



KOMISIONI  
EVROPIAN

Strasbourg, 17.4.2018  
SWD(2018) 156 final

**DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË KOMISIONIT**

**Raport për Kosovën\* 2018**

*Në përçjellje të dokumentit*

**Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin,  
Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, si dhe Komitetin e Rajoneve**

**Komunikata 2018 për Politikën e Zgjerimit të BE-së**

{COM(2018) 450 final} - {SWD(2018) 150 final} - {SWD(2018) 151 final}  
-  
{SWD(2018) 152 final} - {SWD(2018) 153 final} - {SWD(2018) 154 final}  
-  
{SWD(2018) 155 final}

---

\* Ky emërim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin, si dhe është në përputhje me Rezolutën e KSOKB 1244/1999, si dhe Mendimin e IGJK-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

## Pasqyra e përmbajtjes

1. <b>HYRJJE</b> .....	4
1.1. <b>Konteksti</b> .....	4
1.2. Përmbledhje e Raportit .....	4
2. <b>THEMELORET SË PARI: KRITERET POLITIKE DHE SUNDIMI I LIGJIT</b> .....	6
2.1. <b>Funksionimi i institucioneve demokratike dhe Reforma e Administratës Publike</b> .....	6
2.1.1. <b>Demokracia</b> .....	6
2.1.2. <b>Reforma e Administratës Publike</b> .....	10
2.2. <b>Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore</b> .....	14
2.2.1. <b>Gjyqësori dhe të drejtat themelore</b> .....	14
2.2.2. <b>Drejhtësia, liria dhe siguria</b> .....	29
Implementimi dhe kapaciteti zbatues .....	38
3. <b>THEMELORET SË PARI: ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRENCA</b> .....	39
3.1. <b>Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut</b> .....	39
3.2. <b>Kapaciteti për përballje me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian</b> .....	45
4. <b>ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE</b> .....	47
5. <b>NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE MES KOSOVËS DHE SERBISË</b> .....	49
6. <b>STANDARDET EVROPIANE</b> .....	50
6.1. <b>Lëvizja e lirë e mallrave</b> .....	50
6.2. <b>Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit</b> .....	51
6.3. <b>Lëvizja e lirë e kapitalit</b> .....	53
6.4. <b>Shërbimet financiare</b> .....	53
6.5. <b>Dogana</b> .....	54
6.6. <b>Tatimimi</b> .....	55
6.7. <b>Konkurrenca</b> .....	56
6.8. <b>Prokurimi publik</b> .....	57
6.9. <b>E drejta e subjekteve tregtare</b> .....	59
6.10. <b>E drejta e pronës intelektuale</b> .....	59
6.11. <b>Politika sociale dhe punësimi</b> .....	60
6.12. <b>Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit</b> .....	62
6.13. <b>Arsimi dhe kultura</b> .....	63
6.14. <b>Shkenca dhe hulumtimet</b> .....	65
6.15. <b>Çështjet tregtare</b> .....	66
6.16. <b>Politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale</b> .....	66
6.17. <b>Bujqësia</b> .....	67
6.18. <b>Politikat për siguri ushqimore, veterinare dhe fitosanitare</b> .....	68
6.19. <b>Peshkataria</b> .....	69
6.20. <b>Mjedisi dhe ndryshimet klimatike</b> .....	69

6.21. Politika e transportit .....	71
6.22. Energjia .....	73
6.23. Rrjetet Trans-Evropiane .....	74
6.24. Shoqëria e informacionit dhe mediat.....	75
6.25. Kontrolli financiar .....	76
6.26. Statistikat.....	78
SHTOJCA I - MARRËDHËNIET MES BE-SË DHE KOSOVËS .....	80
SHTOJCA II - ANEKSI STATISTIKOR .....	82

## 1. HYRJE

### 1.1. Konteksti

Marrëveshja BE-Kosovë për Stabilizim-Asocim (MSA) është në fuqi që prej prillit të vitit 2016. Për të definuar prioritetet e reformës, Qeveria e Kosovës, bashkë me Komisionin Evropian, në nëntor të vitit 2016, ka lansuar Agjendën Evropiane të Reformave (AER). Qeveria e re e vendosur në shtator të vitit 2017 është zotuar të zbatojë reformat në lidhje me BE-në, por progresi deri më sot ka qenë i ngadalshëm. Marrëveshja për demarkimin e kufirit me Malin e Zi është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 2018, duke shënuar kështu arritje të rëndësishme, si dhe përmbushjen e njërit prej kriteve kyçe për liberalizimin e vizave për Kosovën.

### 1.2 Përmbledhje e Raportit <sup>1</sup>

Sa i përket **kriteve politike**, Kosova ka mbajtur zgjedhje të jashtëzakonshme në qershor të vitit 2017. Kuvendi dhe qeveria kanë marrë mandatet në shtator. Megjithatë, deri më sot, koalicioni i ri në pushtet ka pasur sukses të kufizuar në shtytjen para të reformave të lidhura me BE-në, si dhe krijimin e konsensusit për çështje kyçe strategjike për Kosovën. Fragmentimi dhe polarizimi i vazhdueshëm politik kanë ndikuar negativisht mbi rolin e Kuvendit, si dhe kanë ndikuar efektshmërinë e qeverisë. Veprimet penguese nga disa parlamentarë, duke përfshirë edhe përdorimin e gazit lotsjellës, kanë penguar punimet e Kuvendit. Ratifikimi i marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018 ishte zhvillim i rëndësishëm.

Zgjedhjet parlamentare dhe ato komunale, të mbajtura më 2017, qenë përgjithësisht konkurruese dhe të administruara mirë në pjesën më të madhe të Kosovës. Megjithatë, një sërë frikësimesh mes komunitete të shumta serbe të Kosovës, që shënjestronin posaçërisht kandidatët që nuk i përkasin partisë Lista Serbe, paraqesin brengë.

Konteksti në veri të Kosovës ngre sfida të posaçme. Hetimet për vrasjen e politikanit serb të Kosovës, Oliver Ivanović, në janar të vitit 2018, vazhdojnë.

Përpjekjet nga deputetët e Kuvendit të Kosovës në dhjetor të vitit 2017 për të shfuqizuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar kanë ngritur brenga serioze. Është me rëndësi themelore që Kosova të respektojë plotësisht obligimet e veta ndërkombëtare në lidhje me Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar, si dhe të shfaqë përkushtim të plotë dhe të palëkundur ndaj këtyre institucioneve.

Ekziston një nivel përgatitjesh në fushën e **reformës së administratës publike**. Është arritur pak progres sidomos me rishikimin e agjencive dhe organeve (gjysmë) të pavarura. Politizimi i vazhdueshëm i administratës publike mbetet brengosës, si dhe ndikon negativisht mbi efikasitetin dhe pavarësinë profesionale të administratës publike.

**Sistemi gjyqësor** i Kosovës është në fazë të hershme. Është arritur pak progres në zbatim të ligjeve të pakos së drejtësisë të vitit 2015. Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës, si dhe personelit gjyqësor të Kosovës brenda sistemit gjyqësor ka qenë arritje e madhe e vitit 2017. Gjyqësori është ende i nënshtrueshëm ndaj ndikimit politik dhe institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për përpjekje më të forta për të zhvilluar kapacitetet e tyre. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas.

Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje në **luftën kundër korrupsionit**. Kosova ka arritur pak progres sa i përket historisë së vazhdueshme të hetimit dhe ndjekjes për raste të korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel të lartë, duke përfshirë dënimet përfundimtare. Është arritur progres edhe në konfiskimin preliminar të pasurive, edhe pse

---

<sup>1</sup> Ky raport mbulon periudhën nga tetori 2016 e deri në shkurt të vitit 2018. Bazohet në të dhëna nga një mori burimesh, duke përfshirë kontributet nga qeveria e Kosovës, Shtetet Anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informatat nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

konfiskimi përfundimtar mbetet i ulët. Korrupsioni është gjerë i përhapur, si dhe mbetet çështje brengosëse. Nevojiten orvatje të përbashkuara për të përballur këtë problem në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike.

Kosova është në fazë të hershme në **luftimin e krimit të organizuar**. Është arritur pak progres në kuptimin e regjistrimit të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivel të lartë. Përkundër që ka më shumë sekuestrim të pasurive, ende ka pak dënime të plotfuqishme, hetime financiare dhe konfiskime përfundimtare të pasurive. Agjencitë ligjzbatuese ende përballen me vështirësi në luftimin efektiv të krimit të organizuar në veri të Kosovës. Pak progres është bërë edhe në luftën ndaj terrorizmit, edhe me masat e përballjes me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, si dhe në parandalimin e bashkimit të qytetarëve në konflikte të huaja. Autoritetet e Kosovës duhet të jenë më efektive në përpjekjet e tyre për të luftuar shpëlarjen e parave, ndërsa ligji përkatës duhet të vihet në përputhje me *acquis* të BE-së si dhe standardet ndërkombëtare.

Korniza ligjore gjerësisht garanton mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe atyre themelore** në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, ka nevojë për përpjekje shitesë në aspektin e zbatimit. Implementimi i strategjive dhe legjisllacionit për të drejta të njeriut shpesh pengohet për shkak të resurseve joadekuate financiare dhe të tjera, sidomos në nivelin lokal, prioritetet politike të kufizuara, si dhe mungesa e koordinimit. Duhet të bëhet më shumë për të garantuar efektivisht të drejtat e personave që i përkasin pakicave, duke përfshirë romët dhe ashkalinjtë<sup>2</sup> si dhe personat e zhvendosur, për të siguruar barazinë gjinore në praktikë, për të zhvilluar sisteme të integruar të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe për të avansuar mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Kosova ka një nivel të përgatitjes në fushën e **lirisë së shprehjes**, e cila është e përligjur në kushtetutë. Kosova gëzon një ambient plural dhe të gjallë të mediave. Megjithatë, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve kanë vazhduar. Kuvendi ka treguar një përkushtim të kufizuar për të gjetur një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë të cenueshëm ndaj presionit politik.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova ka bërë përparim të mirë, si dhe është në fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Ambienti i biznesit është përmirësuar, ndërsa qeveria ka respektuar rregullin fiskal për deficitin buxhetor; megjithatë, beneficionet e veteranëve të luftës vazhdojnë të përbëjnë sfida për financat publike. Ekonomia joformale mbetet e përhapur. Rritja e shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nuk është pasuar me rritjen e punësimit, duke shkaktuar kështu rritje të mëtutjeshme të shkallës së papunësisë. Kjo posaçërisht ka prekur gratë dhe punëtorët e rinj dhe të pakualifikuar. Përkundër rritjes së fortë të eksportit, deficitin e lartë tregtar reflekton bazën e dobët prodhuese.

Kosova ka bërë pak progres dhe është në fazë të hershme në kuptimin e kapacitetit për t'u përballur me trysinë konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së. Nuk është arritur ndonjë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe adresimit të hendeqeve të shkathtësive në tregun e punës. Kosova ka arritur pak përparim në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por mbeten hendeqe të mëdha infrastrukturore në sektorin e hekurudhurave dhe atë të energjisë. Ndryshimet strukturore në ekonomi janë të ngadalshme, pasi që ekonomia mbështetet shumë në sektorin e tregtisë me pakicë. Integrimi në BE pengohet nga implementimi i ngadalshëm i MSA-së.

Kosova ka vazhduar përpjekjet e saj për të mbajtur **marrëdhënie dypalëshe** të mira dhe konstruktive me vendet tjera të zgjerimit. Kosova përfaqësohet në shumicën e organizatave rajonale në kuadër të fushëveprimit të Marrëveshjes për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, të lidhur mes Beogradit dhe Prishtinës, më 2012.

Sa i përket **normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova ka vazhduar të jetë e angazhuar

---

<sup>2</sup> Të gjitha këto grupe shqyrtohen në kuadër të termit të gjerë gjithëpërfshirës "Roma", sipas Kornizës së BE-së për Strategjitë Shtetërore për Integrimin e Romëve.

në dialog. Megjithatë, Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtutjeshme e substanciale për implementimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe për të kontribuar në krijimin e rrethanave që nxisin normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, gjë që do të përkufizohet në një marrëveshje juridikisht obligative.

Sa i përket përafrimit me **standardet evropiane**, Kosova është në një fazë të hershme. Përafrimi legjislativ ka vazhduar në disa fusha, por implementimi është i dobët. Pak përparim është arritur në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, prokurimit publik dhe konkurrencës, bashkë me përmirësimin e mjedisit afarist. Në fushën e tatimit dhe doganës, pak progres është bërë edhe në vjeljen e të ardhurave dhe thjeshtimin e procedurave administrative, por Kosova duhet të përforcojë veprimet e veta në luftimin e ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Sektori i energjisë vazhdon të përballet me sfida serioze. Asnjë lloj progresi nuk është arritur në adresimin e çështjeve mjedisore. Përgjithësisht, Kosova duhet të përmirësojë kapacitetet dhe bashkërendimin e saj administrativ, në të gjithë sektorët, për të siguruar zbatim efektiv të *acquis*.

Autoritetet kanë bërë progres në menaxhimin e **migrimit** të rregullt dhe të parregullt. Këto përpjekje duhen vazhduar e konsoliduar tutje. Në këtë kontekst, Kosova duhet të vërë në zbatim një mekanizëm kthimi për migruesit e parregullt, në përputhje me standardet dhe praktikën e BE-së.

## 2. THEMELORËT SË PARI: KRITERET POLITIKE DHE SUNDIMI I LIGJIT

### 2.1 Funkcionimi i institucioneve demokratike dhe Reforma e Administratës Publike

#### 2.1.1 Demokracia

Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme në qershor të vitit 2017, Kuvendi dhe qeveria e re morën mandatin në shtator. Megjithatë, deri më sot, koalicioni i ri në pushtet ka pasur sukses të kufizuar në shtytjen para të reformave të lidhura me BE-në dhe krijimin e konsensusit për çështje kyçe strategjike për Kosovën. Fragmentimi dhe polarizimi i vazhdueshëm politik kanë ndikuar negativisht mbi rolin e Kuvendit, si dhe kanë ndikuar efektshmërinë e qeverisë. Ratifikimi i marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018 ishte zhvillim i rëndësishëm.

Përpjekjet për të shfuqizuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar, të themeluara për të trajtuar pohime të caktuara për krime ndërkombëtare të kryera në kontekstin e konfliktit të Kosovës, kanë ngritur brenga serioze në lidhje me zotimet e liderëve politikë të Kosovës për të ndjekur e gjykuar ato krime, si dhe për të vënë në vend obligimet përkatëse ndërkombëtare të Kosovës.

#### Zgjedhjet

Zgjedhjet parlamentare dhe ato komunale, të mbajtura më 2017, qenë përgjithësisht konkurruese dhe të administruara mirë në pjesën më të madhe të Kosovës. Megjithatë, një sërë frikësimesh mes komunitete të shumta serbe të Kosovës, që shënjestronin posaçërisht kandidatët që nuk i përkasin partisë Lista Serbe, paraqesin brengë. Një numër dobësish afatgjate, sidomos financimi i partive politike, pjesëmarrja e gruas, mekanizmat e kontesteve zgjedhore, listat e pasakta të votuesve, si dhe sistemi në masë të madhe i mangët i votimit për qytetarët e Kosovës jashtë vendit, mbeten për t'u adresuar. Këto sfida duhen trajtuar si çështje prioritare, të udhëzuara nga rekomandimet e misioneve evropiane të vëzhgimit të zgjedhjeve.

Pas një mocioni të mosbesimit në Kuvend, më 10 maj 2017, **zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare** u mbajtën më 11 qershor. 120 deputetët e parlamentit u zgjodhën për një mandat katërvjeçar, përmes një sistemi proporcional të përfaqësimit, me vota preferenciale dhe ulëse të garantuara për komunitetet jo-shumicë.

Zgjedhjet u mbajtën brenda një periudhe të shkurtër kohore prej 30 ditësh. Dalja e votuesve në zgjedhje ishte e ulët, me 41.3 % (42.6 % më 2014). "Koalicioni PAN" (që përbëhet kryesisht nga

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Social Demokratike (Nisma)) morn 33.7 % (39 ulëse), Vetëvendosje (VV) 27.5 % (32 ulëse), "Koalicioni LAA" (Që përbëhet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Kosovën e Re (AKR) dhe Alternativa) 25.5 % (29 ulëse), dhe Lista Srpska 6.1 % (9 ulëse). Përkundër faktit që forumet e grave ekzistojnë në disa parti politike, kjo nuk ka sjellë pjesëmarrje më të madhe të grave në procesin zgjedhor. Nga 120 deputetë të zgjedhur të parlamentit, 39 janë gra. Ekzistojnë mospërputhje mes kornizës ligjore zgjedhore dhe dispozitës së përfaqësimit të barabartë në Ligjin për Barazi Gjinore. Kandidatet nuk kanë marrë përkrahjen e barabartë financiare e as logjistike nga subjektet e tyre politike për fushatat e tyre, ndërsa gratë kandidate folën rrallë në ngjarje zgjedhore. Mediet i dhanë hapësirë prioritare kandidatëve meshkuj.

**Zgjedhjet e rregullta komunale dhe për kryetar komuneu** mbajtën më 22 tetor 2017, ndërsa raundi i dytë për zgjedhje të kryetarëve më 10 nëntor. Këto qenë zgjedhjet e dyta lokale të mbajtura në të gjitha komunat në gjithë Kosovën. Nga 204 kandidatë për kryetarë, vetëm 8 qenë gra. Nga 38 komunat, LDK fitoi pozitën e kryetarit në 8, AAK në 7, PDK në 5 dhe VV në 3 sosh. Lista Serbe fitoi në të 10 komunat me shumicë serbe. AKR, NISMA dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës fituan nga një komunë. Dy kandidatë të pavarur fituan pozitën e kryetarit. Nga 38 kryetarë komunash të zgjedhur, asnjë nuk është grua.

BE-ja dërgoi misione plotësisht të pajisura vëzhguese edhe në zgjedhjet parlamentare edhe në ato komunale. Zgjedhjet në veri të Kosovës u ndihmuan teknikisht nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Në Evropë (OSBE). Përgjithësisht, të dy palë zgjedhjet qenë konkurruese dhe të mirë-administruara në pjesën më të madhe të Kosovës. Megjithatë, në shumë komunitete serbe të Kosovës, ambienti zgjedhor u njollos nga një mori rastesh frikësimi, që shënjestronin posaçërisht subjektet politike dhe kandidatët që nuk ishin me Listën Srpska. Janë raportuar raste të dhunës nga brenga komunitetit serb të Kosovës, si dhe për reagimin e pamjaftueshëm nga autoritetet e zbatimit të ligjit. Misioni vëzhgues i zgjedhjeve nga BE-ja vërejti që gjatë fushatës, zyrtarë të lartë në Beograd vazhdimisht ftonin votuesit që të votonin për Listën Serbe. Të gjitha këto ngrejnë brenga të mëdha për gjendjen e demokracisë brenda komuniteteve serbe të Kosovës.

Ka nevojë për vullnet politik në të gjithë spektrin politik, për të ndërmarrë reformat e domosdoshme zgjedhore shumë më përpara raundit vijues të zgjedhjeve të përgjithshme. Kuvendi duhet që urgjentisht të trajtojë dobësitë me histori të gjatë, sipas udhëzimeve e rekomandimeve të misionit të BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve. Pohimet për frikësim duhen hetuar menjëherë dhe thellësisht. Listat e pasakta të votuesve, që mund t'i nënshtrohen mashtrimeve, duhen pastruar, ndërsa sistemi i votimit për qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit është përgjithësisht i mangët, si dhe duhet rishikuar. Duhet ndërmarrë veprime afirmative për të tejkaluar vështirësitë që pengojnë gratë nga pjesëmarrja në politikë dhe në zgjedhje. Rregullimi i financimit të partive politike dhe fushatave ka humbur efektshmërinë për shkak të mungesës së monitorimit dhe kontrollit sistematik. Mekanizmat e kontesteve zgjedhore duhet të funksionojnë në mënyrë më transparente dhe të besueshme.

## **Parlamenti**

Kuvendi duhet të përmirësojë në masë substanciale punën e tij si forum për dialog konstruktiv e përfaqësim politik, por edhe të garantojë kontrollet dhe baraspeshat e mirëfillta. Mungesa e shpeshtë e parlamentarëve në seanca plenare, si dhe polarizimi i vazhdueshëm politik kanë dëmtuar aktivitetin ligjvënës gjatë periudhës së raportimit. Veprimet penguese nga disa parlamentarë, duke përfshirë edhe përdorimin e gazit lotsjellës, kanë penguar punimet e Kuvendit. Puna ndërpartiake në reforma të pritura gjatë është nevojë urgjente. Edhe koalicioni në pushtet edhe opozita duhet të intensifikojnë punën e tyre parlamentare, si dhe të kërkojnë konsensusin mbi prioritetet e reformave që lidhen me BE-në. Ratifikimi i marrëveshjes për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018 ishte zhvillim i rëndësishëm. Përgjithësisht, mbikëqyrja efektive e Kuvendit si dhe transparenca e cilësia e ligjvënies duhen

përmirësuar, ndërsa përdorimi i procedurave urgjente duhet kufizuar.

Pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme më 11 qershor, u deshën rreth dy muaj që të konstituohet Kuvendi dhe të emërohet qeveria. Me 61 nga 120 vota, koalicioni qeverisës (që përbëhet nga PDK, AAK, NISMA, AKR dhe Lista Srpska, bashkë me partitë tjera minoritare), udhëhequr nga Kryeministri Haradinaj, ka shumicë të brishtë. Për herë të parë, partia opozitare VV u bë subjekti më i fuqishëm në parlament (32 ulëse).

Zgjedhet parlamentare dhe formimi i qeverisë gjatë verës, si dhe zgjedhjet komunale në vjeshtë, vonuan punën parlamentare dhe në masë të madhe ngadalësuan reformat evropiane të Kosovës. Periudha e raportimit u shënuar me polarizim politik dhe mosfunksionim, edhe në legjislaturën e kaluar edhe në atë aktuale. Të gjitha partitë politike duhet të shfaqin përgjegjshmëri dhe të angazhohen sërish në dialog konstruktiv, ku Kuvendi do të ishte forumi kryesor i debatit politik.

Kuvendi ka vazhduar të mbajë seanca të parregullta plenare. Mungesa e shpeshtë e deputetëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe prijësit e tij, shpesh ka shkaktuar mungesë kuorumi për vendim-marrje. Si pasojë, pikat e rendit të ditës janë shtyrë nga seanca në seancë. Dobësitë dhe mangësitë në rregulloren e punës duhen trajtuar. Procedura e përshpejtuar është përdorur shpesh (22 nga 115 ligje janë miratuar me këtë procedurë). Kjo ka sjellë legjislacion që është miratuar pa ndonjë debat substancial apo konsultim të palëve me interes, duke përfshirë edhe ligjet me rëndësi jetike, si ai i buxhetit. Kuvendi duhet të vendosë një plan ambicioz të punës për të adresuar punët e pakryera që po rriten në numër, si dhe për të rifituar kohën e humbur. Kuvendi duhet të planifikojë punën paraprakisht, duke prezantuar agjenda çdo gjashtë muaj, me datat e seancave të rregullta plenare javore, për të mundësuar mbikëqyrje proaktive dhe për të siguruar kontrollin dhe baraspeshat.

**Mbikëqyrja e ekzekutivit** nga parlamenti mbetet e dobët. Komisionet parlamentare kanë vazhduar konsultimet me palët relevante të interesit, por kërkohen përmirësime në kuptimin e njoftimeve të hershme dhe vazhdimësisë. Për më tepër, Kuvendi i mungojnë kompetencat dhe kapacitetet për të mbikëqyrë efektivisht 32 agjencitë/organet që i raportojnë drejtpërdrejt. Qeveria dhe Kuvendi duhet të implementojnë rekomandimet që kanë dalë nga rishikimi i agjencive të pavarura, i cili është bërë për të racionalizuar numrin e agjencive që i raportojnë Kuvendit. (*Shih 2.3 Reforma e Administratës Publike*). Kuvendi ka dështuar në emërimin, me kohë apo sipas meritave, të anëtarëve profesionalë të bordeve për disa institucione të pavarura. Kuvendi duhet të shfrytëzojë raportin vjetor të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për të shqyrtuar imtësisht punën e qeverisë. Komisioni parlamentar për Financa Publike, që përgatit rekomandimet për miratim nga Kuvendi, gjithashtu duhet të mbajë seanca dëgjimi me ministra e kryetarë komunash.

Mbikëqyrja parlamentare e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Inteligjencës vazhdon të jetë e pamjaftueshme.

**Avokati i Popullit** ka vazhduar të përforcojë kapacitetet e tij në shqyrtim të rasteve dhe është bërë institucioni më i besuar në Kosovë. Kuvendi ka emëruar 5 zëvendës-avokatë të popullit, edhe pse me shumë vonesë. Ka nevojë që Kuvendi të rishikojë rregulloret e veta të brendshme për këtë gjë.

Pak progres është bërë në përmirësimin e **transparencës** brenda dhe në qasjen publike ndaj punës së Kuvendit. Në nëntor të vitit 2017, Kuvendi vuri në funksion një sistem elektronik të përcjelljes, duke ofruar qasje publike në të gjitha informatat dhe dokumentet e projektligjeve që ka në shqyrtim.

Financat e **partive politike** si dhe financimi e shpenzimet e fushatave vazhdojnë të lëngojnë nga mungesa e transparencës, ndërsa legjislacioni në këtë fushë mbetet përgjithësisht i pazbatuar. Kjo rrënon besimin e publikut tek partitë politike, si dhe vazhdon ta ekspozojë procesin demokratik ndaj rreziqeve të konsiderueshme të korrupsionit dhe ndikimeve të pahijshme. Është bërë një hap pozitiv me publikimin e auditimeve të jashtme të financave të partive politike, për herë të parë që nga viti 2013. Megjithatë, këto auditime kanë konfirmuar shkelje serioze të ligjeve për financimin e partive politike, si dhe dobësi të mëdha në kontrollin e brendshëm financiar të subjekteve politike. Dispozitat ligjore duhen zbatuar urgjentisht, si dhe korniza ligjore duhet përforcuar efektivisht.



## Qeverisja

Polarizimi i fortë ndërmjet partive politike ka penguar qeverisjen efektive në pjesë të mëdha të periudhës së raportimit. Qeveria e re e vendosur në shtator të vitit 2017 ka shprehur përkushtimin e saj që të zbatojë reformat në lidhje me BE-në, e sidomos Agjendën e Reformave evropiane. Duhet një fokus më i madh në ndërtimin e konsensusit për reformat kryesore evropiane. Qeveria është tejet e madhe, gjë që gërryen edhe koherencën në krijim të politikave.

**Qeveria** e Kryeministrit Mustafa ishte rrëzuar pasa votës së mosbesimit në Kuvend në maj të vitit 2017. Edhe para kësaj, kohezioni në qeveri ishte rrënuar tashmë, si dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, gati asnjë reformë e konsiderueshme nuk ishte bërë. Qeveria e re e udhëhequr nga Kryeministri Haradinaj mori mandatin në shtator të vitit 2017. Koalicioni qeverisës përbëhet nga PDK, AAK, NISMA, AKR, Lista Srpska, si dhe përfshin përfaqësues të tjerë të pakicave. Me vëmendjen politike tek zgjedhjet për pjesën më të madhe të periudhës së raportimit, qeveria e kaluar dhe ajo aktuale nuk kanë arritur të ndjekin ndonjë agjendë koherente e substanciale të politikave.

Ekziston një trend i emërimit të një numri të tepërt të pjesëtarëve të qeverisë, si emërimi i 70 zëvendësministrave në qeverinë aktuale, si dhe 45 në qeverinë e kaluar, nganjëherë pa ndonjë atribut të qartë. Autoritetet duhet të konsiderojnë vendosjen e një kufizimi të madhësisë së qeverisë, që të parandalojnë praktikën e tillë. Janë vetëm 2 ministre gra. Pesë pozita ministrore mbahen nga përfaqësuesit e pakicave, 3 nga të cilët përfaqësojnë komunitetin serb, 1 komunitetin turk, si dhe 1 komunitetin boshnjak të Kosovës.

Në nëntor të vitit 2016, qeveria e Kosovës, bashkë me Komisionin Evropian, lansuan **Agjendën e Reformave Evropiane (ARE)**, mjet ky për priorizimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA). Plani i Veprimit për ARE u miratua nga Kuvendi; megjithatë, zbatimi i tij ka ngecur prapa. Programi i rishikuar 2018-2022 i Kosovës për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit shërben si mjeti kryesor për planifikimin, bashkërendimin dhe monitorimin e reformave të lidhura me BE-në. Implementimi i MSA-së është në vazhdim, por pjesa më e madhe e programit po ngec prapa. Qeveria e re ka përditësuar masat afatshkurtra dhe afatmesme në program, për ta bërë më realist, të buxhetuar, si dhe më mirë të përputhur me programin vjetor të punës.

Kuvendi, pas disa përpjekjeve, ka ratifikuar marrëveshjen e demarkimit të kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018, duke përmbushur njërin prej kritereve kyçe për liberalizim të vizave.

Vëmendja ministrore ndaj legjislacionit në Kuvend, nga propozimet deri tek miratimi, duhet të rritet. Dështimi i ministrave në pjesëmarrje në seanca plenare, si dhe mosdhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve parlamentare, vazhdojnë të minojnë transparencën, llogaridhënien dhe komunikimin me kuvendin.

Dialogu ndërmjet institucioneve qeveritare dhe Avokatit të Popullit është përmirësuar. Përcjellja dhe implementimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit janë rritur më tutje, në përgjithësi. Megjithatë, qeveria, sidomos Zyra e Kryeministrit për Qeverisje të Mirë, si dhe Kuvendi, duhet të jenë më aktive në sigurimin e adresimit të mirëfilltë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Ato duhet që gjithashtu të zhvillojnë sisteme efektive të monitorimit për adresim të rekomandimeve të organeve dhe agjencive që raportojnë tek to.

Përpjekjet e mëtutjeshme për të rritur kapacitetet e **qeverisjes lokale** kanë vazhduar. Pas zgjedhjeve lokale në tetor dhe nëntor 2017, shumica e kuvendeve të reja komunale janë themeluar me kohë. Gratë mbeten dobët të përfaqësuara në pozitat lokale të vendim-marrjes. Derisa komunat lokale kanë marrë përsipër më shumë kompetenca, resurset e tyre njerëzore dhe financiare shpesh janë të pamjaftueshme. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal duhet ndryshuar, duke përfshirë një grant specifik për shërbime sociale, për të siguruar transparencën në buxhet dhe një nivel minimal të

përkrahjes për shërbime sociale në nivel komunal.

Komunat në veri të Kosovës kanë vazhduar të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre me institucionet e qeverisë qendrore. 4 komunat veriore kanë respektuar legjislacionin për miratimin e buxheteve komunale për vitin 2017. Megjithatë, për shkak të mospërputhjeve të vazhdueshme të shifrave të popullsisë, duhet të kryhet një regjistrim i popullsisë në 4 komunat.

### Shoqëria civile

Pak progres është arritur në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë qendrore. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar angazhim kuptimplotë dhe bashkëpunim edhe në nivelin lokal. Publikimi i raportit të parë qeveritar për financimin publik të organizatave joqeveritare ka sjellë më shumë transparencë.

Shoqëria civile e fuqizuar është element qenësor i cilitdo sistem demokratik, si dhe duhet njohur e trajtuar si i tillë nga institucionet në Kosovë. Shoqëria civile duhet të vazhdojë të luajë rol të rëndësishëm në debatin demokratik, si dhe në dizajnimin e zbatimin e politikave publike. Rregullat për krijimin, regjistrimin, operimin, pezullimin, pushimin, si dhe çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare (OJQ) kanë nevojë për më shumë sqarim. Projektligji i ri për lirinë e bashkimit në OJQ, përgatitur në konsultim me shoqërinë civile, ende nuk është miratuar.

Legjislacioni për shpëlarjen e parave dhe anti-terrorizmit mbetet kufizues për sektorin e OJQ-ve. Në shtator të vitit 2017, vlerësimi i rrezikshmërisë në sektorin e OJQ-ve ishte iniciuar nga Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës, për të identifikuar se në çfarë mase rrezikohet sektori i OJQ-ve nga financimi terrorist.

Hyrja në fuqi e dy rregulloreve që vendosin standarde për konsultimet publike dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për financimin publik të OJQ-ve ka shtruar rrugën për qeverisje më të mirë si dhe përdorim më transparent të fondeve publike. Kjo është pjesë e strategjisë së Kosovës për bashkëpunimin qeveri-shoqëri civile. Megjithatë, disa ministri dhe komuna ende nuk janë të gatshme për të përmbushur obligimet sipas rregulloreve të reja. Ato gjithashtu kanë mungesë të kapaciteteve teknike për të ekzekutuar efektivisht buxhetin e ndarë në pajtim me rregulloret dhe procedurat e reja.

Në mars të vitit 2017, qeveria publikoi raportin e parë mbi financimin publik. Kjo përbën hap pozitiv drejt një transparence më të madhe të financimit publik. Megjithatë, lloji i informatave që ofrohet ende nuk mundëson analizë kuptimplotë të ekzekutimit të buxhetit.

Korniza ligjore për zbritjet tatimore për donacione mbetet e dykuptimtë.

#### 2.1.2 Reforma e Administratës Publike

Kosova ka arritur **një nivel përgatitjeje** në reformimin e administratës së saj publike. **Pak progres** është arritur sidomos në rishikimin e agjencive dhe organeve (gjysmë) të pavarura, siç është rekomanduar nga Komisioni më 2016. Megjithatë, plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të rishikimit është ende në përgatitje e sipër. Mbeten brenga në lidhje me rekrutimet pa bazë meritore, që ndikojnë në efikasitetin dhe pavarësinë profesionale të administratës publike. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të miratojë pakon ligjore që përmban ligjin për shërbimin civil, pagat dhe organizimin dhe funksionimin e administratës publike, në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në evidenca;
- të miratojë dhe fillojë implementimin e planit të veprimit për të racionalizuar agjencitë dhe organet (gjysmë) të pavarura, sipas dakordimit mes Kuvendit dhe qeverisë;
- të përmirësojë parashikueshmërinë juridike për qytetarë dhe biznese duke ndryshuar e plotësuar gradualisht ligjet speciale të identifikuar dhe aktet zbatuese që janë në kundërtënie me Ligjin e ri për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe të adresojë çështjet e prapambetura administrative.

## Hartimi dhe bashkërendimi i politikave

Baza ligjore dhe strukturat institucionale për një **sistem hartimi politikash** koherent e të bashkërenduar, edhe për reforma evropiane, janë përgjithësisht në zbatim. Reforma e administratës publike është e përfshirë si fushë prioritare në programin qeveritar për 2015-2018, Strategjinë Shtetërore të Zhvillimit, si dhe Programi Nacional për Implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Dobësia kyçe tek hartimi dhe bashkërendimi i politikave është që ka tepër shumë dokumente planifikimi, si dhe planifikimi është vazhdimisht tejet ambicioz. Ekziston obligimi ligjor për përgatitjen e strategjive sektorale, duke përfshirë kostimin dhe burimet e financimit. Megjithatë, për shkak të mungesës së kontrollit të centralizuar të cilësisë, strategjitë sektorale rrallë ndërlidhen me kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe shpesh janë financiarisht të paqëndrueshme.

Disa aspekte të **hartimit të politikave dhe ligjeve në bazë të fakteve** dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse janë të vendosura, por në praktikë, analiza e problemeve dhe arsyetimi për ndërhyrje qeveritare shpesh mungojnë. Derisa kriteret për vlerësimet e ndikimit buxhetor janë të caktuara, vlerësimet më specifike të ndikimit rregullativ rrallë kanë cilësi të mjaftueshme. **Konsultimet publike** dhe ndërministrore janë të rregulluara, si dhe është arritur përparim në implementim të standardeve minimale për konsultime publike. Këto standarde kanë hyrë në fuqi në janar të vitit 2017, si dhe janë pasuar, në shkurt të vitit 2017, me lansimin e një portali interneti për konsultimet ndërministrore dhe ato publike. Më 2016, vetëm 21% e dokumenteve primare të politikave dhe projektligjeve janë publikuar për konsultime. Shkalla e reagimit nga shoqëria civile dhe publiku është ende e ulët.

**Vëzhgimi i imtë e efektiv publik mbi punët qeveritare** dobësohet nga mungesa e kriterëve të qarta edhe për raportimin mbi implementimin e planit vjetor të punës së qeverisë edhe të strategjive sektorale edhe publikimin e atyre raporteve. Mbikëqyrja parlamentare e qeverisë mbetet e pamjaftueshme.

## Menaxhimi financiar publik

Kosova është duke implementuar **strategjinë e reformimit të menaxhimit të financave publike (MFP)** për periudhën 2016-2020. Kjo adreson disiplinën fiskale, alokimin dhe efikasitetin operacional, si dhe çështjet e ndërlidhura. Strategjia, që duhet rishikuar më 2018, plotësohet me strategjinë e prokurimit publik, miratuar më 2017, si dhe strategjinë e kontrollit të brendshëm të financave publike, miratuar më 2015. Raporti i parë vjetor për strategjinë e reformës së MFP-së është miratuar më 2017. Përparimi në implementimin e strategjisë së reformës së MFP-së ka qenë i kënaqshëm deri sot.

Rregulli fiskal për normën e borxhit ndaj BPV-së dhe bilancit buxhetor është respektuar. Megjithatë, futja e “klauzolës së investimeve” në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjshmërisë e ka bërë këtë rregull më pak transparent. Vjelja vjetore e tatimeve është përmirësuar paksa, si dhe projeksionet e të ardhurave, kontrolli i zotimeve, si dhe alokimi efektiv i shpenzimeve gjatë vitit kanë rritur kredibilitetin e buxhetit në nivel të agreguar. Derisa niveli i përgjithshëm i borxhit publik si pjesë e BPV-së është rritur nga 14,3 % në 16,8 % të BPV-së, shpenzimet e shërbimit të borxhit janë dyfishuar në 2 vitet e kaluara. Vlerësimi më i ri me vitin referent 2015 tregon një ulje në ekonominë e hirtë, por administrata tatimore dhe doganat kanë nevojë për përforsim shtesë për të tkurrur informalitetin dhe për të zgjeruar bazën tatimore.

Kosova është përkushtuar të përmirësojë **transparencën buxhetore**. Raportimi mbi financat publike është bërë më i detajuar, gjithëpërfshirës dhe sistematik. Ministria e Financave gjithashtu ka filluar publikimin e të dhënave financiare krahasuese në baza mujore, në faqen e vet të internetit. Ky është një hap drejt përmirësimit të standardeve të Doracakut të Statistikave Financiare Qeveritare 2014 të FMN-së. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, e cila auditon menaxhimin financiar të qeverisë, ka filluar të angazhohet në mënyrë më proaktive me shoqërinë civile. Megjithatë, implementimi i rekomandimeve në Raportin Vjetor të Auditimit të Zyrës Shtetërore të Auditimit është modest dhe duhet përmirësuar (*shih pjesën për kontrollin financiar*).

## Shërbimi publik dhe menaxhimi i resurseve njerëzore

Puna ka vazhduar në nivel qeveritar me hartimin e ligjit të ri për shërbimin civil. Ky projektligj është pjesë e një pakoje ligjesh, ku përfshihen edhe ligji për pagat dhe ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës publike. Koncept-dokumentet e ligjit për shërbimin civil dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës publike janë miratuar në maj të vitit 2017, derisa koncept-dokumenti për ligjin për pagat është miratuar në mars të vitit 2018.

Ligji aktual për Shërbimin Civil formalisht parasheh **rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin në bazë të meritave**, bazuar në kritere objektive. Megjithatë, mangësitë në ligj kanë mundësuar praktika kundërthënëse, duke përfshirë kthimin e punëtorëve të përkohshëm në shërbyes civilë të përhershëm pa konkurse publike. Ndikimi politik në emërime e shkarkime vazhdon të jetë brengë serioze, sidomos tek menaxhmenti i lartë. Ministria e Administratës Publike ende nuk ka kapacitet të mjaftueshme për të mbikëqyrur në mënyrë aktive procedurat e rekrutimit. Komunitetet jo-shumicë mbeten dobët të përfaqësuara në institucionet publike qendrore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka mungesë të kapaciteteve të mjaftueshme profesionale. Rreth 87% e rekomandimeve dhe vendimeve të tij janë implementuar. Gjyqtarët administrativë janë duke u mbingarkuar në vazhdimësi, duke shpjeguar drejt vonesave në vendime, si dhe tkurrja e numrit të tyre në Gjykatën Themelore të Prishtinës është brengosëse.

Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për bashkërendimin qendror të **menaxhimit të resurseve njerëzore**, edhe pse Ligji aktual për Shërbimin Civil nuk ia cakton shprehimisht atë rol koordinues, si dhe nuk i obligon ministrinë të raportojnë tek kjo Ministri. Sistemi i klasifikimit të vendeve të punës, i cili është futur në zbatim që nga janari i vitit 2016, tashmë mbulon rreth 80% të shërbyesve civilë. Pozitat e tyre janë harmonizuar me katalogun e vendeve të punës, i cili do të përafrohet me pakon e ligjeve të reja pas miratimit të tyre. Edhe pse ka pasur përparim me sistemin informativ të menaxhimit të resurseve njerëzore, i cili tashmë mbulon gati të gjitha institucionet, ai është vetëm pjesërisht i zhvilluar, si dhe nuk përdoret për qëllime menaxhimi dhe monitorimi. Kjo e bën të vështirë aplikimin e standardeve adekuate, koherente.

Kosova ka nevojë urgjente për legjislacion të cilësisë së lartë e koherent për të rregulluar **kompensimet** në sektorin publik për të shmangur strukturat e padrejta të pagave, keqpërdorimin e pagesave dhe vendimet në diskrecion në këtë fushë. Sistemi aktual nuk ofron stimuj për mbajtjen dhe rekrutimin e personelit profesional kyç. Vendimi i qeverisë në dhjetor të vitit 2017 për të rritur pagat e kabinetit qeveritar, ministrave, zëvendësministrave, si dhe disa shërbyesve civilë në zyrën e Kryeministrit u pezullua në fund të janarit 2018, në pritje të mendimit të Gjykatës Kushtetuese. Vendimi qeveritar ndezi kritika të gjera publike, si dhe u identifikua nga Agjencia Anti-Korrupsion si rast brengosës i konfliktit të mundshëm të interesave.

Është arritur përparim në **zhvillimin profesional** të shërbyesve civilë, por Instituti i Kosovës për Administratë Publike ka buxhet tejet të kufizuar për trajnime për personelin në të gjitha institucionet. Vlerësimet e performancës janë rritur në përdorim, por ato vazhdojnë të kenë ndikim të vogël tek zhvillimi i karrierës.

Masat dhe mekanizmat për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e **integritetit në shërbimin publik janë të vendosura**. Fillimisht u arrit përparim i mirë me publikimin e raportit vjetor të dhjetorit 2017 për masat disiplinore ndaj shërbyesve civilë. Këto masa janë ndërmarrë ose nga administrata ose gjykata, për shkeljen e neneve të etikës dhe anti-korrupsionit. Në përputhje me Agjendën e Reformave Evropiane, qeveria duhet të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme për të mundësuar, në bazë të vendimit gjyqësor, pezullimin e zyrtarëve publikë nën aktakuzë për veprat penale të lidhura me korrupsionin dhe largimin e zyrtarëve publikë të dënuar për veprat penale të lidhura me korrupsionin (*shih pjesën për Luftën ndaj korrupsionit*).

## Llogaridhënia e administratës

Administrata publike është e fragmentuar, si dhe nuk siguron **linja efektive të llogaridhënies**; as ndërmjet organeve të shumta administrative e as brenda institucioneve, ku nuk ka delegim të qartë të përgjegjësive tek menaxhmenti i mesëm. Ligji aktual që rregullon administratën ka lejuar themelimin e 46 agjencive qeveritare (gjysmë) të pavarura, ku shumë të tilla kanë përgjegjësi të ndërlidhura me ministritë e tyre amë. Shumë nga këto institucione e agjenci nuk janë në përputhje me Ligjin për Shërbimin Civil, si dhe kanë kushte më të favorshme të pagave sesa shërbyesit civilë në ministri që bëjnë punë ekuivalente (*Shih pjesën për kontrollin financiar*).

Gjatë periudhës së raportimit, qeveria dhe Kuvendi nuk kanë shfaqur ndonjë vullnet të mjaftueshëm për të adresuar bashkërisht këto mangësi. Rishikimi gjithëpërfshirës i agjencive (gjysmë) të pavarura u publikua në dhjetor të vitit 2016. Rekomandimet e këtij rishikimi do të implementohen si pjesë e një plani veprimi që po hartohet. Plani i veprimit duhet të parashohë që qeveria do të ulë numrin e përgjithshëm të këtyre agjencive, si dhe të ndërrojë linjat e raportimit të disa organeve nga Kuvendi tek qeveria. Synimi është të ketë më shumë efikasitet, linja më të mira të llogaridhënies dhe mbikëqyrja më e madhe.

**E drejta e qytetarëve për administratë të mirë** po adresohet nga institucionet e pavarura e mbikëqyrjes, si Auditori i Përgjithshëm dhe Avokati i Popullit. Edhe pse ka pasur përmirësim të dukshëm gjatë periudhës së raportimit, jo të gjitha institucionet kanë ndjekur sistematikisht rekomandimet e tyre. Ligji për Qasje në Dokumente Publike mëton të sigurojë **të drejtën e qasjes në informata publike**, por implementimi mbetet i pabarabartë. Ligji kërkon rishikim të thukët për të adresuar implementimin sfidues dhe të fragmentuar. Kosova duhet të miratojë një ligj të ri për kontestet administrative për të përforcuar **të drejtën e qytetarëve për drejtësi administrative**. Gjykata Themelore e Prishtinës ka ngarkesë substanciale të rasteve të prapambetura administrative, të cilat duhen adresuar vazhdimisht. Kjo ngarkesë e rasteve të prapambetura ka pak gjasë të zvogëlohet, sidomos pasi që Ligji i ri për Kundërvajtje, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017, rrezikon të shtojë edhe më shumë rastet e prapambetura në gjykata. **E drejta e kërkimit të kompensimit** si dhe përgjegjësia e autoriteteve publike në rastet e kundërvajtjeve ndikohen nga legjislacioni i fragmentuar. Nuk mblidhen të dhëna për monitorimin e implementimit faktik.

## Ofrimi i shërbimeve për qytetarë dhe biznese

Qeveria promovon **administratën e orientuar kah shfrytëzuesi**, por mungesa e vizionit të qartë, lidershit dhe bashkërendimit pengojnë përpjekjet reformuese. Shumë institucione kanë filluar të implementojnë zgjidhje vetanake jashtë mjeteve qendrore të identifikimit elektronik (eID) që po zhvillohen. Veglat qendrore për mbledhjen e informatave nga publiku dhe bizneset janë në fazë të hershme të zhvillimit. Zgjidhjet teknike për interoperabilitet nuk janë të zhvilluara ende. Legjislacioni për qasje të barabartë në shërbime ekziston, por zbatimi i tij është sfidues, sidomos kur bëhet fjalë për personat me lëvizshmëri të kufizuar.

**Thjeshtimi i procedurave administrative** ka ecur përpara me hyrjen në fuqi të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në qershor të vitit 2017. Qeveria ka krijuar një inventar të ligjeve që përmbajnë procedura të posaçme administrative. Këto ligje tash duhen ndryshuar për të hequr kundërthëniet me ligjin e ri. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të informuar dhe edukuar administratën dhe publikun në Kosovë për detyrimet dhe të drejtat sipas ligjit të ri.

## Korniza strategjike për reformën e administratës publike

**Korniza strategjike për reformën e administratës publike** përbëhet nga 4 strategji për rregullimin më të mirë, planifikimin dhe bashkërendimin e politikave, modernizimin e administratës publike si dhe menaxhimin e financave publike. Implementimi ka qenë i dobët, kryesisht për shkak të planifikimit tejambicioz si dhe mungesës së resurseve. Dy nga këto strategji janë rishikuar më 2017, ndërsa njëra po rishikohet për të përmirësuar caqet dhe treguesit, si dhe për të siguruar planifikim më real. Reforma në administratën publike deri më tash ka gëzuar **mbështetje të**

**fuqishme politike.** Këshilli Ministror, udhëhequr nga Kryeministri, ka drejtuar procesin e reformës. **Qëndrueshmëria financiare** e reformave është brengosëse, pasi që implementimi i strategjive varet në masë të madhe nga përkrahja e donatorëve të jashtëm. Përkundër zotimeve të qeverisë, alokimet dhe ndarjet buxhetore vjetore në kornizën afatmesme të shpenzimeve janë më të ulëta sesa ato që janë planifikuar me dokumente strategjike.

## 2.2 Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore

### 2.2.1 Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Kosova është në një **fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje** për të zbatuar *acquis* dhe standardet evropiane në këtë fushë. Është arritur **pak progres**, sidomos me integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe stafit mbështetës serb të Kosovës nga e gjithë Kosova brenda sistemit të unifikuar gjyqësor të Kosovës, me hetimin dhe ndjekjen penale të disa rasteve korruptive të nivelit të lartë, si dhe fillimin e procesit të aplikimit për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Sa i përket të drejtave themelore, implementimi i ligjeve dhe strategjive përkatëse shpesh dëmtohet nga resurset joadekuate financiare dhe të tjera, priorizimi i kufizuar politik dhe mungesa e bashkërendimit. Arrestimi dhe deportimi vijues i gjashtë shtetasve turq që ligjërisht banonin në Kosovë, në mars të vitit 2018, ka ngritur pyetje në lidhje me respektimin e procesit të mirëfilltë juridik. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të marrë masa konkrete për të rritur në maksimum pavarësinë, llogaridhënien, profesionalizmin dhe efikasitetin e gjyqësorit;

→ Të vazhdojë të përforcojë regjistrin e rasteve të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë aktgjykimet e plotfuqishme dhe konfiskimet, si dhe të ndryshojë legjislacionin përkatës penal. Të zgjerojë sistemin ekzistues përcjellës TI për të përfshirë të gjitha rastet korruptive të nivelit të lartë;

→ T'i japë prioritet më të lartë politik mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre themelore, si dhe të sigurojë resurset dhe kapacitetet adekuate buxhetore për implementimin, zbatimin dhe promovimin e tyre, duke përfshirë shërbimet kyçe dhe ndihmën për grupet e cenueshme.

## Funksionimi i gjyqësorit

Kosova është në **fazë të hershme** të zhvillimit të një sistemi funksional gjyqësor. **Pak përparim** është arritur më 2017 në implementim të ligjeve të pakos së drejtësisë të vitit 2015. Integrimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, si dhe personelit gjyqësor të Kosovës brenda sistemit gjyqësor të Kosovës ka qenë arritje e madhe e vitit 2017. Gjyqësori është ende i nënshtrueshëm ndaj ndikimit të pahijshëm politik, si dhe institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për përpjekje të vazhdueshme forta për të zhvilluar kapacitetet e tyre. Administrimi i drejtësisë mbetet i ngadalshëm dhe joefikas.

Pasi që rekomandimet e raportit 2016 janë adresuar vetëm pjesërisht, ato mbeten të vlefshme. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të vazhdojë të përforcojë kapacitetin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës, si dhe të përmirësojë administratën gjyqësore, sidomos me anë të sistemit funksional të menaxhimit të rasteve, që duhet të mundësojë edhe ndarjen e rëndomtë të rasteve si dhe të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ);

→ Të miratojë ligj të ri për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përputhje me standardet evropiane për të përforcuar llogaridhënien;

→ Të vazhdojë përpjekjet për të zvogëluar ngarkesën me raste të prapambetura, duke përfshirë edhe shfrytëzimin e mjeteve të zgjidhjes alternative të kontesteve, përdorimi i të cilave duhet të finanohet e promovohet në masë të mirëfilltë.

### Dokumentet strategjike

Përgjithësisht, ka progres të ngadalshëm në zbatimin e **planit strategjik 2014-2019** të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), strategjisë së komunikimit 2014-2019, si dhe strategjinë për zvogëlimin e numrit të rasteve të prapambetura. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka demonstruar më shumë progres në zbatim të planit strategjik për periudhën 2016-2018, por edhe ai është duke ngecur prapa. Kosovës i mungon një strategji gjithëpërfshirëse për reforma të sektorit të drejtësisë, si dhe mekanizmi i mirëfilltë për bashkërendimin ndërinstitucional. Koordinimi i donatorëve është i pamjaftueshëm nga autoritetet e Kosovës. Kjo shpie në joefikasitet, jokoherecë dhe dyfishim të përpjekjeve. Në nëntor të vitit 2016, qeveria miratoi një vendim për të ndërmarrë rishikimin funksional të sektorit të sundimit të ligjit. Megjithatë, nuk ka pasur zhvillime të konsiderueshme të mëtutjeshme që prej lansimit të tij.

### Organet menaxhuese

Sipas Kushtetutës së Kosovës, **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** dhe **Këshilli Prokurorial i Kosovës** janë përgjegjës për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Përbërja e tyre dhe procedurat e emërimit janë përgjithësisht në pajtim me standardet evropiane.

Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ende ka nevojë të përafrohet me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, sipas të cilave shumica e anëtarëve të tij duhen zgjedhur nga të njëjtët. Derisa Këshilli Prokurorial ka miratuar të gjitha rregulloret e brendshme, Këshilli Gjyqësor i mungojnë kapacitetet për të krijuar kushtet për zbatimin e ligjeve të pakos së drejtësisë të korrikut 2015. Buxheti i alokuar për të dy Këshillat është rritur gjatë periudhës së raportimit. Mbledhjet e të dy Këshillave janë të hapura edhe për mediat edhe për publikun. Të dy Këshillat publikojnë raportet vjetore në internet, por mekanizmat e tyre të raportimit prapë kanë nevojë për përmirësim.

Në pajtim me marrëveshjen e drejtësisë të vitit 2015 mes Beogradit dhe Prishtinës, Presidenti ka emëruar 40 gjyqtarë serbë, 13 prokurorë si dhe stafin përkatës mbështetës me një dekret të tetorit 2017. Ata filluan punë pak kohë pas tij. Prokurorët u caktuan në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, si dhe gjyqtarët në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, si dhe në divizionin e Gjykatës së Apelit. Kjo përmbyll procesin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës brenda sistemit gjyqësor të Kosovës. Nevojiten përpjekje shtesë për të siguruar qasjen në procedura gjyqësore në gjuhën shqipe dhe serbe në të gjithë Kosovën, si dhe përdorimin e të dyja gjuhëve në punën e organeve gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese funksionon në prag të kuorimit, me 1 vend të lirë të gjyqtarit kushtetues për muaj me radhë, ndërsa 3 pozita do të lirohen më 2018.

### Pavarësia dhe paanshmëria

**Masat mbrojtëse** ligjore për pavarësinë dhe paanshmërinë janë të përlidhura në Kushtetutë dhe kornizën ligjore. Gjyqtarët nuk mund të transferohen pa pëlqimin e tyre. Këshillat duhet të themelojnë një mekanizëm për reagim më efikas dhe më aktiv në rastet e ndërhyrjeve të pohuara politike në gjyqësor.

Sistemi i **caktimit të rasteve** funksionon mirë si dhe menaxhohet me hedhje të shortit. Rastet urgjente caktohen nga kryetarët e gjykatave. Rastet e profilit të lartë dhe ato të ndjeshme nuk procedohen gjithmonë me kohë nga gjyqtarët që caktohen t'i gjykojnë.

Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial janë përgjegjës për ndërmarrjen e masave mbrojtëse për të mundësuar sigurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Aspektet teknike të mbrojtjes trajtohen nga policia. Gjatë periudhës së raportimit, 3 prokurorëve iu është caktuar mbrojtja e afërt për shkak të kërcënimeve që kanë marrë për rastet që hetojnë.

## Llogaridhënia

**Kodet etike** janë në fuqi për gjyqtarë, prokurorë e avokatë, por implementimi efektiv mbetet e dobët. **Procedurat disiplinore** janë në fuqi, por përballen me vonesa të gjata dhe janë vërtetuar të mos jenë efikase. Ligji i ri për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që siguron mekanizma më solidë disiplinorë, me afate rigorozë e ndarje të qartë të kompetencave e përgjegjësi, ende nuk është miratuar. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shkarkohen nga Kryetari, me propozimin e Këshillit Gjyqësor apo Prokurorial për një numër veprash penale dhe disiplinore. Ata kanë të drejtë ankese.

Më 2017, 7 raste ndaj gjyqtarëve dhe 9 raste ndaj prokurorëve janë parashtruar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor në Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial. Këshillat kanë vendosur një numër masash disiplinore. Nuk ka pasur shkarkime të gjyqtarëve apo prokurorëve.

Gjyqtarët dhe prokurorët janë të obliguar me ligj që të **deklarojnë pasuritë e tyre** si dhe dhuratat e pranuar, por edhe të raportojnë ndonjë konflikt të mundshëm të interesit tek Agjencia Anti-Korrupsion. Më 2017, të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët kanë dorëzuar deklaratimet e tyre të pasurisë me kohë.

## Profesionalizmi dhe kompetenca

Presidenti i Kosovës **emëron** gjyqtarët dhe prokurorët për një mandat fillestar trevjeçar, pas propozimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, respektivisht Prokurorial i Kosovës. Procesi i rekrutimit dhe provimet hyrëse për gjyqtarë dhe prokurorë organizohen nga Këshilli Gjyqësor, respektivisht Prokurorial, si dhe formalisht janë të bazuara në merita. Megjithatë, rekrutimi i gjyqtarëve në periudhën e raportimit ka hedhur dyshime për drejtësinë e procesit, pasi që rregullat janë ndryshuar në mes të procesit të përzgjedhjes. Pas kritikave, procesi u anulua dhe u përsërit. Procesi më i vonshëm për kryetarin e Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit gjithashtu ka ngritur brenga në këtë drejtim. Pas dy vendimeve nga Gjykata Kushtetuese, Këshilli Gjyqësor ndryshoi rregulloren për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave në korrik të vitit 2017, për të qenë në përputhje me parimet e meritokracisë dhe transparencës. Procesi vijues i përzgjedhjes së gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve të gjykatave shfaqti përmirësim. Sistemi i rekrutimit duhet të bëhet plotësisht transparent dhe i bazuar në merita. Njësia e vlerësimit dhe verifikimit në Këshillin Gjyqësor operon pa një bazë të qartë ligjore. Kjo është brengë e posaçme, pasi që njësia ka ndikim të thellë në proceset e përzgjedhjes, si dhe ndërhyr në masë të madhe në jetën private të gjyqtarëve.

Kriteret e punës së bazuar në merita dhe sistemi i vlerësimit janë në fuqi. Këshilli Gjyqësor miratoi rregulloren për vlerësimin e punës së gjyqtarëve në prill të vitit 2017. Këshillat janë të obliguar të kryejnë **vlerësimin e punës** së gjyqtarëve dhe prokurorëve me mandat të përhershëm çdo tre vjet, por kjo është përballur me vonesa në Këshillin Gjyqësor. Këshilli Prokurorial ka vlerësuar 81 prokurorë, ndërsa Këshilli Gjyqësor ka vlerësuar 66 gjyqtarë më 2017. Deri më sot, shumica e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë kaluar vlerësimin. Niveli i **profesionalizmit dhe kompetencës**, sidomos tek prokurorët, është ende çështje brengosëse; disa kanë trajnim jo adekuat, ndërsa disa nuk kanë vullnetin të aplikojnë trajnimin e ndjekur dhe për të marrë përgjegjësi të plotë për rastet e tyre. Ende nuk ka ndonjë sistem të zbatuar ku gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen një vlerësimi efektiv e sistematik, të bazuar në kriteret të qarta dhe ku rezultatet shënohen në rrugën e tyre të karrierës.

## Cilësia e drejtësisë

Në shkurt 2017, Akademia e Drejtësisë u bë pasardhëse e Institutit Gjyqësor. Ajo është përgjegjëse për ofrimin e **trajnimit** fillestar dhe atij të vazhdueshëm për gjyqtarë e prokurorë, si dhe stafin ligjor dhe administrativ gjyqësor. Trajnimi bazohet në kurrikulat vjetore të trajnimit, të përgatitura bashkërisht nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial, si dhe Akademia, pas një vlerësimi gjithëpërfshirës nevojash: Akademia gjithashtu ka përgatitur një program trajnues orientimi për gjyqtarët dhe prokurorët serbë të sapoemëruar. Pas emërimit, gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen një trajnimi fillestar prej 12 muajsh.



Buxheti i ndarë për Akademinë e Drejtësisë është rritur me 16% nga viti 2016 në vitin 2017. Trajnimi i vazhdueshëm mbetet i domosdoshëm, sidomos në fushat e specializuara si krimet ekonomike, konfiskimi, prokurimi publik dhe dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë ngacmimin seksual. Edukimi gjyqësor duhet të ketë rol më të dukshëm në procesin e vlerësimit.

Më 2017, Kosova rekrutoi 52 gjyqtarë të rinj, duke e çuar numrin e përgjithshëm të tyre në 403, pas një numri dorëheqjesh, pensionimesh dhe rekrutimesh të pakta në vitet e kaluara. Njëzet e një prokurorë të rinj janë dekretuar në janar të vitit 2018, duke e çuar numrin e përgjithshëm në 198. Tashmë janë 22.6 gjyqtarë dhe 11.1 prokurorë për 100 000 banorë. Sipas CEPEJ-it, mesatarja evropiane është 21 gjyqtarë/11 prokurorë për 100 000 banorë.

**Buxheti i përgjithshëm për gjyqësorin** ishte 46.4 milionë Euro më 2017 (42.7 milionë më 2016) ose 2.32 % të buxhetit të përgjithshëm (2.38 % më 2016).

**Veglat e E-drejtësisë** mbeten pak të zhvilluara, si dhe sistemet e reja të TI-së në institucionet e ndryshme të sektorit të drejtësisë janë zhvilluar në mënyrë të fragmentuar, pa ndonjë strategji të përgjithshme apo monitorim të bashkërenduar. Strategjia e TI-së për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ka skaduar më 2017. Ekziston një mekanizëm përcjellës për rastet e nivelit të lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar, i cili aktualisht përfshin 42 raste, si dhe duhet zgjeruar për të përfshirë të gjitha rastet e tilla të korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel të lartë. Përgatitjet për themelimin e sistemit informativ për menaxhimin e rasteve kanë vazhduar, por me vonesa. Ka nevojë për përkushtim më të madh në sigurimin e implementimit me kohë të sistemit në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë. Puna në regjistrin qendror të dosjeve penale ka filluar së voni, si dhe duhet të përfundojë sa më shpejt që është e mundur. Duhet bërë më shumë përpjekje për të vendosur sisteme të besueshme statistikore për gjyqësorin, në bazë të indikatorëve standardë të CEPEJ-it.

Masat për sigurimin e konsistencës së **jurisprudencës** janë të kufizuara, si dhe duhen përforcuar. Vendimet shpesh nuk janë të qasshme në versionin elektronik. Databaza e legjislacionit me jurisprudencë në internet, bashkë me komentaret ligjorë për të ndihmuar gjyqtarët dhe prokurorët, themeluar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës është ende në dispozicion përmes faqes së internetit. Megjithatë, Instituti është pasur nga Akademia e Drejtësisë dhe databaza nuk është përditësuar. Ajo duhet të jetë lehtësisht e qasshme dhe vazhdimisht e përditësuar, si dhe të promovohet mes praktikuesve juridikë. Kjo mbetet sidomos relevante për publikimin e vendimeve të Gjykatës Supreme.

Sistemi i **ndërmjetësimit** ka qenë në funksion që nga viti 2008. Megjithatë, ai vuan nga kompensimi i dobët dhe mungesa e financimit, gjë që ka sjellë deri tek mbyllja e 3 nga 7 qendrave rajonale të ndërmjetësimit. Vetëdija publike apo njohuritë për mjetet e **zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve** mbeten të dobëta, por numri i rasteve të referuara dhe të zgjidhura është rritur deri në rreth 1600 më 2017. Edhe sistemi i ndërmjetësimit edhe ai i noterisë duhen përforcuar më tutje.

#### Efikasiteti

Kosova ende ka nevojë të jetë më efikase në përballje me **rastet e prapambetura**. Gjykatat përballen me një numër të lartë të rasteve penale në ardhje, shumica e të cilave janë raste të kundërvajtjeve. Kjo gjë rrezikon që gjykatat të mos arrijnë që t'i kushtojnë vëmendjen e domosdoshme rasteve të profilit të lartë dhe serioze. Sistemi gjyqësor duhet të sigurojë vazhdimësinë e duhur të të gjitha rasteve të profilit të lartë, duke përfshirë rastet e dorëzuara nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX).

Efikasiteti i gjyqësorit pengohet në masë të madhe nga mangësitë në legjislacionin penal. Shumë dispozita në Kodin e Procedurës Penale janë tejet të ndërlikuara dhe formaliste, duke mos lejuar hetim e ndjekje penale solide e të suksesshme. Ato duhen ndryshuar e plotësuar (për shembull afati i paraparë me ligj për hetimin e rasteve). Përveç këtyre, kapaciteti i dobët dhe përkushtimi i dobët i

disa gjyqtarëve për të menaxhuar procedurat gjyqësore, për të sanksionuar palët që shkaktojnë vonesa dhe për të siguruar praninë e të gjitha palëve në seanca çojnë drejt shtyrjeve të shumta të seancave dëgjimore dhe procedurave penale të tejzgjatura pa arsye. Këto aspekte, si dhe prirja e Gjykatës së Apelit që të kthejë rastet në rigjykim tek gjykatat themelore kontribuojnë drejt një **afati të zgjidhjes** mesatarisht të gjatë (pra koha mesatare prej ngritjes së aktakuzës e deri tek aktgjykimi). Këto vonesa në procedura, kombinuar me preferencën për paraburgim kundrejt masave të tjera të sigurimit, kanë çuar drejt rasteve me periudha tejet të gjata të paraburgimit.

Organizimi i gjykatave dhe alokimi i resurseve mbetet tek kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive. Sipas nevojës, gjyqtarët dhe prokurorët mund të transferohen përkohësisht. Kjo është vërtetuar të jetë vegël efektive për të mbështetur gjykatat dhe prokuroritë me mungesë stafi. Numri i punëtorëve ligjorë që ndihmojnë gjyqtarët dhe prokurorët konsiderohet i pamjaftueshëm.

### Trajtimi vendor i krimeve të luftës

Departamenti për **krime lufte** në Prokurorinë Speciale të Kosovës po vazhdon punën e tij, edhe pse sfidat mbeten. Ngarkesa e punës së kësaj Prokurorie është rritur në masë të konsiderueshme, për shkak të tkurrjes dhe dorëzimit të rasteve nga EULEX-i tek prokurorët vendorë. Ka nevojë akute për më shumë trajnime, më shumë personel, si dhe më shumë kapacitete përkthimi. Gjithashtu, mungesa e dosjeve të plota të krimeve të luftës, numri i vogël i prokurorëve (dy) që punojnë me krime lufte, si dhe bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet prokurorive të Kosovës dhe Serbisë, po rrezikojnë qasjen në drejtësi, duke përfshirë atë për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhur me konfliktin. Në rastet kur të dyshuarit janë serbë etnikë, që banojnë kryesisht në Serbi, bashkëpunimi i ndërsjellë juridik me Serbinë mbetet efektivisht i paqenë. Kjo vlen për rastet kur prokuroria e Kosovës përpiqet të hetojë, si dhe rastet kur prokuroria e Serbisë përpiqet të hetojë. Mbetet brenga të konsiderueshme në lidhje me vullnetin për të hetuar, ndjekur e gjykuar krimet e luftës me ish-pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Trajtimi i vazhdueshëm preferencial i kriminelëve të dënuar të luftës në burgjet e Kosovës rrezikon të ndikojë tek vullneti i dëshmitarëve për të bashkëpunuar në hetime. Edhe falja së voni e tre ish-pjesëtarëve të UÇK-së nga Presidenti ka ngritur brenga serioze.

Dhomat e Specializuara të Kosovës, që duhet të gjykojnë pohimet për **krime ndërkombëtare** të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, siç përshkruhen në raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës të vitit 2011, janë themeluar. Në dhjetor të vitit 2017, 43 Deputetë të Kuvendit, që i përkasin kryesisht koalicionit qeverisës, morën një nismë për të shfuqizuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar. Kjo nismë, që nxiti reagime të menjëhershme, të forta e negative nga bashkësia ndërkombëtare dhe mediat e shoqëria civile e Kosovës, shkaktoi brenga të mëdha në lidhje me përkushtimin e liderëve politikë të Kosovës për të ndjekur penalisht e gjykuar krimet e lartpërmendura dhe për të respektuar obligimet përkatëse ndërkombëtare të Kosovës.

Në nëntor të vitit 2017, qeveria themeloi sekretariatit e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës dhe ndau resurset buxhetore për pensionet e viktimave. Që prej shkurtit 2018, viktimat mund të aplikojnë për njohje dhe verifikim, për të marrë beneficionet individuale. Periudha kohore e ligjit në fjalë përjashton ata që kanë përjetuar dhunë seksuale të ndërlidhur me konfliktin pas 20 qershorit 1999.

Grupi Punues Ndërmintor për Përballjen me të Kaluarën dhe Pajtimin, themeluar për t'u marrë me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe të drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë konfliktit të Kosovës, ka dështuar të hartojë strategjinë për drejtësinë tranzicionale dhe efektivisht ka ndalur punën. Presidenti i Kosovës ka iniciuar themelimin e një Komisioni për të Vërtetën dhe Ripajtimin. Autoritetet duhet të krijojnë një qasje gjithëpërfshirëse për ballafaqimin me të kaluarën, duke e lidhur punën e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimin me zotimin e qeverisë për një strategji për ballafaqimin me të kaluarën dhe nismat tjera të drejtësisë tranzicionale. Këto procese duhet të kenë pronësi lokale e shtetërore, si dhe të jenë përfshirëse, të ndjeshme ndaj gjinive dhe viktimave.

## Lufta ndaj korrupsionit

Kosova është **në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje** në luftën kundër korrupsionit. Në periudhën e raportimit, është arritur **pak progres** në krijimin e një regjistri të vazhdueshëm rastesh të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të nivelit të lartë, përfshirë këtu edhe dënimet e plotfuqishme. Është arritur progres edhe në konfiskimin preliminar të pasurive, edhe pse konfiskimi përfundimtar mbetet i ulët. Korrupsioni është gjerë i përhapur, si dhe mbetet çështje brengosëse. Nevojiten orvatje të përbashkuara për të përballur këtë problem në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike. Pasi që rekomandimet e raportit 2016 janë adresuar vetëm pjesërisht, ato mbeten të vlefshme. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Me qëllim të vazhdimin të progresit në këtë regjistër rastesh, të rrisë numrin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale, të cilët hetojnë dhe ndjekin penalisht rastet e korrupsionit në nivel të lartë, si dhe të ofrojë trajnime për përfundimin e kapaciteteve të tyre në hetime financiare, konfiskim të pasurive, si dhe mbrojtje efektive të dëshmitarëve;

→ Të ndryshojë kornizën ligjore (për pezullimin dhe largimin e zyrtarëve publikë nën aktakuzë dhe të dënuar për korrupsion, për deklarimin e pasurive, si dhe për sinjalizuesit) për ta përafëruar atë me standardet evropiane;

→ Të sigurojë që raportet financiare dhe raportet e fushatave të partive politike të publikohen e të auditohen vazhdimisht, si dhe të aplikohen sanksionet ndaj shkeljeve të ligjeve përkatëse. Të ndryshojë kornizën ligjore që rregullon financimin e partive politike dhe financimin e fushatave në bazë të mendimit të Komisionit të Venecias për të siguruar zbatim efektiv, llogaridhënie e transparencë.

### Regjistri i rasteve

Pas themelimit më 2015 të një ekipi multidisiplinor për bashkërendimin efektiv të përpjekjeve për t'u përballur me **rastet e korrupsionit dhe rastet e krimit të rëndë dhe të organizuar në nivel të lartë**, 42 hetime kanë rezultuar me 31 aktakuza, nga të cilat 24 për korrupsion dhe 7 për krim të organizuar, duke përfshirë një numër zyrtarësh politikë dhe të lartë publikë. 7 dënime janë dhënë për veprat e lidhura me korrupsionin. Mekanizmi përcjellës TI duhet zgjeruar për të përfshirë të gjitha rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar në nivel të lartë, për të pasur një regjistër universal përcjellës të hetimeve, ndjekjes penale, dënimeve të plotfuqishme dhe konfiskimeve të pasurive kriminale.

**Konfiskimi i aseteve** është rritur, por konfiskimet përfundimtare mbeten të ulëta. Gjatë periudhës së raportimit, 26 835 asete me vlerë prej afro 11 milionë eurosh janë ngrirë e sekuestruar, derisa 25 asete janë konfiskuar përfundimisht, me vlerë të përafërt të afërt me 1.9 milionë euro.

Që prej themelimit, **Agjencia Anti-Korrupsion** ka dërguar më se 700 raste në prokurori. Në bazë të më shumë se 80 referimeve më 2017, prokuroria ka ngritur aktakuza në më pak se 30 raste. Raportet që Agjencia dorëzon në prokurori duhet të jenë me cilësi më të mirë ndërsa prokuroria duhet të rrisë kapacitetet dhe vullnetin për të ndjekur rastet.

Më 2017, nga 4 498 zyrtarë të obliguar të dorëzojnë **deklarimet vjetore të pasurisë**, vetëm 77 (më pak se 2 %) nuk e kanë bërë këtë. Agjencia Anti-Korrupsion ka dërguar 50 raste ndaj 50 personave për ndjekje penale. Shumica kishin të bënin me mosraportimin apo raportimin e rrejshëm të pasurive, pronave të luajtshme mbi 3000 Euro, si dhe posedimin e aksioneve në kompani komerciale dhe të ardhurat. Agjencia ende nuk ka veglat dhe resurset për të verifikuar deklarimet e pasurisë. Këto kontrolle do të kërkonin bashkëpunim më të afërt dhe këmbim të dhënash me policinë, administratën tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, regjistrin e tokave dhe autoritetet komunale.

Më 2017, Agjencia ka trajtuar më se 150 raste të **konflikteve të interesit**, prej të cilëve, më pak se 5 raste janë dorëzuar për procedurë të kundërvajtjes, si dhe më pak se 5 raste janë dërguar në

prokurori për hetime penale. Në më shumë se 100 raste, konflikti i interesit është parandaluar, ose Agjencia i ka dhënë mendim institucioneve përgjegjëse. Shumica e rasteve kishin të bënin me zyrtarë të pushtetit lokal.

Më 2017, Agjencia trajtoi më se 40 raste të parandalimit të korrupsionit në **prokurim publik** si dhe nxori më shumë se 20 mendime, prej të cilave rreth 20 % nuk u morën parasysh.

Zyrtarët nga **veriu i Kosovës** nuk zbatuan obligimet e tyre në lidhje me dorëzimin e deklaramentit të pasurive tek Agjencia Anti-Korrupsion. Situata në veri të Kosovës, për sa i përket korrupsionit, përbën sfidë të posaçme për agjencitë ligjzbatuese.

Transparenca dhe llogaridhënia e financimit për parti politike dhe financim të fushatave duhen përforcuar. Raportet e financave të partive politike ende nuk publikohen me konsistencë dhe plotësisht, ndërsa fushatat zgjedhore parlamentare dhe lokale janë kryer pa ndonjë prezantim kuptimplotë financiar nga partitë. **Auditimet e pavarura të financave të partive politike** nga viti 2013 deri më 2016 janë kryer - me shumë vonesë - gjatë periudhës së raportimit. Auditorët gjetën që partitë politike kishin shuma të konsiderueshme të të ardhurave e shpenzimeve të paverifikueshme, shkelje të vazhdueshme të kontabilitetit financiar, kontrollit të brendshëm dhe standardeve të raportimit, si dhe shfaqnin raste të shkeljes së ligjeve tatimore dhe Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe autoritetet kompetente duhet të hetojnë dhe të sigurojnë që dispozitat ligjore të zbatohen efektivisht, si dhe që këto raporte auditimi të trajtohen siç duhet, në përputhje me dispozitat dhe sanksionet e ligjit. Partitë politike duhet të dorëzojnë raportet e tyre financiare për vitin 2017 deri në afatin ligjor, e pastaj këto të auditohen në kohën dhe mënyrën e duhur.

Përtej vlerësimeve të kryera për të përcaktuar rrezikun e korrupsionit – të cilat vlerësojnë dobësitë e tërësisë ligjore/institucionale të sektorëve të ndryshëm – në sektorët e shëndetësisë, arsimit, energjisë dhe minierave, janë kryer edhe vlerësimet e rrezikut të korrupsionit në prokurimin publik, sistemin gjyqësor dhe prokurorial. Duhet ndërmarrë hapa për të adresuar efektivisht korrupsionin në këta sektorë posaçërisht të cenueshëm. Ende nuk ka politika për parandalimin e korrupsionit në sektorin privat.

### Korniza institucionale

Institucionet anti-korrupsion në KOsovë nuk janë mirë të integruara, mandatet e tyre ndërthuren, ndërsa ndarja e detyrave duhet sqaruar. Kosova duhet të përforcojë mekanizmat dhe trupat e bashkërendimit ndërinstitutionalë, si dhe të sigurojë që institucionet kanë qasje në databazat relevante (p.sh. prokurimi).

### *Masat e parandalimit*

Organi kryesor për parandalim mbetet **Agjencia Anti-Korrupsion**, e pavarur dhe e specializuar. Ajo ka për detyrë të ndërmarrë hetime administrative, të kontrollojë deklaramentet e pasurisë, të monitorojë konfliktet e interesit si dhe aktivitetet e prokurimit publik, si dhe të rrisë vetëdijen. Trupat tjerë me autorizime inspektuese dhe audituese janë Auditori i Përgjithshëm, autoritetet tatimore dhe ato doganore, si dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.

### *Zbatimi i Ligjit*

Kosova ka institucione të specializuara për luftimin e korrupsionit: Koordinatorin Nacional për Krime Ekonomike, Koordinatorin Anti-Korrupsion emëruar nga Kryeprokurori i Shtetit dhe Drejtoria e Policisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, që ka edhe njësitë anti-korrupsion në stacione policore dhe në zyrën qendrore. Secila prokurori themelore ka një prokuror anti-korrupsion, si dhe dy prokurorë janë emëruar nga Prokurori Special për të marrë rastet e korrupsionit në nivel të lartë. Këto raste trajtohen nga departamentet e Krimeve të Rënda në Gjykatat Themelore të Kosovës.

Hetimet dhe aktakuzat duhet të kenë cilësi më të lartë, si dhe rastet duhen prezantuar më mirë para gjykatave. Prokuroria Speciale nuk ka staf të mjaftueshëm të specializuar me nivelin e duhur të trajnimit dhe kompetencës për t'u marrë me rastet financiare, duke përfshirë ato të prokurimit për të rritur numrin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit në nivel të lartë, është miratuar Ligji i ndryshuar për Prokurorin e Shtetit. **Hetimet financiare** ende nuk inician sistematikisht në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kosova duhet të aplikojë konceptin e hetimeve financiare në pajtim me standardet e Task-Forcës Vepruese Financiare (FATF). Policia, prokurorët dhe gjyqtarët duhet të vazhdojnë të marrin trajnime të specializuara për luftën ndaj korrupsionit, duke përfshirë konfiskimin e aseteve dhe shpëlarjen e parave.

### Korniza ligjore

Dispozitat e të drejtës penale mbi korrupsionin janë përgjithësisht në pajtim me standardet relevante evropiane, ku përjashtim bëjnë dispozitat për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, të cilat janë tejet të rënda dhe të ndërlikuara të përdoren, si dhe përmbajnë afate paarsyeshëm të shkurtra për hetime. **Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave** është rishikuar, për ta përafuar më shumë me standardet evropiane. Legjislacioni që e bën të detyrueshëm **pezulimin dhe largimin e zyrtarëve publikë nën aktakuzë, respektivisht të dënuar për korrupsion** ende nuk është miratuar.

Rishikimi gjithëpërfshirës i **legjislacionit aktual për financimin e partive politike** duhet të kryhet në bazë të konsultimeve të gjera publike dhe në pajtim me praktikën dhe standardet e mira ndërkombëtare, sidomos ato të Komisionit të Venedikut. Rishikimi i tillë duhet të synojë të sigurojë transparencën, llogaridhënien dhe zbatimin efektiv, si dhe duhet të definojë sanksionet.

Kosova duhet të ndërmarrë masa që mundësojnë hetimin efektiv të **pasurisë së paarsyetuar**. Ende nuk ka sistem efikas të vendosur për **deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë** si dhe **deklaimin, prejardhjen dhe kontrollimin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë**. Ndryshimet në të dy ligjet duhen finalizuar ashtu që t'i jepen Agjencisë Anti-Korrupsion kompetenca më solide për të verifikuar deklaratimet e pasurisë, si dhe për ta bërë sistemin e deklarimit më efektiv ndaj rryshfeteve. Ndryshimi i legjislacionit kërkohet për të mundësuar zhvendosjen e barrës së dëshmisë për konfiskimin e aseteve, duke e ndarë veprën e shpëlarjes së parave nga vepra predikate (veprimi penal paraprak që ka krijuar paratë për shpëlarje) si dhe duke ndaluar bartjen e aseteve kriminale tek palë të treta.

Ligji aktual për mbrojtjen e informatorëve ende nuk është përafuar me standardet ndërkombëtare. Mekanizmat e **sinjalizimit** dhe masat mbrojtëse duhen përforcuar në ligj dhe në praktikë.

### Korniza strategjike

Financimi joadekuat në masë serioze ka penguar implementimin e **strategjisë anti-korrupsion 2013-2017** si dhe planit të rishikuar anti-korrupsion për shërbimin prokurorial. Ato nuk kanë pasur tregues të matshëm të ndikimit. Edhe pse planet e veprimit janë vendosur për luftimin e korrupsionit në sektorë të ndjeshëm, si dogana, policia dhe administrata tatimore, në praktikë është arritur pak.

Strategjia dhe plani i veprimit kundër korrupsionit 2018-2022 janë hartuar pas një procesi konsultativ, si dhe janë miratuar në mars të vitit 2018. Qeveria ende ka nevojë të demonstrojë lidhshmëri të vërtetë, aftësi për të praktikuar planifikim paraprak, si dhe vullnet për të ndarë resurse adekuate për luftën ndaj korrupsionit. Kredibiliteti i saj do të varet nga resurset e ndara për implementimin e tyre. Duhet themeluar edhe një mekanizëm monitorues për të vlerësuar rregullisht ndikimin e strategjisë dhe planit të veprimit.

## Të drejtat themelore

Korniza ligjore gjerësisht garanton mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore në përputhje strategjive dhe legjislacionit për të drejta të njeriut shpesh dobësohet nga resurset joadekuate financiare dhe të tjera, sidomos në nivelin lokal, prioritetet politike të kufizuara dhe mungesa e bashkërendimit.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të ripërtërijë Grupin Koordinues Ndërmintrosor për të Drejta të Njeriut, si organi kryesor koordinues për të drejta të njeriut, si dhe të ripërtërijë Komisionin Ndërmintrosor për Kthim dhe Çështje të Komuniteteve për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit për të drejta të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që i përkasin pakicave dhe personave të zhvendosur;

→ Të fuqizojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe strategjisë dhe planit të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje;

→ Të sigurojë që korniza ligjore për të drejtat e fëmijëve të zbatohet plotësisht; për projektligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, të parashohë një linjë buxhetore, të sigurojë llogaridhënien e mirëfilltë të institucioneve dhe aktorëve relevantë, si dhe integrimin e sistemeve të mbrojtjes së fëmijëve në nivelin qendror dhe atë lokal;

→ Të avancojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore duke zbatuar plotësisht ligjet që trajtojnë ndërtimet e paligjshme. Të miratojë ligjin për Trashëgimi Kulturore dhe Liri Fetare, si dhe të sigurojë funksionimin aktiv të Këshillit për Zbatim e Monitorim;

**Instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut** përbëjnë pjesë integrale të kornizës ligjore të Kosovës, si dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme, siç parashihet edhe me Kushtetutën e Kosovës. Kosova ka vazhduar të përafrojë legjislacionin e saj me këto instrumente, si dhe ka vazhduar praktikën e raportimit ad-hok.

Tek **promovimi dhe zbatimi i të drejtave të njeriut**, implementimi efektiv i ligjeve për të drejtat e njeriut mbetet sfidues. Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë nuk ka resurset dhe kapacitetet e nevojshme për të menaxhuar barrën e vet të punës në mënyrë efektive. Si pasojë, nuk ka arritur të përmbushë detyrimet e veta të monitorimit dhe koordinimit për një numër strategjish për të drejtat e njeriut, si dhe nuk ka qenë në gjendje të monitorojë implementimin e rekomandimeve nga Zyra e Avokatit të Popullit. Autoritetet duhet të vlerësojnë kapacitetet institucionale të Zyrës Këshilluese dhe të vlerësojnë se si mund të plotësojë nevojat e saj, ashtu që të përmbushë mandatin plotësisht. Grupi Koordinues Ndërmintrosor për të Drejta të Njeriut, themeluar në maj të vitit 2016, si organi kryesor koordinues për të drejta të njeriut, ka mbajtur mbledhjen e parë dhe të vetme në shkurt të vitit 2017. Nevojitet një lidhshmëri më e fortë politike për të siguruar që Grupi të përmbushë mandatin e tij. Nuk ka pasur ndonjë përparim të konsiderueshëm në hartimin e ndonjë strategjie mbizotëruese për të drejtat e njeriut, që inkorporon dymbëdhjetë strategjitë që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Sa i përket **parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit**, gjendja mbetet përgjithësisht e kënaqshme, si dhe ka përkushtim të vazhdueshëm nga autoritetet e Kosovës në parandalim të praktikave të tilla në të gjitha rrethanat. Megjithatë, janë parashtruar një numër ankesash e pretendimesh në lidhje me trajtimin jokorrekt të të burgosurve nga personeli korrektues. Pas themelimit të Mekanizmit Nacional Parandalues kundër Torturës më 2016, stafi përkatës në Institucionin e Avokatit të Popullit është trajnuar gjerësisht dhe ka filluar shqyrtimin dhe hetimin e ankesave të pranuar. Kosova duhet që më tutje të përforcojë përpjekjet e vazhdueshme për të ofruar përkrahje adekuate mjekësore e psikologjike dhe rehabilitim për të gjitha viktimat e torturës dhe keqtrajtimit të tjera në Kosovë. Ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme në adresim të rekomandimeve që janë nxjerrë nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimit Çnjerëzor apo Degradues (shih *sistemi i burgjeve*).

Tek **sistemi i burgjeve**, ka vazhduar përputhshmëria me Rregullat Standarde Minimale të OKB-së për Trajtimin e të Burgosurve, si dhe Rregullat Evropiane të Burgjeve. Kushtet materiale dallojnë në masë të madhe mes institucioneve të ndryshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Mbipopullimi përgjithësisht nuk është problem. Megjithatë, nivelet joadekuate të personelit mbesin brengosëse. Ka mungesë të aktiviteteve kuptimplote për të burgosur, siç është puna dhe programet tjera rehabilituese. Përpjekjet për të themeluar një sistem menaxhues të integruar të dënimeve me përqendrim tek të burgosurit duhet të vazhdojnë. Nuk ka pasur progres në adresimin e brengave tek vendosja e të paraburgosurve me të dënuarit me burg në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Ka filluar puna në rishikimin e Ligjit për Procedura Disiplinore dhe Masat për të Burgosur, në përputhje me standardet ndërkombëtare të burgjeve. Është vërejtur përparim i dukshëm tek transferimi i shërbimit shëndetësor në burgje nga Ministria e Drejtësisë tek Ministria e Shëndetësisë. Presionet dhe ndërhyrjet politike vazhdojnë të ndikojnë procesin e vendim-marrjes për kategorizimin e të burgosurve. Kjo mundëson trajtimin preferencial, si dhe e bën më të lehtë pezullimin e dënimeve për të burgosur të profilit të lartë. Autoritetet duhet të sigurojnë rekrutimin me bazë në merita për pozitat e niveleve të larta në Shërbimin Korrektues.

Nuk është arritur progres gjatë periudhës së raportimit tek **mbrojtja e të dhënave**. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vazhdon të ketë udhëheqësi të përkohshme. Që prej vitit 2016, kur kishte skaduar mandati i të pesë mbikëqyrësve për mbrojtjen e të dhënave, aktivitetet e Agjencisë kanë mbetur të kufizuara. Kjo lidhet *inter alia* me monitorimin e respektimit të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe me kryerjen e inspektimeve. Ligji për mbrojtjen e të dhënave duhet ndryshuar për të adresuar mangësitë në sistem, si dhe për ta përafuar më tutje me kornizën e re evropiane për mbrojtjen e të dhënave.

Dispozitat ligjore për **lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë** janë të vendosura, si dhe të gjithë prijësit e të gjitha feve vazhdojnë të ndërveprojnë. Megjithatë, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Liritë Fetare duhet të miratohet dhe të përfshijë edhe rekomandimet e Komisionit të Venedikut. Seminari Ortodoks Serb në Prizren vazhdon të funksionojë mirë. Në maj të 2016-ës, Gjykata Kushtetuese nxori aktgjykimin përfundimtar për rastin e kontestit pronësor mes Manastirit të Deçanit dhe komunës së Deçanit dhe konfirmoi pronësinë ligjore të manastirit mbi tokën. Megjithatë, aktgjykimi mbetet i pazbatuar, si dhe rezistenca lokale, duke përfshirë edhe mohimin e qartë nga zyrtarët komunalë, vazhdon të ngrejë brenga. Në shtator të vitit 2017, Gjykata e Apelit konfirmoi hedhjen poshtë të padisë së vitit 2015 nga Gjykata Themelore e Prishtinës, padi e ngritur nga Universiteti i Prishtinës më 2012, ku kërkohet rrënim i kishës së papërfunduar të Krishtit Shpëtimtar dhe bartjen e tokës prapa tek universiteti. Autoritetet komunale në Prishtinë kanë ndarë tokën për varrezat e pjesëtarëve të komunitetit protestant. Ato duhet të vazhdojnë të demonstrojnë respektim të plotë të të drejtave të bashkësive fetare, siç parashihet me ligj.

## **Liria e shprehjes**

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** në fushën e lirisë së shprehjes. **Nuk ka pasur progress** në këtë fushë gjatë periudhës së raportimit. Liria e shprehjes është e paraparë me Kushtetutë dhe Kosova gëzon një ambient plural dhe të gjallë medial. Megjithatë, kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve kanë vazhduar, ndërsa zhvillimet në tema të tjera kryesisht kanë stagnuar. Kuvendi ka treguar një përkushtim të kufizuar për të gjetur një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit publik, duke e lënë të cenueshëm ndaj presionit dhe ndikimit politik. Nuk ka pasur zhvillime legislative tek rregullimi i pronësisë dhe transparencës mediale. Mediat kanë filluar publikimin e impresumit (të dhënat e botuesit). Implementimi i legjislacionit mbetet sfidues, sidomos i ligjit për transmetuesit publik. Kosova ka bërë pak në adresimin e rekomandimeve të vitit 2016.

Pasi që rekomandimet e raportit 2016 nuk janë adresuar, ato mbeten të vlefshme. Në vitin vijues Kosova duhet që posaçërisht:

→ të sigurojë që rastet e sulmeve fizike ndaj gazetarëve dhe formave tjera të presionit të

hetohen menjëherë dhe të gjykohen nga gjyqtarët;

→ të sigurojë një zgjidhje të qëndrueshme financiare për transmetuesin publik;

→ të marrë masa për të mundësuar informatat transparente për pronësinë e mediave.

### Frikësimi i gazetarëve

Numri i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve është rritur. Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, vetëm në vitin 2017 janë raportuar 24 incidente, dyfishi i numrit të raportimeve në periudhën kalimtare. Mes rasteve, 2 kryeredaktorë kanë marrë kërcënime me vdekje, si dhe një gazetar që është sulmuar fizikisht në një rast të mëvonshëm është kërcënuar nga një deputet. Autoritetet kanë hapur hetimet e të gjitha këtyre rasteve, por përgjithësisht, këto hetime janë të ngadalshme dhe ka pasur vetëm dy dënime të plotfuqishme më 2017 në lidhje me kërcënimet dhe sulmet në vitet e kaluara. Nevojitet një reagim më sistematik, bashkë me hetimin e menjëhershëm dhe gjykimin me kohë, ashtu që të përforcohet mbrojtja e gazetarëve. Toleranca për kërcënimet apo sulmet ndaj mediave duhet të jetë zero.

### Mjedisi ligjor

Liria e shprehjes dhe mediet janë të garantuara me kushtetutë, ndërsa legjislacioni për shpifje, gjuhë të urrejtjes dhe fyerje është në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Megjithatë, korniza ligjore dhe institucionale në këtë fushë mbetet e fragmentuar dhe joefektive. E drejta e gazetarëve për kundërshtim të ndërjegjshëm dhe e drejta e publikut për përgjigje dhe korrigjim mbeten të parregulluara. Policia, prokurorët dhe gjyqtarët kanë nevojë për trajnime të mirëfillta për standardet e vendosura nga Këshilli i Evropës dhe Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut për trajtimin e burimeve dhe materialeve gazetareske. E drejta e qasjes në informata publike dëmtohet nga implementimi i fragmentuar i legjislacionit përkatës nga autoritetet.

### Implementimi i legjislacionit/institucionet

Implementimi i legjislacionit mbetet sfidues, sidomos i ligjit për transmetuesit publik. Edhe vendosja e standardeve etike po vërtetohet të jetë e vështirë. Komisioni i Pavarur për Media ende nuk ka filluar të bëjë përgatitjet për tranzicionin digjital. Ai monitoron përmbajtjen e mediave audio-vizuale, por ngec në inicimin e rasteve dhe implementimin e gjobave për shkeljet ligjore. Komisioni po përballlet me vështirësi në mbulimin e detyrimeve të tij financiare, duke përfshirë investimet kapitale.

As Komisioni i Pavarur për Media e as Këshilli i Mediave të Shkruara i Kosovës nuk monitorojnë lirinë e shprehjes në internet. Edhe pse kjo krijon një ambient të papenguar për mediat në internet, edhe dëmton privatësinë e individëve, duke shpjer drejt shumë rasteve të pohimeve për gjuhë të urrejtjes, shpifje dhe fyerje. Rastet e tilla duhen trajtuar thellësisht.

### Transmetuesi publik

Transmetuesi publik, Radio-Televizioni i Kosovës (RTK) mbetet i financuar drejtpërdrejt nga shteti. Kjo vazhdon të minojë pavarësinë e tij, të dobësojë qëndrueshmërinë e tij afatgjate, si dhe e lë të hapur ndaj ndikimeve politike. Kuvendi ende nuk ka gjetur zgjidhje të qëndrueshme financimi për RTK-në, ndërsa afati ligjor ka skaduar në prill të vitit 2015. Në tetor të vitit 2017, Kuvendi ka theksuar qëllimin e tij për të miratuar një ligj krejtësisht të ri për RTK-në, në bazë të një modeli evropian, por planet mbeten të paqarta. Zgjidhja për hapësirat punuese të transmetuesit publik ende nuk është gjetur. Bordi i RTK-së është i plotë, por performanca e tij duhet të përmirësohet. Numri i të punësuarve është rritur në vite, me procedura rekrutimi që kritikohen nga sindikatat e punëtorëve si jotransparente.



## Faktorët ekonomikë

Subjektet mediale përgjithësisht nuk janë ekonomikisht të qëndrueshme. Informatat për strukturat e pronësisë së mediave, sidomos për mediat në internet, mbesin të paqarta dhe shpesh fiktive, si dhe shumica e medieve nuk ofrojnë informata për financat apo pronësinë e tyre reale. Fakti që mediat kanë filluar publikimin e impresumit (të dhënat e botuesit) në fillim të vitit 2017 është megjithatë zhvillim pozitiv. Mungesa e industrisë së fuqishme private reklamuese i bën transmetuesit privatë të varur tek burimet tjera të financimit, si dhe pak prej tyre kanë gjasa të veprojnë pa lidhje të forta me grupet e interesave politikë e afaristë.

## Organizatave profesionale/kushtet profesionale

Shoqatat e gazetarëve në Kosovë kanë qenë aktive në dënimin e incidenteve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve. Ato kanë rritur edhe bashkëpunimin me Policinë e Kosovës dhe Prokuroritë për të përcjellë këto raste. Angazhimi i tyre në diskutimin e nismave ligjore për çështjet mediale mbetet i kufizuar. Shoqatat e gazetarëve mbeten kryesisht të ndara përgjatë vijave etnike, si dhe konsiderohen të dobëta. Gazetarët shpesh punojnë pa kontrata, gjë që i bën ata të cenueshëm ndaj korrupsionit dhe të prirur ndaj vetë-censurimit. Mbrojtja e standardeve profesionale në gazetari rregullohet me kode etike, por as Komisioni i Pavarur për Media e as Këshilli i Mediave të Shkruara nuk kanë ngritur ndonjë rast për shkelje të kodit.

**Liria e grumbullimit dhe asociimit** garantohet me Kushtetutë, si dhe qytetarët i kanë gëzuar këto të drejta duke demonstruar e protestuar kundrejt niveleve të ndryshme të qeverisjes. Individët dhe subjektet juridike kanë të drejtë të themelojnë shoqata pa pasur nevojë të regjistrojnë organizatën, por shumica e organizatave vendosin të regjistrohen për të fituar subjektivitet juridik.

Tek **të drejtat pronësore**, në nëntor të vitit 2016, ish-Agjencia Kosovare e Pronës, e mandatuar për zgjidhjen e kërkesave pronësore të lidhur me konfliktin, u transformua në Agjenci të Kosovës për Krahësim dhe Verifikim të Pronave (AKKVP). Strategjia për të drejtat pronësore u miratua në janar të vitit 2017, por implementimi mbetet joadekuat. Mbeten bregat në lidhje me mungesën e implementimit të skemës së kompensimit për pronarët e pronave banesore më parë në pronësi shoqërore e të prekura nga konflikti. Një çështje tjetër sfiduese është riuzurpimi i paligjshëm i pronave, pasi që Agjencia e Pronës nuk ka autorizim për të vepruar ndaj riuzurpimeve pas dëbimit të dytë. Avokati i Popullit ka rekomanduar ndryshimin e Ligjit për AKKVP-në për të siguruar përputhshmërinë e tij me Kushtetutën e Kosovës, standardet evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe për të mundësuar dëbime të shumëfishta të kryera nga Agjencia. Ekzistojnë edhe bregat të tjera në lidhje me transaksionet pronësore mashtruese dhe bartjet e paligjshme të pronësisë së pronave që kryesisht i përkasin personave të zhvendosur. Pas identifikimit të 350.000 ndërtimeve pa leje, qeveria po rishikon politikën e saj dhe Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Strategjia e shumëpritur për legalizimin e vendbanimeve joformale ende nuk është miratuar. Autoritetet komunale kanë arritur progres të kufizuar në miratimin e planeve trevjeçare të banimit social, duke i penguar kështu autoritetet qendrore në përmbylljen e një strategjie të nivelit të Kosovës për banimin social.

Sa i përket **mos-diskriminimit**, pak progres është shënuar, duke marrë parasysh që më 2017, Kosova ka miratuar Rregulloren për Mekanizmat Institucionalë për Mbrojtje nga Diskriminimi në Qeveri dhe Komuna. Kjo rregullore mëton të definojë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit përkatës në nivel qendror dhe komunal, si dhe të përkufizojë bashkërendimin e tyre, raportimin dhe bashkëpunimin me mekanizmat tjerë institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi. Mekanizmi përcjellës i Këshillit Prokurorial ende duhet të zgjerohet për të përfshirë rastet e të gjitha formave të diskriminimit, jo vetëm të atyre të bazuar në etni.

Korniza ligjore e Kosovës për **barazi mes grave dhe burrave** është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, gratë shpesh përballen me dhunë me bazë gjinore dhe diskriminim të lartë në tregun e punës, gjyqësor dhe polici. Gratë janë tejet dobët të përfaqësuara në vendim-marrje, qoftë në qeverinë qendrore ashtu edhe në komuna. Gratë gjithashtu vazhdojnë të

përballen me sfida në aspektin e pronësisë dhe trashëgimisë së pronës. Gjatë periudhës së raportimit, qeveria ka miratuar dy aktet e mbetura nënligjore që rrjedhin nga Ligji për barazi gjinore. Megjithatë, zbatimi efektiv i ligjit ngec prapa. Strategjia dhe plani i veprimit 2016- 2020 për mbrojtje nga dhuna në familje janë miratuar në dhjetor të vitit 2016, por zbatimi i tyre është i dobët. Koordinatorin Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje u emërua në janar të vitit 2018. Roli i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe roli i zyrtarëve për barazi gjinore në ministri e komuna, në politikë-bërje, duhet përfortuar. Të dhënat e ndara në gjini mungojnë, ndërsa harmonizimi gjinor në ligje e politika mbetet i dobët. Tek dhuna me bazë gjinore, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të adresuar koordinimin e dobët mes policisë, prokurorëve dhe palëve të tjera të përfshira, si dhe për të adresuar monitorimin joadekuat të urdhrave mbrojtës nga policia dhe gjykatat, në rastet e dhunës në familje. Përkufizimi ligjor i dhunës në familje dhe ngacmimin seksual duhen përkshkruar në Kodin Penal. Është gjithashtu imperative të sigurohet që strehimoret për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit me njerëz të financohen në mënyrë të qëndrueshme, si dhe që të merren masa për riintegrimin efektiv të viktimave.

Tek të drejtat e fëmijës, korniza ligjore e Kosovës është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, por implementimi mbetet i kufizuar. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve është aktualisht duke u hartuar. Autoritetet duhet të sigurojnë që ligji të pasohet me buxhetin adekuat dhe pronësinë institucionale. Grumbullimi dhe menaxhimi i të dhënave mbeten sfiduese për shumë çështje të ndërlydhura me fëmijë. Puna e fëmijëve vazhdon të jetë brengosëse. Përpjekjet për parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve janë të pamjaftueshme nuk e ndalon shprehimisht dënimin trupor. Përkujdesja në familje strehuese duhet të zgjerohet në të gjitha komunat. Institucioni i ri Edukativo-Korrektues i inauguruar në shtator të vitit 2017 duhet të ndihmojë në ofrimin e mundësive të reja për të mitur në mbajtje. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me disa kufizime në të drejtat e tyre, e sidomos në qasjen në arsim dhe qasjen në shërbime adekuate intervenuese. Institucionet duhet të rrisin përkrahjen financiare për qendrat rehabilituese ditore si dhe të bëjnë më shumë përpjekje për të integruar efektivisht fëmijët me aftësi të kufizuara në institucione arsimore.

Pak progres është shënuar në të **drejtat e personave me aftësi të kufizuara** si dhe integrimi i tyre në shoqëri mbetet sfidë për shkak të mbështetjes së kufizuar, shërbimeve joadekuate shëndetësore, si dhe qasshmërisë së dobët në shërbimet ekzistuese. Qasja fizike në objekte dhe transport publik mbeten të kufizuara për personat me aftësi të kufizuara. Planifikimi dhe buxheti gjithëpërfshirës për ndërhyrjet e dhura dhe ofrimin e shërbimeve pengohen nga mungesa e të dhënave të sakta për personat me aftësi të kufizuara. Korniza ligjore për shëndetin mendor është gjithashtu jo e plotë. Zbatimi i Ligjit për persona të verbër dhe Ligjit për statusin e të drejtave të personave me paraplegji dhe tetraplegji është i kufizuar. E njëjta vlen edhe për strategjinë 2013-2023 për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në dhjetor të vitit 2017, qeveria miratoi planin e veprimit 2018-2020 për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Forumi Kosovar për Aftësi të Kufizuara u funksionalizua në janar të vitit 2017. Këshilli Nacional për Aftësi të Kufizuara vazhdon të mos funksionojë mirë. Ai duhet të mblidhet rregullisht dhe të luajë rol më proaktiv për të përmirësuar mirëqenien dhe për të promovuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Për të drejtat e personave **lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë dhe interseksualë (LGBTI)**, Kushtetuta e Kosovës mbron nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual, si dhe ligji kundër diskriminimit i vitit 2015 trajton edhe orientimin seksual edhe identitetin gjinor. Megjithatë, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar implementimin adekuat, duke përfshirë edhe me planin e dytë të veprimit për LGBTI. Në tetor të vitit 2017, Parada e parë zyrtare e Krenarisë LGBTI u organizua në Prishtinë, si dhe u ndoq nga përfaqësues të lartë të autoriteteve. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, paragjykimi dhe stereotipat mbeten të përhapura në shoqëri dhe në media. Nevojiten më shumë përpjekje për të trajtuar jotolerancën ndaj personave LGBTI, pasi që shumë të tillë mbeten të rrezikuar nga diskriminimi dhe abuzimi. Rastet e krimeve të urrejtjes ndaj personave LGBTI duhen hetuar thellësisht dhe të sillen para gjykatave. Korniza ligjore për njohjen juridike të gjinisë duhet të përmirësohet.

Çështjet e të drejtave të punës dhe sindikatave janë të mbuluar tek Pjesa e *Politikave sociale dhe punësimit*.

Për të drejtat procedurale, personat e dyshuar, akuzuar apo viktimat e krimit kanë të drejtë për mbrojtje solide me Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Policinë, Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, Ligjin për kompensimin e viktimave të krimit dhe Ligjin për Ndihmë juridike pa pagesë. Ata kanë të drejtë të përkthimit verbal dhe të shkruar, të drejtën e informimit për të drejtat e tyre, si dhe të drejtë të këshillimit ligjor para dhe gjatë gjykimit, si dhe për ndihmë juridike, por edhe të drejtë të komunikimit me anëtarë të familjes, punëdhënës dhe autoritete konsullore. Ligji për kompensimin e viktimave të krimit është përgjithësisht i përafëruar me Direktivën e BE-së për kompensimin e viktimave të krimit. Programi i kompensimit të viktimave të krimit është themeluar më 2016. Komisioni që verifikon kërkesat për kompensim deri më tash ka pranuar shtatë kërkesa, prej të cilave dy janë miratuar, dy janë refuzuar, ndërsa tri janë në përpunim,

Kosova ka korniza adekuate institucionale dhe ligjore për të drejtat dhe mbrojtjen e **pakicave**, duke përfshirë strategjitë dhe planet e veprimit. Megjithatë, implementimi është i dobët dhe ka varësi të madhe tek donatorët ndërkombëtarë për përkrahje të komuniteteve pakicë. Struktura dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e komuniteteve pakicë janë të vendosura, por nuk kanë koordinim. Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi ende duhen themeluar në veri të Kosovës, për të përforcuar më tutje mbrojtjen e komuniteteve pakicë. Grupi teknik i punës, themeluar për implementimin e rekomandimeve të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Pakica Kombëtare, nuk është takuar gjatë periudhës së raportimit. Përfaqësimi i komuniteteve pakicë në administratën publike është përmirësuar paksa, por pragu minimal që kërkohet me Ligjin për Shërbimin Civil ende nuk është arritur plotësisht. Në tetor të vitit 2017, është emëruar shefi i ri i Zyrës për Çështje të Komuniteteve. Është me rëndësi që kjo Zyrë të angazhohet plotësisht në hartim të politikave për mbrojtjen e pakicave.

Ende nevojitet përkrahje më e madhe nga qeveria në harmonizimin e politikave gjuhësore. Implementimi i Ligjit për gjuhët është ende joadekuat, përkundër përpjekjeve të bëra nga Zyra e Komisionerit të Gjuhëve. Qeveria ende nuk ka aprovuar strategjinë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave gjuhësore. Një sistem më i integruar dhe gjithëpërfshirës arsimor, me mundësi të ndjekjes së mësimave në gjuhën shqipe dhe serbe, por edhe në gjuhë të pakicave, kudo që zbatohet, do të mund të kontribuonte drejt mirëkuptimit më të mirë mes komuniteteve.

Gjendja e përgjithshme e sigurisë për komunitetet pakicë mbetet relativisht stabile. Megjithatë, ka incidente të përsëritura të vjedhjes dhe plaçkitjes së pronave, që shpesh prekin të kthyerit serbë të Kosovës në Kosovën perëndimore dhe komunitetet tjera pakicë në komunat tjera. Trajtimi i pamjaftueshëm nga autoritetet gjyqësore në këto raste rrit pasigurinë dhe dëmton edhe procesin e kthimit. Autoritetet ligjzbatuese dhe ato gjyqësore duhet të ndërmarrin veprime urgjente për të vënë kryesit e veprave para drejtësisë. Në përgjithësi, kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të adresuar siç duhet dhe vazhdimisht nxitjen e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes ndaj pakicave. Rritja e rekrutimit të oficerëve policorë nga pakicat do të kontribuonte drejt një ndjenje më të fortë të sigurisë mes komuniteteve të prekura.

Ritmi i kthimit dhe riintegrimin të **refugjatëve dhe personave të zhvendosur** vazhdon të ngadalësohet, ku 498 individë janë kthyer më 2017. Moszgjidhja e pretendimeve pronësore nga personat e zhvendosur është një faktor i rëndësishëm, që shpjegon pse nuk ka mjedis nxitës për kthimin. Agjencia Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronave dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim duhet të përmirësojnë bashkëpunimin për të lehtësuar restituimin e pronës për procesin e kthimit. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për raste pronësore duhen respektuar plotësisht, si dhe duhen zbatuar menjëherë.

Gjendja e komuniteteve **Rom** dhe Ashkali mbetet e vështirë. Strategjia e re dhe plani i veprimit për periudhën 2017-2021 për përfshirjen e tyre në shoqërinë e Kosovës nuk u miratua deri në prill të vitit 2017, 16 muaj pas skadimit të strategjisë së mëparshme. Pak para miratimit nga qeveria,

strategjia është ndryshuar duke përjashtuar nga fushëveprimi i saj komunitetin egjiptian. Komisioni Evropian dhe organizatat e shoqërisë civile kanë shprehur brengë që kjo mund të shpie drejt një marginalizimi të mëtutjeshëm të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian. Mekanizmat koordinues në të gjitha nivelet, siç parashihen në strategji, duhet të jenë plotësisht funksionale dhe politikisht të përkrahura.

Shkallët e dobëta të kryerjes së arsimit të detyrueshëm janë të shpeshta tek fëmijët romë e ashkalinj. Regjistrimi në arsimin parafillor është rritur. Numri i studentëve që ndjekin kolegje apo universitetin mbetet tejet i ulët. Qendrat mësimore vazhdojnë të luajnë rol të rëndësishëm në tkurrjen e numrit të braktisjeve. Qëndrueshmëria e përkrahjes plotësuese arsimore për komunitete të cënueshme duhet të sigurohet. Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të trajnuar, akredituar dhe integruar personelin mësimor nga këto komunitete brenda sistemit arsimor. Qasja në shëndetin publik është pa pagesë; megjithatë, ajo mbulon vetëm nevojat tejet bazike. Duhet të ndahet buxheti për të mbuluar nevojat banesore të komuniteteve, si dhe duhen marrë masa për t'i përfshirë në tregun e punës. Kosova ka një rën prej shkallëve më të larta në rajon për punën joformale të romëve. Duhet ndërmarrë përpjekje për të parandaluar martesat e përhapura të hershme, që prekin sidomos vajzat, si dhe të parandalohet puna e fëmijëve. Ende ka persona që përballen me vështirësi me dokumente civile, shpesh të lidhura me kthimin apo riatdhesimin.

**Tek të drejtat kulturore,** marrëdhëniet mes autoriteteve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe kanë qenë të ngrysur gjatë periudhës së raportimit. Bashkëpunimi me Këshillin për Implementim dhe Monitorim ka pushuar, edhe pse është premtuese një nismë së voni për ta gjallëruar. Qeveria ka themeluar sekretariatit e KIM-së. Njësia e Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore e Policisë së Kosovës zbaton mandatin e saj në katër rajone, në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe. Disa incidente minore të vjedhjeve të vogla dhe vandalizmit në objekte kulturore e fetare janë raportuar.

Ministria e Kulturës është duke u angazhuar me Kishën Ortodokse Serbe në lidhje me mbështetjen për rindërtimin e objekteve të papërfunduara nga Komisioni i Zbatimit të Rindërtimit. Megjithatë, kushtet e kësaj mbështetjeje duhen sqaruar, për të siguruar që Kisha Ortodokse Serbe të mund të ushtrojë liri të plotë veprimi në menaxhimin e pronave të saj, derisa edhe zbaton procedurat ligjore. Kosova duhet të demonstrojë që respekton këtë të drejtë në praktikë.

Autoritetet kosovare janë zotuar të rikthejnë të gjitha dispozitat substanciale të përshkruara në Aneksin V të Propozimit Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes së Statusit në lidhje me trashëgiminë serbe në Kosovë. Qeveria në mënyrë proaktive ka punuar me BE-në në hartimin e strategjisë së trashëgimisë kulturore për periudhën 2017-2027, si dhe e ka miratuar atë në dhjetor të vitit 2016. E njëjta pritet për hartimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për trashëgimi kulturore, i cili duhet që saktësisht të reflektojë të gjitha zotimet e Kosovës sipas Aneksit V të Propozimit.

Këshilli i Fshatit Hoçë e Madhe dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturore në Prizren janë duke funksionuar në pajtim me ligjin. Qeveria po bashkëpunon më afërsisht me shoqërinë civile në menaxhimin e trashëgimisë kulturore. Incidentet e rrënimit të trashëgimisë kulturore kanë vazhduar ilegalisht, ndërsa sanksionet ndaj kryesve nuk janë shqiptuar. Task-forca e krijuar më 2014 për t'u marrë me ndërtimet e paligjshme në Prizren nuk është takuar për më shumë se një vit. Megjithatë, më 2017, Ministria e Kulturës intervenoi për të ruajtur monumentet e rrezikuara. Nevojiten ende më shumë përpjekje për të siguruar mbrojtjen dhe menaxhimin adekuat të trashëgimisë kulturore në të gjithë Kosovën.

## 2.2.2 Drejtësia, liria dhe siguria

Kosova është në një **fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjeje** në këtë fushë. **Pak progres** është bërë, sidomos në luftën ndaj terrorizmit, edhe me masat e përballjes me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, si dhe në parandalimin e bashkimit të qytetarëve në konflikte të huaja. Në luftën kundër krimit të organizuar, ka më shumë konfiskime preliminare të aseteve. Megjithatë, konfiskimet përfundimtare të aseteve mbeten të pakta. Autoritetet autoritetet kanë bërë progres në menaxhimin e migrimit të rregullt dhe të parregullt. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme.

Kosova ka përmbytur vetëm pjesërisht rekomandimet e raportit të vitit 2016, gjegjësisht ato për qasjen e policisë së udhëhequr nga inteligjenca, si dhe rezultatet në regjistrin e rasteve. Rekomandimet për legjislacionin e konfiskimeve dhe zgjerimin e mekanizmit përcjellës drejt të gjitha rasteve të krimit të organizuar ende nuk janë adresuar.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të krijojë një qasje strategjike ndaj hetimeve financiare, duke përfshirë edhe (i) miratimin e konceptit të FATF-së për hetimet financiare; (ii) ndërmarrjen automatike të hetimeve financiare kur trajtohet krimi i organizuar, terrorizmi, shpëlarja e parave dhe rastet e korrupsionit të rëndë; (iii) fillimin e hetimeve financiare që nga fillimi i hetimeve penale; si dhe (iv) aplikimin e një qasjeje multidisiplinore dhe proaktive ndaj hetimeve financiare;

→ Të vazhdojë të përforcojë regjistrin e rasteve të vazhdueshme në luftën kundër krimit të organizuar, si dhe të ndryshojë legjislacionin përkatës për konfiskimin e pasurive. Të zgjerojë sistemin ekzistues përcjellës TI për të përfshirë të gjitha rastet korruptive të nivelit të lartë;

→ Të përshkallëzojë përpjekjet për zhvillimin e programeve të de-radikalizimit, rehabilitimit dhe riintegrit të luftëtarëve të kthyer, duke përfshirë ata që janë të burgosur, si dhe bashkëshortet dhe fëmijët e tyre;

→ Të përforcojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërinstitucional në fushën e migrimit.

## Lufta kundër krimit të organizuar

Kosova është në **fazë të hershme** në luftimin e krimit të organizuar. **Pak progres** është bërë në periudhën e raportimit në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë. Derisa ka më shumë konfiskime preliminare të pasurive, ka ende pak dënime të plotfuqishme, hetime financiare dhe konfiskime përfundimtare të pasurive. Nevojiten masa që të sigurohet mirë që të mos ketë ndërhyrje politike tek aktivitetet operative të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë. Gjendja në veri të Kosovës, në lidhje me krimin e organizuar, përbën sfidë të posaçme për agjencitë ligjzbatuese. Kosova ka përmbytur vetëm pjesërisht rekomandimet e raportit 2016, gjegjësisht tek regjistri i rasteve, trajnimi i prokurorëve dhe qasja e policisë së udhëhequr nga inteligjenca. Pra, rekomandimet mbeten të vlefshme. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të rishikojë Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, si dhe ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, për t'i bërë vegla efektive të luftës ndaj krimit të organizuar;

→ Me qëllim të vazhdimin të progresit në këtë regjistër të rasteve, të rritet numri i prokurorëve në Prokurorinë Speciale për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e korrupsionit në nivel të lartë, si dhe rastet e krimit të organizuar, si dhe të ofrojë trajnime për përforcimin e kapaciteteve të tyre për të kryer hetime financiare, për të konfiskuar pasuri, si dhe për të mbrojtur efektivisht dëshmitarët;

## Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Dispozitat në **Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale** për luftimin e krimit të organizuar janë përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane. Megjithatë, disa prej tyre duhen rishikuar urgjentisht, si ato për bastisjen dhe konfiskimin, lejueshmërinë e provave, dispozitat që shkaktojnë çekuilibrin mes mbrojtjes dhe prokurorisë në gjykim, si dhe dispozita që mundëson një mori mundësish apeli. Brengë e posaçme është periudha e paraparë me Kodin e Procedurës Penale për hetime, që është jorealiste dhe e shkurtër për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo duhet adresuar në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale. Ligji për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit nuk është plotësisht në përputhje me legjislacionin evropian (Acquis) dhe standardet ndërkombëtare. Mangësitë kryesore mbeten (i) sistemi i paqartë i mbikëqyrjes së sektorit financiar nga Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe banka qendrore;

(ii) kërkesat e mëdha të raportimit për OJQ-të; (iii) mungesa e dispozitave që i mundësojnë prokurorit apo gjykatës të vazhdojë ngrirjen e një transaksioni të dyshimtë në përputhje me urdhrat e NJIF-së; (iv) si dhe fushëveprimi i përkufizimeve, që është më i ngushtë sesa ai i rekomandimeve të Task-Forcës Vepruese Financiare (FATF). Ligji për përgjimin e telekomunikimeve, miratuar në maj të vitit 2015, ende nuk zbatohet plotësisht.

**Policia e Kosovës** mbetet institucioni më i besuar në sigurim të sundimit të ligjit. Ekzistojnë 8 742 oficerë policorë në Kosovë, apo 440 oficerë për 100 000 banorë, krahasuar me mesataren e BE-së që është 211 më 2015. Oficerët janë relativisht mirë të trajnuar dhe të pajisur. Forca policore ka disa njësi të specializuara edhe në nivelin qendror (p.sh. Task-forca anti-korrupsion) edhe në nivelin rajonal (p.sh. Njësitë për droga dhe trafikim me njerëz). Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron nivel të mirë të **trajnitimit fillestar dhe të vazhdueshëm** për policinë dhe trupat e sigurisë publike, si shërbimi korrektues apo doganor. Në nëntor të vitit 2016, Policia e Kosovës publikoi Vlerësimin e Kërcënimeve nga Krimi i Rëndë dhe i Organizuar, në bazë të metodologjisë së Europol-it. Është me rëndësi që kërcënimet e identifikuara të përkthehen në prioritetet operative, të mbështetura tutje me resurset adekuate.

Strategjia dhe plani i veprimit 2012-2017 kundër krimit të organizuar mbeten dokumentet kryesore strategjike. Strategjia e re për periudhën 2018-2022 është në hartim e sipër. Ka edhe strategji e plane të tjera veprimi në funksion për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar; parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpie drejt terrorizmit; kundër terrorizmit; kundër trafikimit me qenie njerëzore; për sigurinë kibernetike dhe kundër narkotikëve. Zëvendësministri i Punëve të Brendshme koordinon zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër krimit të organizuar. Drejtoria e Krimit të Organizuar në selinë e policisë mbështetet nga njësitë e specializuara të luftimit të drogave dhe trafikimit me njerëz në nivel rajonal, ndihmuar nga njësitë forenzike. Aktori kryesor në luftimin e krimit të organizuar është Prokuroria Speciale, e cila ka prokurorë të specializuar për hetimin dhe ndjekjen penale të këtij lloji krimi.

Legjislacioni për **krimin kibernetik** është përgjithësisht në përputhje me *acquis të BE-së*. Bashkë me ndryshimet e planifikuara në Kodin Penal, autoritetet duhet të sigurojnë përfshirjen e mirëfilltë në rishikimet e vazhdueshme edhe të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, duke marrë parasysh ekspertizën e disponueshme të bashkësisë ndërkombëtare. Kjo do t'i mundësonte autoriteteve që të reagojnë më mirë ndaj peizazhit vazhdimisht ndryshues të krimit kibernetik. Departamenti policor përgjegjës për hetimin e krimit të organizuar ka themeluar një sektor për hetimet e krimit kibernetik, ndërsa personeli ka marrë trajnimet dhe pajisjet e specializuara.

Strategjia dhe plani i veprimit 2015-2019 kundër **trafikimit me qenie njerëzore** janë në fuqi, ku prioritet është parandalimi i trafikimit me persona, mbrojtja dhe mbështetja për viktimat e dëshmitarë, hetimi dhe ndjekja penale e krimeve të trafikimit, si dhe mbrojtja e fëmijëve. Legjislacioni është përgjithësisht i përafuar me Direktivën e BE-së për parandalimin dhe luftimin e

trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave, edhe pse zbatimi i tij do të mund të përmirësohej. Kosova është vend origjine, tranziti dhe destinacioni për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, e sidomos për eksploatimin seksual. Më 2017, u identifikuan 32 viktima trafikimi, nga të cilat 25 ishin nga Kosova.

Rastet e krimit të organizuar trajtohen nga Prokuroria Speciale dhe departamentet e Krimeve të Rënda në Gjykatat Themelore të Kosovës. **Dogana, Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) dhe administrata tatimore** janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollimin e qarkullimit të brendshëm dhe ndërkufitar/kufitar të mallrave, materialeve dhe kapitalit, që mund të përfshihen në çfarëdo forme të krimit të organizuar. NJIF-ja posaçërisht ndihmon në analizimin dhe shpërndarjen e informatave mbi shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe këmben informata me të gjitha institucionet ligjzbatuese. Ajo ka edhe kapacitetin për të ngrirë transaksionet e dyshimta financiare. Kosova është në proces të themelimit të një Zyre për rikuperimin e aseteve. Ky proces duhet të përshpejtohet, ashtu që Zyra qendrore e Rikuperimit të Aseteve, e mandatar me identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, të mund të rrisë efektshmërinë e sistemit të rikuperimit të pasurive, si dhe të mundësojë bashkëpunimin operativ me zyrat simotra të rikuperimit në Shtetet Anëtare.

Duhet të ketë **bashkëpunim dhe bashkërendim** më të mirë mes të gjitha institucioneve ekzistuese. Prokuroria Speciale mbetet hallka më e dobët.

#### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Tek **regjistri i rasteve**, mekanizmi elektronik i përcjelljes së **rasteve të profilit të lartë**, duke përfshirë krimin e organizuar, është funksional (*shih luftën ndaj korrupsionit*) por duhet të zgjerohet për të mbuluar të gjitha rastet e krimit të organizuar. Kjo do të shpiente drejt një bashkëpunimi më të madh mes institucioneve, si dhe do të mundësonte këmbimin e më shumë informatave mes atyre që angazhohen në sigurimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Derisa ka më shumë konfiskime preliminare të pasurive, ka ende pak dënime të plotfuqishme, hetime financiare dhe konfiskime përfundimtare të pasurive. Nga 42 raste në regjistrin e rasteve, 10 kanë pasur të bëjnë me krimin e organizuar, me 4 raste në gjykata, 3 aktakuzë të ngritura, si dhe 3 raste në hetim. Për rastet e krimit të organizuar që nuk përfshihen në regjistrin e rasteve, në lidhje me trafikimin me njerëz, një aktakuzë është ngritur për 40 persona, si dhe 11 persona janë shpallur fajtorë gjatë periudhës së raportimit. Për trafikimin me armë, 6 janë akuzuar, ndërsa 5 persona janë shpallur fajtorë. Për shpëlarje të parave, aktakuzë është ngritur ndaj 3 personave, si dhe një rast është mbyllur me lirim.

Lufta ndaj **shpëlarjes së parave** nuk është mjaftueshëm efikase për të prodhuar rezultate bindëse. Shpëlarja e parave shpesh nuk ndiqet si krim në vete, por në lidhje me veprat tjera penale, gjë që pengon përparimin në këtë fushë. Hetimet financiare nuk janë efektive dhe nuk bëhen sistematikisht dhe paralelishut me procedurën penale në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Derisa vlera e përafërt e aseteve të konfiskuara përkohësisht është rritur në përgjithësi në masë të dukshme, shkalla e konfiskimeve përfundimtare e aseteve kriminale mbetet relativisht e ulët. Konfiskimi i aseteve kriminale duhet të bëhet prioritet strategjik në luftën ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit të nivelit të lartë në Kosovë. Grupet kriminale përfshihen në një sërë veprimtarish të paligjshme e fitimprurëse në rritje e sipër, e pastaj riinvestojnë fitime të konsiderueshme në ekonominë e Kosovës. Sot, mjetet e Kosovës për ngrirje, menaxhim dhe konfiskim të aseteve kriminale nuk janë mjaftueshëm efektive. Kështu, Kosova duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një kornizë më gjithëpërfshirëse dhe koherente ligjore për konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Kosova duhet të posaçërisht: (i) të fokusohet tek miratimi/zbatimi i rregullave për konfiskimin e aseteve që nuk lidhen drejtpërdrejt me një veprë të caktuar, por që qartësisht rezultojnë nga veprimtari të ngjashme kriminale të kryera nga personi i dënuar (konfiskimi i zgjeruar); (ii) të fokusohet tek miratimi/zbatimi i rregullave për konfiskimin e pasurive kriminale që qëllimisht janë bartur nga i dyshimti tek një palë e tretë (konfiskimi nga pala e tretë); (iii) të mundësojë konfiskimin e aseteve kriminale kur dënimi penal nuk është i mundur, sidomos për shkak se i dyshimti ka vdekur, ka paafësi të përhershme apo ka ikur (konfiskimi pa bazë dënimi); si dhe (iv)

të sigurojë që autoritetet kompetente të vendosin më sistematikisht ngritjen e përkohshme të pasurive që rrezikojnë të zhduken nëse nuk ndërmerren veprime, duke ditur që gjykata duhet ta konfirmojë sa më shpejt që është e mundur (ngridja si masë sigurie). Përveç këtyre, është qenësore që hetimi financiar i pasurive të personit të mundësohet të vazhdojë për vite pas dënimit penal, ashtu që të ekzekutohet plotësisht urdhri i nxjerrë më parë për konfiskim (ekzekutimi efektiv). Përfundimisht, Kosova duhet të përshkallëzojë kapacitetet e saj për të menaxhuar pasuritë e ngrira apo të konfiskuara, ashtu që të mos humbin vlerën ekonomike (menaxhimi i aseteve).

Kapaciteti policor për luftimin e krimit të organizuar është i mirë. Megjithatë, policia ende i nënshtrohet korrupsionit dhe trysnisë politike, gjëra që pengojnë hetimin e krimit të organizuar. **Qasja e policisë së udhëhequr nga inteligjenca** mbetet dobët e zbatuar. Vegla e re analitike që përdoret për ekspozimin dhe hetimin e krimit të organizuar, Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës, ende nuk përdoret plotësisht. Ka nevojë për më shumë seanca të trajnimeve të specializuara për të gjitha institucionet e angazhuara në luftim të krimit të organizuar - më kompleks - si dhe ka nevojë për bashkëpunim më të afërt ndërkombëtar. Prokuroria Speciale duhet të përforcohet (*shih funksionimin e gjyqësorit dhe luftën kundër korrupsionit*).

Kosova rregullisht këmben informata me Europol-in dhe Interpol-in përmes EULEX-it apo Misionit të Kombeve të Bashkuara për Administratë të Përkohshme në Kosovë (UNMIK). Në shtator të vitit 2017, Kosova kërkoi që aplikimi i saj për anëtarësim në Interpol të shtyhet për mbledhjen vijuese të Kuvendit të Përgjithshëm në nëntor të vitit 2018. Në dhjetor të vitit 2017, Bordi Menaxhues i Europol-it miratoi listën e prioritetëve për partnerë të bashkëpunimit strategjik, duke përfshirë Kosovën. Njësia kosovare e Inteligjencës Financiare u bë pjesë e Grupit Egmont në shkurt të vitit 2017. Akademia e Kosovës për Siguri Publike nënshkroi një marrëveshje pune me Akademinë Policore të BE-së (CEPOL) në mars të vitit 2017.

Mungesa e besimit të publikut tek autoritetet vazhdon të frenojë zbatimin efektiv të **mekanizmave të mbrojtjes së dëshmitarëve**. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar duhen përmirësuar më tutje, me më shumë marrëveshje për vendosjen e dëshmitarëve jashtë vendit, si dhe për këmbimin e informatave. Prokurorët dhe gjyqtarët kanë nevojë për më shumë trajnime në lidhje me mbrojtjen efektive të dëshmitarëve.

Sa i përket **trafikimit të armëve**, Kosova ka miratuar, si dhe po zbaton, strategjinë e saj **2017–2021** për armët e vogla dhe të lehta dhe kontrollin e eksplozivëve. Ministria e Punëve të Brendshme ka një databazë në të cilat regjistron të gjitha armët e importuara në Kosovë, ku ato shënohen në arritje. Ligji për legalizimin e armëve dhe dorëzimin e armëve të vogla dhe të lehta, municionit dhe materialeve plasëse është miratuar në mars të vitit 2017. Kosova po merr pjesë në zbatimin e Planit të Veprimit për trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit ndërmjet BE-së dhe rajonit të Evropës Juglindore (2015-2019). Angazhimi i grupeve të armatosura në aktivitete kriminale të organizuara, si kontrabandimi i armëve, është brengë serioze. Kosova është përmirësuar në masë të konsiderueshme në luftën ndaj trafikimit me armë zjarri, jo vetëm përmes hetimeve normale, por edhe me punën forenzike.

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit mbetet fundamentale për luftimin e infiltrimit kriminal në sistemet politike, ligjore e ekonomike.

## **Lufta ndaj terrorizmit**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

**Korniza ligjore** e Kosovës është në përputhje me *acquis* të BE-së dhe instrumentet ndërkombëtare për anti-terrorizmin. Kosova ka legjislacion që kriminalizon fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë, në vijë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 2178 (2014). Vepra e financimit të terrorizmit është e përfshirë në Ligjin për luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Ky ligj megjithatë nuk është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Strategjia dhe plani i veprimit 2018-2022 kundër terrorizmit janë miratuar në mars



të vitit 2018. Strategjia është bazuar në katër shtyllat e parandalimit, përndjekjes, mbrojtjes dhe reagimit, si dhe është në përputhje me strategjinë anti-terrorizëm të BE-së. Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimin kanë qenë në fuqi që prej vitit 2015.

**Institucionet** kryesore të angazhuara në luftimin e terrorizmit janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Policia, agjencia e inteligjencës, Njësia e Inteligjencës Financiare, si dhe prokuroria, duke përfshirë Prokurorinë Speciale. Si koordinator i anti-terrorizmi, Ministri i Punëve të Brendshme është përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive për luftimin e terrorizmit, vlerësimin e inteligjencës strategjike dhe sigurimin e koordinimit. Qeveria dhe Grupi Punues Teknik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm takohen në baza të rregullta, duke siguruar kështu bashkëpunimin mes autoriteteve dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë shoqërinë civile dhe bashkësitë fetare.

Njësia e Inteligjencës Financiare (NJIF) është pjesë thelbësore e sistemit të luftimit të financimit të terrorizmit. Megjithatë, ajo nuk ka stafin dhe resurset për t'u përballur efektivisht me këtë fenomen.

#### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Kosova ka përshkallëzuar përpjekjet e saj për të luftuar terrorizmin, duke përfshirë masat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe pengimin e **luftëtarëve terroristë** nga bashkimi në konflikte jashtë shtetit. Numri i qytetarëve kosovarë që janë angazhuar në konfliktet e Sirisë/Irakut ka rënë vazhdimisht, si dhe më 2017, nuk ka pasur raste të reja të raportuara. Ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, afërsisht 359 qytetarë kosovarë (255 burra, 49 gra dhe 55 fëmijë) ikën drejt zonave të konfliktit në Lindje të Mesme, kryesisht si luftëtarë të huaj terroristë. Gjithashtu, 41 fëmijë janë lindur në zonën e konfliktit, 133 qytetarë kosovarë janë kthyer, 74 kanë vdekur dhe 195 kanë mbetur në atë arenë (59 burra, 41 gra dhe 95 fëmijë).

Më 2017, 61% e aktiviteteve në planin e veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që shpjen në terrorizëm janë implementuar; 14% e aktiviteteve janë zbatuar pjesërisht dhe 25 % nuk janë implementuar. Institucionet ligjzbatuese dhe gjyqësore vazhdojnë të reagojnë në mënyrë solide ndaj terrorizmit. Policia ka arrestuar një numër të konsiderueshëm të njerëzve që janë bashkuar me grupe terroriste të angazhuara në konflikte jashtë shtetit, apo që kanë synuar të bashkohen. Një numër i konsiderueshëm i rasteve kanë përfunduar me dënime. Ka pasur raste me akuza që shkojnë nga rekrutimi për terrorizëm, organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist, nxitje të urrejtjes, përçarje apo mosdurim nacional, racor, fetar apo etnik, nxitje e të tjerëve të kryejnë vepra terroriste, shkelje e dispozitave të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë Kosovës. Në nëntor të vitit 2016, Policia e Kosovës arrestoi 18 persona të dyshuar për terrorizëm. Ata pretendoheshin të kishin planifikuar të kryenin sulme të koordinuara terroriste në Shqipëri, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovë. Gjatë të gjithë periudhës së raportimit, Drejtoria kundër Terrorizmit inicioi 27 raste të reja të veprave penale të lidhura me terrorizmin, duke rezultuar me arrestimin e shtatë të dyshuarve. 20 persona u dënuan për vepra penale të lidhura me terrorizmin.

Përkundër këtyre përpjekjeve, autoritetet vazhdojnë të përballen me sfidën e **ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit**. Kjo ndihmohet pjesërisht me fondet nga organizata të huaja që ligjërojnë ideologji ekstremiste. Grupet ekstremiste të dhunshme gjithashtu përdorin në mënyrë aktive mediat sociale për të përhapur propagandë dhe për të rekrutuar pasues. Kosova duhet të rrisë përpjekjet e saj për të luftuar këto ndikime nga jashtë. Kosova gjithashtu përballet me sfidën e luftëtarëve dhe familjarëve të tyre të kthyer nga zona e konfliktit. Nuk ka programe gjithëpërfshirëse për parandalimin, de-radikalizimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të kthyer, duke përfshirë ata që janë në burgje, si dhe familjet e tyre, sidomos për gra dhe të mitur. Komuniteti i inteligjencës dhe zbatimit të ligjit duhet të zbatojë qasje të dedikuara ndaj fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Duhet të ketë politikë koherente gjyqësore për kryesit, kombinuar me reagimin social, me bazë në komunitet, të orientuar posaçërisht kah të rinjtë e marginalizuar. Bashkëpunimi i rritur mes shërbimeve ligjzbatuese dhe të inteligjencës, sidomos

mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, do të mund të ndihmonte në përballjen me këtë kërcënim. Aktivitetet monitoruese dhe parandaluese duhen përshkallëzuar në jug të Kosovës, sidomos afër kufirit me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kosova duhet të këmbëjë më shumë të dhëna për anti-terrorizmin me Europol-in. Lidhja mes krimit të organizuar dhe terrorizmit duhet vlerësuar. Prokurorët dhe Policia kanë nevojë për trajnime të specializuara shtesë për teknikat e hetimit. Agjencitë ligjzbatuese të Kosovës gjithashtu kanë mungesë të ekspertizës dhe pajisjeve për të hetuar rastet e ndërlikuara të terrorizmit. Kosova duhet të fokusohet tek një sistem përfshirës arsimor për të luftuar rrezikun e radikalizimit të rinjve të cënueshëm.

## **Migrimi i ligjshëm dhe ai i parregullt**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

**Korniza ligjore** është në masë të madhe në përputhje me *acquis*. Ndryshimet në Ligjin për të huajt për ta përafuar me Direktivat më të reja të BE-së për punësimin e shtetasve nga vendet jashtë BE-së, si dhe përafrimi me Rregulloren për Sistemin Informativ të Vizave (Rregullorja VIS) për këmbimin e të dhënave për vizat afatshkurtra janë miratuar nga Kuvendi.

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim në Ministrinë e Punëve të Brendshme është përgjegjës për zbatimin e politikës së migrimit. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë Kufitare të Kosovës merret me migruesit e parregullt. **Strategjia** dhe plani i veprimit për migrimin për periudhën 2013-2018 janë duke u zbatuar. Megjithatë, nevojiten bashkëpunimi dhe bashkërendimi më i afërt ndërinstytucional. Strategjia vijuese pesëvjeçare duhet të përgatitet me angazhimin e plotë të të gjitha ministrive përkatëse, duke u bazuar në mësimet e kaluara dhe vlerësimin gjithëpërfshirës të sfidave në implementim. Profili i migrimit 2016 është miratuar në nëntor të vitit 2017. Ai përmban një analizë të thukët të të dhënave të migrimit, si dhe të faktorëve “shtytës” dhe “tërheqës”, bashkë me rekomandimet dhe udhëzimet për politika, që tani duhen marrë parasysh në praktikë. Ai është hartuar nga Autoriteti Qeveritar për Migrim, organ ndërinstytucional që përbëhet nga 15 institucione të ndryshme qeveritare. Ky trup ka pozitë të mirë për të marrë rol më proaktiv në udhëheqje. Mandati i tij duhet përfortuar.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Ka disa **mangësi në zbatim**, posaçërisht për shkak të mungesës së koordinimit mes agjencive qeveritare. Disa prej divizioneve të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme mbeten me staf të mangët, përkundër rritjes me disa zyrtarë. Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës dhe Qendra e (Pranimit) Azilit dhe Qendra e Paraburgimit për të Huaj gjithashtu përballen me mungesë stafi. Gjatë periudhës së raportimit, personeli është bërë më i specializuar duke iu falënderuar një numri kursesh trajnime, që shkojnë nga menaxhimi i migrimit dhe teknikat e posaçme të intervistimit e deri tek procedurat dhe standardet e trajtimit të të miturve pa përcjellje, identifikimin dhe referimin e azilkërkuesve me nevoja të posaçme, si dhe të drejtat e aplikuesve me nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Kosova ka një stabiliment pranimi për **migruesit e parregullt** në Vranidoll, që mund të pranojë 70 persona, si dhe të ofrojë akomodim të mirëfilltë për grupet e cënueshme. Dispozitat ligjore që sigurojnë të drejtat themelore të migruesve të parregullt apo të huajt që vendosen në qendër janë në zbatim. Megjithatë, mungon stafi adekuat dhe i specializuar për të siguruar të drejtat dhe nevojat themelore. Ofrimi i kujdesit të mirëfilltë për shumicën e grupeve të cënueshme të migruesve mbetet sfidë. Masat janë të vendosura për të parandaluar **kontrabanduesit e njerëzve** që të mos infiltrohen në qendër. Megjithatë, besohet që lëvizja e migruesve ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje të saj mundësohet nga kontrabanduesit individualë apo rrjetet, pasi që janë në gjendje të lëvizin pa kaluar nëpër pikat kontrolluese në kufij apo në kufirin me Serbinë. Rrjetet kontrabanduese nga Kosova mundësojnë lëvizjet sekondare të migruesve të parregullt nga pikat hyrëse përgjatë vijës ballkanike. Ndërmjet shtatorit 2016 dhe janarit 2018, Policia e Kosovës ka hetuar 23 raste të kontrabandimit të migruesve. Ajo gjithashtu ka ndërmarrë 7 operacione policore në të cilat janë arrestuar 15 të dyshuar.

Në përgjithësi, ka pasur 63 migrues të parregullt të strehuar në qendrën e pranimit ndërmjet shtatorit 2016 dhe janarit 2018. Që të 63 personat janë kthyer në vendet e tyre të origjinës, shumica sosh brenda një periudhe të arsyeshme të kohës (koha mesatare e pritjes është 25 ditë). Kosova duhet të vërë në zbatim një mekanizëm kthimi për migruesit e parregullt, në përputhje me standardet dhe praktikën e BE-së.

Mbeten sfidat me komunikimin ndërmjet zyrtarëve dhe migruesve të parregullt, por është arritur përparim në vitin 2017 me një marrëveshje për këmbimin e përkthyesve mes vendeve të rajonit përmes Iniciativës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë.

Kosova ka nënshkruar marrëveshje **ripranimit** me 24 vende, 20 prej të cilave janë Shtete Anëtare të BE-së dhe vende të Zonës së Shengenit. Së voni, u nënshkrua marrëveshja me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë në dhjetor të vitit 2017. Nuk është nënshkruar ndonjë marrëveshje ripranimi me BE-në. Numri i kërkesave për azil nga qytetarët e Kosovës në vendet e BE-së dhe anëtare në Zonën e Shengenit ka rënë nga 73.235 më 2015, në 11.965 më 2016, si dhe afërsisht 7.575 më 2017. Marrëveshjet e ripranimit me Shtetet Anëtare të BE-së dhe shtetet anëtare të Shengenit po implementohen mirë. Si pasqyrim i trendit të kërkesave të azilit, numri i përgjithshëm i qytetarëve kosovarë të ripranuar ka rënë nga 18.789 më 2015, si dhe 11.030 më 2016, në 4.509 (2.623 me forcë dhe 1.886 vullnetarë) më 2017. Kosova ka arritur shkallë kthimi prej 96% të qytetarëve të Kosovës që janë urdhëruar të lëshojnë territorin e BE-së më 2016. Strategjia dhe plani i ri i veprimit për **riintegrim** (2018-2022) janë miratuar nga qeveria. Rregullorja për riintegrimin u ndryshua në gusht të vitit 2017 pas një konsultimi të gjerë me palët përkatëse të interesit. Synimi kryesor ishte të zhvillohet një proces më i qëndrueshëm i riintegrimit, përmes decentralizimit progresiv drejt nivelit komunal, ku duhen ofruar shërbimet publike. Procesi është në vazhdim, derisa sistemi nuk është plotësisht funksional. Që prej janarit 2018, 2.890 persona kanë gëzuar shërbimet e ndihmës së qëndrueshme të ofruara nga Fondi i Riintegrimit. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të vendosur një sistem funksional që mbulon më shumë të kthyer dhe fokusohet më shumë tek shërbimet e ndihmës së qëndrueshme, si krijimi i të ardhurave. Kjo kërkon bashkëpunimin e ministrive të ndryshme.

## **Azili**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

**Korniza ligjore** për azilin është në masë të madhe në përputhje me *acquis*. Ligji për azilin është rishikuar për ta përafëruar më tutje me *acquis* për procedurat e azilit dhe kushtet e pranimit. Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim është organi i shkallës së parë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Komisioni Shtetëror për Refugjatë shqyrton ankesat. Ankesa përfundimtare gjyqësore mund të parashtrohet në Gjykatën Supreme. Pas refuzimit të kërkesës për azil apo pushimit të procedurës, Divizioni për Kthim dhe Ripranim i këtij Departamenti është përgjegjës për zbatimin e vendimit.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Për procedurat e azilit, autoritetet kompetente kanë rritur kapacitetin e tyre të vlerësimit të kërkesave për azil në bazë të meritave të aplikimit, por duhet më shumë trajnim. Numri i kërkesave për azil ka rënë nga 307 më 2016, në 147 në vitin 2017. Kosova është ende vend tranziti. Shumica e kërkesave për azil pezullohen, pasi që aplikuesit zhduken pa përfunduar procedurën. Më 2017, 2 aplikues morën përgjigje pozitive në formë të mbrojtjes subsidiare.

Nivelet e personelit janë përgjithësisht adekuate për numrin e kërkesave për azil. Megjithatë, Qendra për Azilkërkues, përgjegjëse për **pranimin, regjistrimin, akomodimin dhe lëvizjen e azilkërkuesve brenda dhe jashtë qendrës** ka mungesë stafi. Gjithashtu ka mungesë të përkrahjes psiko-sociale dhe ligjore, ndihmës me zhvillimin e fëmijëve, si dhe mbështetjes nga shërbimet sociale. Edhe pse parashihet me aktin nënligjor për pranimin dhe trajtimin fillestar për azilkërkues, sistemi i referimit në kufi, duke përfshirë qasjen në ndihmë juridike, nuk është ende i themeluar. Për

më tepër, teknikat e intervistimit mbeten brengosëse dhe shpesh të komplikuar me mungesën e përkthimit adekuat. Megjithatë, edhe pse sistemet plotësisht efektive dhe të ndjeshme ndaj hyrjes nuk janë të vendosura, nuk janë identifikuar raste të dokumentuara të *refoulement* (kthimit me forcë në vende ku mund t'i nënshtrohen persekutimit) apo kthimit me dhunë në vitet e fundit. Më 2017, autoritetet kompetente përditësuan planin e tyre të kontingjencave në rast të një fluksi migruesish/refugjatësh në Kosovë. Megjithatë, ekziston një hendek i konsiderueshëm ndërmjet kapacitetit aktualisht të disponueshëm (50 vende) dhe kapacitetit të paraparë në institucionet akomoduese në planin kontingjent (5.000 vende). Zyra Evropiane për Përkrahjen e Azilit është duke mbështetur autoritetet kosovare në harmonizim të praktikave, duke implementuar Sistemin e Përbashkët Evropian të Azilit dhe duke koordinuar me Rrjetet Evropiane për Pranime.

## **Politika e vizave**

Kosova ende nuk ka përafuar legjislacionin e saj me listat e BE-së me vendet, shtetasit e të cilëve obligohen të kenë viza, si dhe atyre që përjashtohen nga obligimi i vizave kur udhëtojnë drejt BE-së. Në bazë të një vendimi qeveritar të datës 29 nëntor 2013, Kosova ka vendosur kriteret vizash për shtetasit e 88 vendeve. Numri i konsullatave të Kosovës që japin viza është rritur në 16, duke çuar drejt rënies së numrit të vizave të dhëna në kufi (vetëm 6 gjatë periudhës së raportimit) me vlefshmëri prej 15 ditësh kalendarike. Autoritetet e lëshimit të vizave kanë kapacitet për të marrë në rrugë digjitale të dhënat biometrike nga aplikuesit për viza, edhe pse pajisjet mund të kenë nevojë për ripërtëritje. Lidhja e internetit mes autoriteteve lëshuese të vizave dhe Ministrisë së Jashtme mundësohet përmes Sistemit Informativ të Vizave të Kosovës. Të gjitha vizat e dhëna dhe të refuzuara regjistrohen në këtë sistem informativ.

Qytetarët e Kosovës mbeten të vetmit qytetarë nga Ballkani Perëndimor që duhet të aplikojnë dhe të marrin viza për të udhëtuar drejt Zonës së Shengenit. Dialogu për liberalizimin e vizave ka qenë në vazhdim që prej vitit 2012. Në maj të vitit 2016, Komisioni nxori propozimin e tij për liberalizim të vizave, me kushtin që deri në ditën e miratimit të tij nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, Kosova do të ketë ratifikuar marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi, si dhe të ketë përforcuar regjistrin e rasteve në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018.

## **Shengeni dhe kufijtë**

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

**Korniza legjislative** për menaxhimin e kufijve të Kosovës është në masë të madhe në përputhje me *acquis* dhe standardet ndërkombëtare. Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve shtetërorë për ta përafuar më tutje kornizën ligjore me *Acquis* të BE-së, sidomos me Rregulloren 2016/399. Qendra Nacionale për Menaxhimin e Kufijve (QNMK) ka një njësi të përbashkët të analizës së rreziqeve dhe kërcënimeve të inteligjencës përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave dhe informatave nga agjencitë e Menaxhimit të Integruar të Kufijve (MIK) (policia, dogana dhe agjencia e ushqimit dhe veterinarisë). QNMK-ja shihet si njëri prej elementeve më të rëndësishme të kapacitetit për menaxhim efektiv të sigurisë së kufijve të saj. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar që ajo të funksionojë deri në potencialin e saj të plotë. Strategjia dhe plani i veprimit për MIK 2013-2018 janë të përafuara me konceptin e BE-së për MIK të vitit 2016. Në korrik të vitit 2017, u miratua plani i rishikuar dhe i rivlerësuar i veprimit për MIK.

### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Departamenti Kufitar i Policisë së Kosovës ka staf të mjaftueshëm, me gjithsej 1.300 oficerë, si dhe përgjithësisht plotëson standardet minimale të BE-së për kontrollet kufitare. Infrastruktura e pikëkalimeve kufitare (PKK) është përmirësuar, si dhe Sistemi i Menaxhimit të Kufijve është avancuar plotësisht. Megjithatë, efektshmëria e tij mbetet e kufizuar për shkak të mungesës së lidhjes me rrjete të rëndësishme ndërkombëtare, si SIENA e Europol-it dhe I 24/7 e Interpol-it, për shkak të

çështjeve të lidhura me statusin. **Bashkëpunimi ndërinstitucional** është i mirë, por mund të përmirësohet në nivelin më të lartë, por edhe në veçanti tek këmbimi i informatave dhe analiza e përbashkët e rreziqeve. Është arritur përparim në luftën kundër korrupsionit, me disa plane të reja veprimi, reforma e rregullore në kuadër të Policisë Kufitare dhe doganës. Është hartuar strategjia anti-korrupsion e policisë kufitare, por nuk është zbuluar ndonjë rast i korrupsionit në kufi.

Tek **bashkëpunimi në rajon**, Kosova ka lidhur 23 marrëveshje për Menaxhimin e Integruar të Kufijve. Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018. Kosova dhe Shqipëria bëjnë kontrolle të përbashkëta të kufirit, ku një oficer policor kufitar i Shqipërisë dhe një i Kosovës ndajnë një kabinë. Janë bërë disa hapa tejet pozitivë me themelimin e dy qendrave të përbashkëta të bashkëpunimit policor ndërkufitar, njëra me Shqipërinë (PKK Vërmicë) dhe tjetra me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (PKK Hani i Elezit). Gjithashtu, është themeluar një qendër e përbashkët trepalëshe e bashkëpunimit policor ndërkufitar ndërmjet Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës, në maj të vitit 2017. Pikë-kalimet e ndërmjetme të MIK-së me Serbinë vazhdojnë të jenë plotësisht funksionale. Ka pasur pak përparim në themelimin e pikave të përhershme të kalimit kufitar MIK me Serbinë në Merdare dhe Mutivodë, si dhe në themelimin e pikave të tjera të përkohshme të përbashkëta të kalimit kufitar në Kapi dhe Rajetici. Duhet ndërmarrë masa plotësuese për të parandaluar kalimet e paligjshme dhe aktivitetet kriminale.

Kosova ka një rregullim pune me Agjencinë Evropiane të Kufirit dhe Rojës Detare, që mundëson bashkëpunimin e ngushtë për migrimin e parregullt, krimet kufitare, sigurinë kufitare dhe menaxhimin e përgjithshëm kufitar.

### **Bashkëpunimi juridik në çështje civile dhe penale**

Derisa Kosova nuk është palë në shumicën e traktateve shumëpalëshe që rregullojnë bashkëpunimin juridik në çështje civile dhe penale, ajo njëanshëm zbaton standardet e traktateve të njohura ndërkombëtarisht. Për Konventën e Hagës të vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, rastet relevante trajtohen nga Ministria e Drejtësisë. Kosova në mënyrë të njëanshme është përafuar me Konventën e Hagës të vitit 1961 për heqjen e kriterit të legalizimit për dokumentet e huaja publike.

Bashkëpunimi juridik në çështje penale rregullohet me Ligjin e vitit 2013 për Bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështje penale, si dhe 20 marrëveshje dypalëshe me vendet tjera. Korniza ligjore për bashkëpunim gjyqësor në çështje civile do të ndihmonte në sqarimin e rregullave dhe procedurave. Bashkëpunimi bazohet në parimin e reciprocitetit me vendet me të cilat Kosova nuk ka marrëveshje bilaterale. Procedurat e vitit 2015 për Ndihmën Juridike të Ndërsjellë, të dakorduara mes Beogradit dhe Prishtinës, formojnë bazën për bashkëpunim juridik ndërmjet autoriteteve gjyqësore në Kosovë dhe Serbi. Vendet tjera që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës vullnetarisht kanë pranuar rolin lehtësues të BE-së. Për shkak të çështjeve të statusit, rastet e Eurojust-it aktualisht mund të hapen ndaj EULEX-it dhe UNMIK-ut. Që prej vitit 2015, nuk janë hapur raste ndaj këtyre entiteteve.

### **Bashkëpunimi në fushën e drogave**

#### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

Ligji për drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë është akti kryesor ligjor që rregullon drogat. Veprat e lidhura me drogat kryesisht trajtohen me Kodin Penal. Korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me praktikën më të mira evropiane në luftën ndaj drogave. Strategjia 2012-2017 dhe plani i veprimit kundër narkotikëve të paligjshëm ka vazhduar të implementohet, si dhe janë goditur disa grupe kriminale. Strategjia e re dhe plani i veprimit për periudhën 2018-2022 mbeten të miratohen. Mekanizmi koordinues për parandalimin dhe luftimin e trafikimit dhe abuzimit me droga dhe prekursorë udhëhiqet nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, i cili koordinon të gjitha ministrinë përkatëse të linjës. Kosova duhet që formalisht të themelojë një Sistem të Paralajmërimit të Hershëm për të ecur më tutje me dy pikat kontaktuese tashmë të

vendosura, si dhe të finalizojë marrëveshjen për Qendrën Kombëtare të Monitorimit. Duhet siguruar mbledhja e qëndrueshme dhe rutinore e të dhënave.

### **Implementimi dhe kapaciteti zbatues**

Kosova vazhdon të jetë vend depozitimi dhe tranziti për heroinë dhe kanabis. Konfiskimet mbeten tejet të ulëta, sidomos për heroinën dhe kokainën, përkundër rritjes së personelit në Drejtorinë për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve. Grupet e krimit të organizuar (kryesisht shqipfolëse) vazhdojnë të luajnë rol dominues në trafikimin e heroinës në masë të madhe, si dhe shpërndarjen pasuese në BE. Kosova duhet të intensifikojë luftën e saj ndaj trafikimit të drogave. Zbatimi i mëtutjeshëm i qasjes së policisë së udhëhequr nga inteligjenca, si dhe përforcimi i bashkëpunimit rajonal policor mbeten të domosdoshme. Prokuroria mbetet me mangësi në staf, si dhe mungesë trajnimi të mjaftueshëm për të ndjekur penalisht dhe me efikasitet veprat e lidhura me drogat. Megjithatë, ka pasur rritje të dukshme në numrin e aktgjykimeve krahasuar me raportin e mëparshëm. Në këtë periudhë raportimi, prokuroria është marrë me 3670 raste të drogave (me 5150 persona), ku në 971 raste (me 1369 persona) janë shpallur aktgjykimet. 344 persona janë shpallur fajtorë nga gjykatat. Është krijuar depoja e sigurt për drogat dhe prekursorët e konfiskuar para shkatërrimit të tyre.

Vëmendje e posaçme i duhet kushtuar vetëdijesimit publik për pasojat e abuzimit me droga. Policia, oficerët e sigurisë në bashkësi dhe mësimdhënësit vazhdojnë të ndjekin trajnime mbi rreziqet e abuzimit me drogat. Trajtimi i varësive dhe terapia me metadon është duke u ofruar, duke përforcuar parandalimin e abuzimit me droga.

Kosova vazhdon të bashkëpunojë me Qendrën Evropiane të Monitorimit për Droga dhe Varësi Droge. Edhe pse nuk është anëtare e plotë, është përfituese e një projekti rajonal IPA, zbatuar nga Qendra, si dhe ofron edhe raporte të rregullta për agjencinë, përmes kontakt-personit të caktuar.

### **Bashkëpunimi doganor**

Dogana e Kosovës ka themeluar Sistemin Informativ të Zbatimit të Ligjit për regjistrimin dhe menaxhimin e të gjitha rasteve të veprave doganore, duke përfshirë por pa u kufizuar tek regjistrimi i mallrave falso në përputhje me *acquis* në këtë fushë. Administrata doganore ka sistem të integruar të TI-së për përpunim të të dhënave.

Dogana e Kosovës ka krijuar njësi ndërlidhëse me Policinë e Kosovës dhe Njësinë e Inteligjencës Financiare. Bashkëpunimi mes të gjitha autoriteteve kufitare duhet rritur më tutje.

Masat për sigurimin e integritetit të oficerëve doganorë janë kodi i mirësjelljes, kodi i etikës dhe procedurat disiplinore.

### **Falsifikimi i Euros (aspektet e të drejtës penale)**

Kosova është përgjithësisht në përputhje me *acquis* për shtypjen e valutës së falsifikuar, si dhe autoritetet kompetente dhe procedurat për përballjen me paratë e falsifikuara janë të vendosura. Analiza teknike, në përputhje me standardet ndërkombëtare, e parave të falsifikuara, duke përfshirë banknotat dhe monedhat, kryesisht kryhet nga agjencia forenzike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. (*shih edhe pjesën për Kontrollin Financiar*)

### 3. THEMELORET SË PARI: ZHVILLIMI EKONOMIK DHE KONKURRENCA

Shifrat kryesore ekonomike	2015	2016	2017
<b>Bruto-Prodhiimi Vendor për kokë banori</b> (% të EU28 në PPS)	N/A	N/A	N/A
<b>Rritja e BPV-së</b> (%)	4.1	4.1	3.9*
<b>Shkalla e papunësisë</b> (femërore; mashkullore) (%)	32.9 (36.6; 31,8)	27.5 (31.8; 26,2)	30.4* (36.4*; 28.6*)
<b>Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat në moshat 20– 64 vjeç: pjesa e popullatës në grupmoshat 20–64 që është ekonomisht aktive</b> (femërore; mashkullore) (%)	42.8 (20.4;65.1)	44.0	N/A
<b>Bilanci i llogarive rrjedhëse</b> (% e BPV-së)	-8.6	-9.1	-5.9
<b>Neto-Investimet e Huaja Direkte (IHD)</b> (% të BPV-së)*	4.7	2.9	3.9

\* Në bazë të të dhënave agregate TM1-TM3 të BPV-së

*Burimi: Eurostat, ASK*

Në përputhje me konkluzat e Këshillit Evropian në Kopenhagë, në qershor të vitit 1993, aderimi në BE kërkon ekzistencën e një ekonomie funksionale tregu, si dhe kapacitetin për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

Monitorimi i këtyre kriterëve ekonomike duhet parë edhe në kontekstin e rëndësisë qendrore të qeverisjes ekonomike në procesin e zgjerimit. Secili vend aderues përgatit çdo vit një program të reformave ekonomike (ERP), i cili vendos kornizën e politikave makro-fiskale afatmesme, si dhe një agjendë të reformave strukturore, me qëllim të sigurimit të konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse. ERP-të janë baza për orientimet e politikave të shteteve specifike që bashkërisht miratohen nga BE-ja dhe Ballkani Perëndimor dhe Turqia, në nivel ministror, në maj të çdo viti.

#### 3.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut


Kosova ka arritur **progres të mirë** si dhe është në **fazë të hershme** të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Ambienti i biznesit është përmirësuar, ndërsa qeveria ka respektuar rregullin fiskal për deficitin buxhetor; megjithatë, beneficionet e veteranëve të luftës vazhdojnë të përbëjnë sfidë për financat publike. Ekonomia joformale mbetet e përhapur. Rritja e shkallës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nuk është pasuar me rritjen e punësimit, duke shkaktuar kështu rritje të mëtutjeshme të shkallës së papunësisë. Kjo posaçërisht ka prekur gratë dhe punëtorët e rinj dhe të pakualifikuar. Përkundër rritjes së fortë të eksportit, deficitin i lartë tregtar reflekton bazën e dobët prodhuese.

Për të mbështetur rritjen afatgjate, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme:

- avancimit të stabilitetit fiskal dhe përmirësimit të efikasitetit të shpenzimeve publike;
- adresimit të faktorëve bazë ligjorë dhe institucionalë që pengojnë qasjen e bizneseve në financa;

## Qeverisja ekonomike

**Figura 1 Rritja e BPV-së së Kosovës**



*Burimi: Eurostat, Burime nga Kosova*

zbatimin e zotimeve sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) kanë penguar Kosovën nga gëzimi i plotë i qasjes së zgjeruar tregtare që mundësohet nga MSA-ja. Udhëzimi i politikave bashkërisht i miratuar në maj të vitit 2017 është zbatuar pjesërisht, derisa masat e miratuara sipas agjendës së reformave evropiane janë vonuar.


### Stabiliteti makroekonomik

**Përkundër rritjes së BPV-së me më shumë se 4% në 3 vitet e fundit, Kosova mbetet ekonomia më e varfër në rajon.** BPV-ja për kokë banori në Kosovë është vlerësuar të jetë rreth 3.200 Euro në terma nominalë më 2017. Rritja reale ka vazhduar të jetë e fortë, 3.9% në tre tremujorët e parë të vitit 2017, krahasuar me 4.1% më 2016, për shkak të ndërtimeve madhore të rrugëve dhe investimeve të financuara me IHD. Eksportet neto kanë dhënë kontributin pozitiv në rritje, duke marrë parasysh që eksportuesi më i madh i metaleve, Ferronikeli, ka rikthyer tregjet e eksportit të Lindjes së Mesme që kishte humbur, derisa eksportimi i shërbimeve është rritur shpejt. Për dallim nga vitet e kaluara, të dhënat tremujore paraqesin tkurrje të konsumit privat me 2.5%, përkundër kreditimit konsumator të fortë, rrjedhës së lartë hyrëse të remitencave, si dhe qarkullimit të mirë në pakicë, gjë që thekson mospërputhjet e mundshme në të dhëna. Ana e ofertës në BPV tregon rritje inkurajuese me bazë të gjerë që udhëhiqet nga ndërtimtaria, tregtia dhe sektori financiar, derisa administrata publike dhe veprimtaritë tjera shërbyese kanë rënë shumë. Përgjithësisht, kapacitetet prodhuese të Kosovës mbeten dobët të zhvilluara dhe ekonomia vazhdon të varet nga konsumi, investimi në infrastrukturë dhe dërgesat e parave.

**Eksportet e rritura të shërbimeve kanë ndihmuar në ngushtimin e deficiteve të jashtme** Deficiti i llogarive rrjedhëse është tkurrur në 5.9% të BPV-së më 2017, krahasuar me 9.1% të BPV-së më 2016. Kjo kryesisht ka ardhur për shkak të rritjes së fortë të eksportimit të shërbimeve. Ndryshimet metodologjike në llogaritjet e veprimtarisë ekonomike të diasporës së Kosovës që kthehet kohë pas kohe do të mund të shpjegojnë një ndryshim kaq të madh dhe rënie të konsumit privat që janë përmendur më sipër. Deficiti tregtar i mallrave është rritur me 1 pikë përqindjeje në 38.9 % të BPV-së. Një burim i rëndësishëm i të ardhurave për shumë familje të Kosovës, dërgesat financiare janë rritur në 12% të BPV-së më 2017. IHD-të neto janë rritur me 3.9% të BPV-së, krahasuar me 2.9 % të BPV-së më 2016. Rrjedhat hyrëse të IHD-ve kanë qenë edhe më të koncentruara më 2017, duke marrë parasysh hiset e pronës së paluajtshme, ndërtimit dhe sektorit financiar, IHD-të janë rritur në 97.1%. Rrjedhat hyrëse në sektorët prodhues ka qenë negative. Kjo reflekton një mjedis të dobët afarist dhe pak mundësi investimi “parësore” (greenfield).



**Figura 2 Zhvillimet fiskale të Kosovës**



Burimet: Eurostat, Burime nga Kosova

Si ekonomi e vogël me prodhimtari të ulët vendore, zhvillimet e çmimeve në Kosovë udhëhiqen kryesisht nga çmimet e importimit të ushqimit dhe energjisë. Inflacioni mesatar i çmimit të konsumit më 2017 u rrit në 1.5%, krahasuar me 0.3% më 2016. Inflacioni mesatar i çmimit të importit ishte 4.4% në tre tremujorët e parë të 2017-ës. Të dy zhvillimet e çmimeve pasqyrojnë lëvizjet globale në çmimet e ushqimeve e lëndëve djegëse derisa inflacioni bazë mbetet i ulët. Në anën tjetër inflacioni i çmimeve të prodhuesit ishte vetëm 0.3% në të njëjtën periudhë, kryesisht për shkak të rritjes së ulët të pagave.

**Stabiliteti fiskal është ruajtu më 2016 dhe 2017, përkundër mungesës së zbatimit të disa reformave të rëndësishme fiskale.** Rritja e fortë ekonomike dhe vjelja më e mirë e të hyrave ka shpjeguar drejt rritjes së konsiderueshme të të hyrave prej 9.4% më 2016, respektivisht 5.3% më 2017. Edhe totali i shpenzimeve u rrit me 6.9% dhe 4.9% në të njëjtën periudhë, derisa pjesa e shpenzimeve kapitale mbeti e pandryshuar (26.9% të shpenzimit total më 2017). Shpenzimet kapitale janë ekzekutuar dobët, për shkak të mbivlerësimit të financimit të disponueshëm nga institucionet financiare ndërkombëtare (IFN) dhe Agjencisë së Privatizimit. Për më tepër, vjelja e dobët e të hyrave komunale, e cila lidhet me ekzekutimin e disa projekteve më të vogla kapitale ka vonuar investimet në nivel lokal. Alokimet buxhetore për beneficionet e veteranëve të luftës janë tejkaluar edhe më 2016 edhe më 2017, për shkak të numrit të pensionistëve të kualifikuar, që ishte dyfishi i shifrës së pritur. Për të kufizuar koston e skemës së pensioneve të veteranëve të luftës, është vendosur kufiri i shpenzimeve prej 0.7% të BPV-së. Megjithatë, kjo do të zbatohet vetëm pasi që një komision i posaçëm të riklasifikojë të gjithë pranuesit e kualifikuar, në bazë të kritereve më strikte. Për shkak të vonësive në procesin e riklasifikimit, SBA-ja e FMN-së ka skaduar pa disbursimin e kështu përfundimtar. Në rishikimin buxhetor të vitit 2017, janë alokuar 26.2 milionë euro shtesë për pensionet e veteranëve të luftës, duke e çuar shumën e përgjithshme në 1% të BPV-së.

**Borxhi publik i Kosovës ka mbetur relativisht i ulët** me 16.4% të BPV-së<sup>3</sup> më 2017, por është në rritje. Norma e interesit mesatare e ponderuar ka vazhduar rënien në 1.92% për shkak të hises së madhe të kredive koncesionale nga IFN-të. Amortizimi mesatar i borxhit vendor (20.2 muaj) ka gjasë të vazhdojë rritjen, pasi që Kosova ka lëshuar për herë të parë letra me vlerë me maturim shtatëvjeçar në gusht të vitit 2017. Depozitat qeveritare janë rritur në dy vitet e fundit në 5.3% të BPV-së, mbi kriterin rregullativ.

**Buxheti i 2018-ës projektton financa publike stabile, por mund të ketë nevojë për korrigjime të konsiderueshme gjatë rishikimit të ndërmjetëm.** Rritja e parashikuar totale e të hyrave (8.3% krahasuar me rezultatet preliminare të vitit 2017) do të varet nga zgjerimi i konsiderueshëm i bazës tatimore, që lind nga lufta ndaj informalitetit, pasi që nuk planifikohen masa të reja për të ardhurat më 2018. Me fillim në vitin 2018, rritja e faturës së pagave do të kufizohet tek norma e rritjes së BPV-së së fundit të disponueshme nominale (aktualisht 4.3%). Kështu që pagat publike do të rriten me 4%, derisa pjesa tjetër do të shpenzohet në rekrutime të reja. Shuma e ndarë për programet e ndryshme të beneficioneve të veteranëve të luftës ka gjasë të jetë e pamjaftueshme, përveç nëse procesi i riklasifikimit rishikon edhe certifikatat e pensionistëve ekzistues. Kostoja e skemës së invaliditetit të veteranëve të luftës do të mund të rritej edhe përtej alokimit buxhetor, pasi që më se 3.000 aplikues të rinj presin për certifikim. Rritja e shpenzimeve kapitale (37.1%) duket tejet ambicioze. Kapaciteti i Kosovës për të absorbuar fonde do të duhej rritur në masë të konsiderueshme për të arritur vlerësimet e disbursimeve nga IFN-të në kuadër të

<sup>3</sup> Duke mos përfshirë hisen e Kosovës në borxhin e ish-Jugosllavisë nga Klubi i Londrës dhe parisit, që aktualisht vlerësohet të jetë rreth 6% të BPV-së.

“klauzolës së investimeve”. Deficiti, sipas rregullit fiskal, pritet të jetë 1.7% të BPV-së, por rishikimi buxhetor mund të transferojë fonde nga buxheti kapital për të financuar shpenzimet e rritura sociale.

### **Qeverisja fiskale ka arritur pak progres, por ende përballet me sfida të konsiderueshme.**

Derisa ka në dispozicion të dhëna fiskale, ende nuk janë të besueshme, e as të disponueshme në kohën e duhur. Kapaciteti për projeksione të besueshme makro-ekonomike dhe buxhetore mbetet i dobët, si dhe varet gjerësisht nga projeksionet e FMN-së. Megjithatë, besueshmëria e projeksioneve në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe vlerësimeve buxhetore është rritur. Pjesërisht si pasojë e një realizmi më të madh në projektim të të hyrave, kontrollet e rritura të zotimeve, si dhe përdorimi efektiv i rialokimeve buxhetore brenda vitit, devijimet ndërmjet vlerësimeve parashikuese dhe të hyrave e shpenzimeve reale janë zvogëluar në masë të konsiderueshme. Janë bërë edhe përpjekjet fillestare për të angazhuar Komisionin për Buxhet e Financa në diskutime, por kjo praktikë ende nuk është sistematike. Kosova operon dhe respekton sistemin vetanak të rregullave fiskale, që synon të baraspeshojë disiplinën fiskale dhe nevojat për investime. Sistemet e kontabilitetit publik mbulojnë shumicën e fushave të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe i nënshtrohen kontrollit të brendshëm dhe auditimeve të pavarura.

**Përdorimi i njëanshëm i Euros nga Kosova e bën stabilitetin makro-fiskal dhe financiar edhe më të rëndësishëm.** Kosova nuk ka vegla standarde të politikave monetare në dispozicion, pasi që përdor Euron si valutë ligjore, duke i lënë politikat fiskale si instrumenti kryesor i politikave makroekonomike. Borxhi publik është ende i ulët, derisa nivelet aktuale të rezervave ndërkombëtare janë adekuate dhe ofrojnë një mbulesë ndaj tronditjeve të jashtme dhe atyre të likuiditetit.

#### Funksionimi i tregjeve të produkteve

##### *Ambienti afarist*

**Është arritur progres i konsiderueshëm në përmirësimin e ambientit afarist.** Është vendosur një sistem elektronik për raportimin dhe pagesën e TVSH-së dhe kontributeve sociale, duke lehtësuar pagesat tatimore për biznese. Periudha kohore që është dashur për eksportim, si dhe kostoja e përputhshmërisë rregullative për të mundësuar eksportin, u zbutën për shkak të një sistemi menaxhues të dhënash automatike doganore më të mirë, harmonizimit të proceseve të zhdoganimit, si dhe implementimit të korridorit tranzit Shqipëri-Kosovë. Fillimi i biznesit është bërë më i lehtë duke iu falënderuar një sistemi elektronik të regjistrimit të bizneseve, si dhe thjeshtësimit të procesit të regjistrimit të punëtorëve. Qasja në kredi është bërë më e lehtë me miratimin e rregullave të qarta prioritare në procedurat e bankrotimit për kreditorë të siguruar. Zgjidhja e paaftësisë së pagesës është bërë më e lehtë me vendosjen e kornizës ligjore për paaftësinë e pagesës së korporatave. Ligji i ri për Shoqëritë Tregtare do të thjeshtojë edhe më shumë procedurat e regjistrimit të bizneseve, si dhe të sjellë ndryshime në qeverisjen korporative.

**Përkundër përparimit në rregulla ligjore për bizneset, mbesin ende shumë pengesa.** Më 2017, Kosova ishte njëra prej 10 reformatoreve më të mëdha sipas Raportit të Bankës Botërore të të Bërit Biznes (*Doing Business*). Megjithatë, barrierat kryesore ndaj biznesit vazhdojnë të jenë administrata e dobët dhe jollogaridhënëse, sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni dhe ekonomia joformale mjaft e përhapur. Edhe pse informaliteti mbetet i lartë, rreth 30% e BPV-së, studime të ndryshme theksojnë rënien e vazhdueshme të tij ndërmjet viteve 2013 dhe 2015, për shkak të efektshmërisë së rritur të praktikave të administratës tatimore. Megjithatë, ekonomia e zezë është rritur në terma absolutë. Sektori i ndërtimit dhe ai tregtar kanë pësuar humbjet më të mëdha në të ardhura për shkak të informalitetit. Sistemi gjyqësor vuan nga qasshmëria e dobët, joefikasiteti dhe vonesat. Shumë pak përparim është shënuar në zvogëlimin e masës së rasteve të pazgjidhura në gjykata.

##### *Ndikimi shtetëror në tregjet e produkteve*

**Ndihma nga shteti dhe subvencionet ende administrohen pa ndonjë strategji gjithëpërfshirëse apo ndonjë vlerësim kosto-përfitim.** Ndërmarrjet publike vazhdojnë të marrin subvencione e grante qeveritare me pak ndikim në fitimprurjen e tyre. Procedurat e emërimit të menaxhmentit

kanë vazhduar t'i nënshtrohen ndikimeve partiake e politike, duke shpjerë drejt keqmenaxhimit në përgjithësi dhe vonesave në emërimet. Lirimet tatimore për disa sektorë janë zgjeruar, por kanë pasur ndikim të kufizuar deri tash në eksporte e investime. Qeveria ka vazhduar të ofrojë subvencione bujqësore, por procesi i komasacionit të tokës nuk po implementohet, duke çuar drejt përfitimeve të dobëta në prodhimtari në këtë sektor. Ligji për Investime Strategjike ende nuk ka pasur ndonjë ndikim në tërheqje të investimeve. Përkrahja financiare për zonat ekonomike dhe parqet industriale ka vazhduar pa ndonjë plan të qartë apo ndonjë analizë transparente të ndikimit apo hendeqeve. Ndikimi i qeverisë në kontrollimin e çmimeve për ndërmarrje publike dhe shërbime postare dhe telekomunikuese ka vazhduar. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP) mund të humbë kuorumin, si dhe të bëhet jofunksional, pasi që dy anëtarë bordi përballen me akuza korrupsioni. Për më tepër, frikësimi i raportuar i anëtarëve të OSHP-së dëmton këtë mekanizëm të rëndësishëm ankesash, duke dobësuar edhe transparencën dhe besueshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit.

#### *Privazimi dhe ristrukturimi*

**Statusi i pazgjidhur i të drejtave pronësore dhe procedurat e stërzgjatura ligjore në trajtimin e pretendimeve financiare ndaj asetëve të privatizuara dëmtojnë procesin e privatizimit.** Në nëntor të vitit 2017, qeveria vendosi që përkohësisht të pezullojë privatizimin e tokave në pronësi shoqërore. Studimi i fizibilitetit për kompleksin minerar Trepça është përgatitur. Megjithatë, ndërrimet e strukturës pronësore në kompani aksionare, siç kërkohen me ligj, nuk janë bërë ende për shkak të mosveprimit të qeverisë, si dhe problemeve me emërimin e bordit mbikëqyrës. Pas dështimit në materializim në vitin 2017, disbursimi prej 86 milionë Eurosh nga Agjencia e Privatizimit prapë është parashikuar për buxhetin e vitit 2018.

#### Funksionimi i tregut financiar

##### *Stabiliteti financiar*

**Sektori financiar ka vazhduar të jetë i kapitalizuar mirë, si dhe me mbulesa të bollshme të likuiditetit.** Kapitali rregullativ ndaj asetëve të ponderuara për rrezik në sektorin bankar kanë qëndruar në 18% në dhjetorin e vitit 2017, mbi minimumin rregullativ prej 12%. Rreziqet kreditore janë të ulëta, pasi që norma e kredive joperformuese, të cilat janë plotësisht të mbuluara me provizione bankare, është më e ulta në rajon, si dhe ka rënë më tutje me 3.1% deri në dhjetor të vitit 2017. Kjo ka ndodhur për shkak të rritjes më të fortë kreditore, performancës së mirë ekonomike, si dhe përmirësimeve në procedura të bankrotimit dhe paaftësisë së pagesës. Sektori financiar ka shënuar fitimprurje të lartë në vitin 2017. Shkalla e kthimit mbi ekuitetin mesatar ishte 21.3%, 17,6 % dhe 17,7 % për sektorin bankar, respektivisht institucionet mikrofinanciare dhe sektorin e sigurimeve. Banka Qendrore e Kosovës së fundmi ka lidhur një memorandum bashkëpunimi me Autoritetin Bankar Evropian dhe me Autoritetin Evropian për Sigurime dhe Pensione të Punës, duke vendosur kështu një kornizë të bashkëpunimit dhe këmbimit të informacioneve për përforcimin e rregullimit bankar dhe mbikëqyrjen e bankave që funksionon në BE dhe vendet e Evropës Juglindore.

##### *Qasja në financa*

**Sektori financiar i Kosovës ende reflekton hapësirë të mjaftueshme për veprimtari edhe më të fortë bankare.** Sektori bankar, kryesisht në pronësi të huaj, në Kosovë përbën 65,7% të asetëve të përgjithshme të sektorit financiar, pasuar me fondet e pensioneve (28%). Asetet totale në sektorin bankar ishin rritur me 6.6

% më 2017, duke qëndruar në 61.3 % të BPV-së. Veprimtaria huadhënëse është përsheptuar në krahasim me vitin paraprak (11,5 % rritje në kredi totale), mbështetur nga huadhënia e madhe për ekonomi familjare (12,7% rritje). Raporti kredi-depozita janë rritur në 80,4 % nga 76,9 % më 2016. Norma mesatare e interesit në kredi është ulur më 2017 në 6,8% nga 7,5% më 2016, por ende mbetet mbi mesataren rajonale.

**Sektori i sigurimeve është dobët i mbikëqyrur, përkundër përmirësimeve në transparencë.** Sektori dominohet nga kompani sigurimesh jo-jetësore. Kostoja e sigurimeve të automjeteve është artificialisht e lartë, pjesërisht për shkak se Kosova nuk është anëtare e sistemit të “kartonave të gjelbër”, por edhe për shkak se nuk ka liberalizuar plotësisht çmimet e sigurimit të përgjegjësishë së palës së tretë.

#### Funksionimi i tregut të punës


**Rritja stabile ekonomike në vitet e fundit ka arritur të përmirësojë vetëm në margjina kushtet e tregut të punës.** Që prej vitit 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës ka prodhuar të dhënat e anketës tremujore të fuqisë punëtore (LFS). Megjithatë, mbeten çështjet e ndërlydhura me krahasueshmërinë e serive tremujore dhe vjetore. Sipas LFS-së, norma e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkalla e punësimit janë rritur në nëntë muajt e parë të vitit 2017 në 42,7 %, respektivisht 29,7 %, krahasuar me

38,7 % dhe 28% më 2016. Njëkohësisht, shkalla e papunësisë u rrit në 30,4%, krahasuar me 27,5 % më 2016, si dhe Kosova ende ka papunësinë më të lartë dhe normën më të ulët të pjesëmarrjes në Evropë. Rezultatet e tregut të punës për gratë janë posaçërisht të dobëta (vetëm

20.2 % të grave morën pjesë në tregun e punës dhe 38 % të këtyre ishin pa punë në 9 muajt e parë të vitit 2017). Papunësia e lartë rinore (51.6 %) demonstroi qartë përafrimin e munguar mes rezultateve të sistemit arsimor dhe nevojave të tregut të punës (pra, mospërputhje mes kualifikimeve dhe shkathësisë të studentëve dhe asaj që kërkohet në tregun e punës). Kjo kërkon politika më aktive të tregut të punës, skema para-kualifikimi dhe programe aftësimi profesional. Në të kundërtën e kësaj, Kosova nuk ka ndonjë problem me legjislacionin e mbrojtjes së punëtorëve, tatimimin e lartë apo sistemin e mirëqenies sociale që do të destimulonte punën, me përjashtim të transfereve të pashënjestruara të veteranëve të luftës. Financimi për shërbime punësimi dhe aftësim profesional mbetet i pamjaftueshëm, si dhe është i fragmentuar në disa subjekte. Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, kryer nga Agjencia Statistike e Kosovës, paga mesatare mujore e sektorit privat më 2016 ishte rreth 359 Euro, 1,4 % më e lartë se më 2015.


**Figura 3 Papunësia në Kosovë**

(% e popullatës aktive)



**Figura 4 Normat e pjesëmarrjes në Kosovë**

(% e fuqisë punëtore)



*Burimi: Eurostat, Burime nga Kosova*

### 3.2 Kapaciteti për përballje me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Kosova ka bërë **pak progres** dhe është në **fazë të hershme** në kuptimin e kapacitetit për t'u përballur me trysinë konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së. Nuk është arritur ndonjë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe adresimit të hendeqeve të shkathtësive në tregun e punës. Kosova ka arritur pak përparim në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por mbeten hendeqe të mëdha infrastrukturore në sektorin e hekurudhurave dhe atë të energjisë. Ndryshimet strukturore në ekonomi janë të ngadalshme, pasi që mbetet e mbështetur tek sektori i tregtisë me pakicë. Integrimi në BE pengohet nga implementimi i ngadalshëm i MSA-së.

Në periudhën vijuese, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme:

→ adresimit të mospërputhjeve të rezultateve në arsim dhe nevojave të tregut të punës, që shpien drejt papunësisë së lartë të rinisë;

→ rritjes së kapaciteteve të pushtetit qendror dhe atij lokal për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve investuese;

→ sigurimit të furnizimit stabil të energjisë, duke zvogëluar humbjet e distributionit në rrjetin elektrik, si dhe duke rritur eficiencën e energjisë.

#### Arsimi dhe inovacioni

**Sektori arsimor nuk është mirë i harmonizuar me nevojat e tregut të punës, duke rezultuar me punësueshmëri të dobët të të diplomuarve dhe premium të konsiderueshëm të shkathtësive.** Shpenzimet publike në arsim mbetën të pandryshuara me 4,6 % të BPV-së më 2016, që është përgjithësisht në përputhje me vendet me të ardhura të mesme, me profile të ngjashme moshore. Megjithatë, duke marrë parasysh numrin relativisht të lartë të nxënësve, Kosova shpenzon mjaft më pak sesa disa vende fqinje për nxënës në arsimin fillor dhe të mesëm. Për më tepër, shpenzimi në arsim dominohet nga fatura e pagave. Shkalla e kujdesit të hershëm femëor dhe ajo e regjistrimit në parashkollor janë tejet të ulëta, me 4,4 %, respektivisht 33,9 %, prapë mjaft nën cakun e BE-së prej 95 % deri më 2020. Në të kundërtën e kësaj, normat e regjistrimit në arsimin fillor dhe të mesëm janë relativisht të larta, me 96 %, respektivisht 88,1 %. Regjistrimi në nivelin terciar është tejet i lartë, me 120.000 studentë në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Megjithatë, vlerësimi i dobët në PISA dhe shkalla e lartë e papunësisë tek të diplomuarit e arsimit të lartë (26,7 % në TM3 2017) tregojnë për cilësinë e dobët të arsimit në përgjithësi, si dhe për mospërputhjen e tij me nevojat e tregut të punës. Në këtë situatë, Kosova duhet të punojë për të vendosur bashkëpunim më të afërt mes sistemit arsimor dhe sektorit privat.

**Shpenzimet në hulumtime praktikisht nuk ekzistojnë fare.** Kosova duhet që të rrisë në masë të konsiderueshme investimet në hulumtime e inovacion (aktualisht vetëm 0.1 % të BPV-së), si dhe të krijojë lidhje mes institucioneve akademike dhe sektorit privat. Në shtator të vitit 2017, u krijua një Ministri e re e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, e mandatuar me përkrahjen për ndërmarrësinë dhe iniciativat private përmes inovacionit, me fokus në zhvillimin e NVM-ve prodhuese dhe shërbyese.

#### Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

**Kosova ka shënuar pak progres në përmirësimin e kapitalit të saj fizik, kryesisht në investime në infrastrukturë rrugore publike.** Megjithatë, sistemi transportues i Kosovës është i pllakosur nga kapaciteti i dobët administrues i institucioneve rregullative dhe gjendja e dobët e infrastrukturës. Investimet në infrastrukturë rrugore fokusohen kryesisht në riparime rrugësh dhe ndërtim autostradash. Përveç këtyre, investimet në sisteme të ujitjes, trajtimit e ujërave të zeza, projektet ujore, përmirësimin e institucioneve shëndetësore, transport publik komunal dhe avancim të sektorit hekurudhor, po mbështeten nga donatorët. Rehabilitimi i linjës hekurudhore 10, prioritet kyç i Komitetit Shtetëror të Investimeve, është projekti i parë që do të implementohet në përputhje me agjendën rajonale të lidhjeve.

**Mungesa e lidhjeve rajonale në transport e siguri të energjisë mbetet fyt i ngushtë për ekonominë.** Furnizimi i paqëndrueshëm i energjisë mbetet një prej pengesave kryesore ndaj zhvillimit ekonomik. Linja e interkoneksionit mes Shqipërisë dhe Kosovës - kryer më 2016 - ende nuk ishte funksionale deri në fund të vitit 2017, për shkak të mospajtimit politik me Serbinë. Marrëveshja për ndërtimin e termocentralit të ri me linjit me kapacitet 500-megavatësh është lidhur, ndërsa ndërtimi pritet të fillojë në fillim të vitit 2019. Projekti me vlerë prej 1.3 miliardë eurosh do të financohet krejtësisht nga investitori, si dhe pritet të sigurojë furnizim më të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Humbjet e larta të distribucionit në rrjetin elektrik, si dhe eficientia e dobët energjetike edhe më shumë dobësojnë sigurinë energjetike. Çështja mund të adresohet duke zgjeruar stimujt e eficientës së energjisë drejt sektorit privat dhe ekonomive familjare. Që prej prillit të vitit 2017, prodhuesit e energjisë obligohen të dorëzojnë të gjithë energjinë elektrike të gjeneruar me çmime të parregulluara, duke ndihmuar në hapjen e tregut të energjisë elektrike. Prodhimi i energjisë elektrike nga burime të ripërtërishme është në nivele tejet të ulëta, përkundër potencialit të vërtetuar për shfrytëzim të energjisë diellore dhe të erës.

**Digjitalizimi i ekonomisë nuk ka përparuar shumë gjatë vitit të kaluar.** Kosova gradualisht po përafron legjislacionin vendor me *acquis*, por zbatimin e tij po ngec. Një numër më i madh i bizneseve po bën e-tregti. Megjithatë, të dhënat e sakta ende nuk janë publikuar. Shkalla e penetrimit të internetit të brezit të gjerë fiks është duke u zgjeruar vit pas viti, duke arritur në 86,7 % gjatë çerekut të parë të vitit 2017, krahasuar me 75,5% një vit më herët. Përveç kësaj, numri i abonuesve të telefonave mobilë është rritur në 112,14 % në krahasim me 97,08 % një vit më herët. Numri i punëtorëve dhe pjesa e vlerës bruto të shtuar (GVA) në industrinë e TIK-ut gradualisht janë rritur që prej vitit 2008, por ende mbeten të ulëta, përkundër potencialit të bollshëm për zhvillim edhe më të fuqishëm.


#### Struktura sektorale dhe e ndërmarrjeve

**Nuk ka pasur ndryshime të mëdha strukturore të ekonomisë së Kosovës.** Sektori privat në Kosovë vazhdon të jetë i fragmentuar dhe i paafhtë të shfrytëzojë ekonominë e shkallës, pasi që mikro-ndërmarrjet e dominojnë ekonominë. Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve për vitin 2016, numri më i madh i ndërmarrjeve në Kosovë i përket sektorit të tregtisë (47,7%), pasuar nga shërbimet afariste dhe shërbimet tjera (13,6 %) dhe industria përpunuese (13,5 %). Numri i përgjithshëm i njerëzve të punësuar në sektorin privat ishte 156.504, nga të cilët: sektori tregtar merr 34,9 %; industria përpunuese 15,6 %, ndërsa shërbimet afariste 11,8 %. Hisja më e madhe e qarkullimit total të biznesit ishte në sektorin e tregtisë me 57,5%, pasuar nga industria përpunuese me 11,9% dhe ndërtimi me 10,5%. Struktura e GVA-së në Kosovë nuk ka ndryshuar në masë të madhe në vitet e fundit, përveç një trendi të vërejtshëm të uljes në pjesën e bujqësisë, që ka vazhduar më 2016 (në 13 %). Normat e minierave, prodhimit, ndërtimit dhe shërbimeve, vazhdojnë të pluskojnë përreth mesatareve të tyre afatgjate.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, destinuar për të ofruar garanci kreditore për investime private, është plotësisht funksional. Fondi ka dhënë 785 garanci kreditore për biznese lokale me shumë të miratuar kredie prej 29,5 milionë eurosh. Qeveria është zotuar të ofrojë financim shtesë më 2018, për të rritur kapacitetin e Fondit për garantim të kredive.

#### Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve

**Kontributi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit në rritje të tregtisë u dobësua nga implementimi i ngadalshëm i reformave të domosdoshme.** Ekonomia e Kosovës është ende relativisht e paintegruar në rrjedhat globale tregtare, me hapje të tregut prej 74,5% të BPV-së, përkundër rritjes me 10.6% në tregtinë totale të mallrave dhe shërbimeve më 2017. Shumica e eksporteve të Kosovës ende përbëhen nga lëndët e para bazë dhe produktet minerale, duke pasqyruar diversifikimin e kufizuar të sektorit prodhues në Kosovë. Megjithatë, më 2017 pati rritje të konsiderueshme në eksportet e mallrave të prodhuar, produkteve bujqësore dhe ushqimeve të përpunuara. BE-ja vazhdoi të ishte partneri më i madh tregtar i Kosovës, me 41 % të Tregtisë së përgjithshme më 2017, pasuar nga vendet e CEFTA-s<sup>4</sup> me 30.3 %. Përkundër rritjes me 30,1% të eksporteve drejt BE-së, deficitin tregtar i Kosovës me BE-në u rrit më tutje më 2017. Zhvillimi i një Zone Rajonale Ekonomike në bazë të rregullave dhe standardeve të BE-së, për të cilën janë zotuar të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, ka potencialin të gjenerojë rritjen deri tash të pashfrytëzuar. BE-ja mbetet investitori kryesor në Kosovë, me 46,4 % të rrjedhës së përgjithshme hyrëse të IHD-ve më 2017.



të gjenerojë rritjen deri tash të pashfrytëzuar. BE-ja mbetet investitori kryesor në Kosovë, me 46,4 % të rrjedhës së përgjithshme hyrëse të IHD-ve më 2017.

**4. ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE**

Fati i pazgjidhur i personave të pagjetur që nga konfliktet e viteve të 90-ta mbetet brengë humanitare në Ballkanin Perëndimor. Që prej shkurtit 2018, gjithsej 10.332 persona ende nuk janë gjetur në të gjithë rajonin, sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC). Prej këtyre, 1652 lidhen me konfliktin në Kosovë, si dhe periudhën vijuese të tij. Më 2017, u mbajtën dy seanca të Grupit Punues Beograd-Prishtinë për Personat e Pagjetur, kryesuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Emërimi i udhëheqësit të delegacionit të Prishtinës në këtë grup punues ka sjellë zhvillime pozitive. Megjithatë, mungesa e informatave të reja mbi varrezat që duhen hapur mbetet pengesa kryesore ndaj zgjidhjes së rasteve, si dhe vetëm njëmbëdhjetë raste janë zgjidhur më 2017.

Procesi i zgjidhjes së fatit të personave të pagjetur vazhdon të dëmtohet nga politizimi dhe mosmarrëveshjet ndërinstitucionale. Përpjekjet e përsëritura nga disa politikanë për të ndryshuar periudhën kohore të mbuluar me Ligjin për personat e pagjetur, që efektivisht përjashton shumë viktima jo-shqiptare, janë të papranueshme. Një zhvillim pozitiv është emërimi i procesmbajtësit për çështjen e personave të pagjetur, si dhe fakti që zëvendësshefi i Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur i përket një komuniteti jo-shumicë. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi më i mirë ndërinstitucional ndërmjet këtij Komisioni dhe Institutit të Kosovës për Mjeklsi Ligjore janë të nevojshme, edhe për lehtësimin e futjes së të dhënave në regjistrin qendror të personave të pagjetur. Autoritetet ende nuk kanë miratuar aktet nënligjore për themelimin e regjistrit qendror, si dhe për mbylljen e rasteve, për të mbështetur zbatimin e Ligjit për persona të pagjetur. Ndërsa Instituti për Mjekësi Ligjore ka bërë pak progres në zhvillim të kapaciteteve, ende nuk arrin standardet e kërkuara për praktika të qëndrueshme forenzike, duke përfshirë antropologjinë forenzike dhe arkeologjinë. Duhet të bëhet më shumë për zhvillimin e kapaciteteve të tilla, si dhe për të siguruar financimin e vazhdueshëm të Institutit. Qindra mbetje mortore të mbajtura në morgun e Prishtinës,

<sup>4</sup> Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore

për të cilat është shteruar veprimi forenzik, mbeten të pidentifikuara.

**Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** përbëjnë pjesë themelore të procesit të ecjes së Kosovës drejt BE-së. Këto pika kontribuojnë në stabilitet, pajtim dhe klimë nxitëse për adresimin e çështjeve të hapura bilaterale dhe trashëgimisë së të kaluarës. Kosova përfaqësohet në shumicën e organizatave rajonale në kuadër të fushëveprimit të Marrëveshjes për Përfaqësimin dhe Bashkëpunimin Rajonal, të lidhur mes Beogradit dhe Prishtinës, më 2012.

Momentumi i rritur përmes **procesit të Berlinit**, sidomos për agjendën e lidhjeve, ka vazhduar të nxisë bashkëpunim më të madh rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Duke u bazuar në rezultatet e samiteve të mëparshme, Samiti i Trieshtes në korrik të vitit 2017 shënoi avancime të mëtutjeshme në agjendën e lidhjeve (konektivitetit) dhe gjithashtu hapi bashkëpunimin në fusha të reja, sidomos në lidhje me Zonën Ekonomike Rajonale (REA), ku Kosova vijimisht emëroi një kontakt-person në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Pas themelimit të Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO) në Tiranë, Kosova hapi degën lokale të asaj Zyre në Prishtinë, në tetor të vitit 2017. Më tutje, Kosova nënshkroi Traktatin e Komunitetit të Transportit, por ratifikimi i tij nga Kuvendi ende nuk është bërë. Masat e transportit në pritje përfshijnë rritjen e implementimit të udhëzimeve për MIK. Projektet e lidhjeve në sektorin hekurudhor janë duke u planifikuar, si dhe puna pritet të fillojë në mesin e vitit 2018. Tek energjia, Rregullatori i Energjisë në Kosovë ka derregulluar çmimet e gjenerimit. Qeveria ka ndërmarrë hapa për t'u bashkuar me Bursën Shqiptare të Energjisë. Kosova duhet që më tutje të finalizojë procedurën teknike për themelimin e tregut funksional dhe të balansuar, si dhe të miratojë një ligj kompatibil të energjisë, i cili do të mundësonte progresin në një numër masash tjera. Kompania e Transmisionit të Energjisë Elektrike të Kosovës nuk është në gjendje të gëzojë plotësisht përparësitë e tregut rajonal të energjisë elektrike, sipas dakordimit në Samitin e Ballkanit Perëndimor të vitit 2016 në Paris. Kjo ndodh për shkak të një kontesti me Serbinë, i cili duhet të zgjidhet sa më shpejt që është e mundur përmes Dialogut Beograd-Prishtinë. Ekziston nevoja për të siguruar qasje të përballeshme në brez të gjerë. Kjo përfshin edhe përdorimin e fijeve ekzistuese optike, si ato që ofrohen përmes rrjetit të transmisionit të energjisë elektrike.

Kosova ka vazhduar përpjekjet e saj për të mbajtur **marrëdhënie dypalëshe të mira dhe konstruktive me vendet tjera të zgjerimit**.

Kosova ka vazhduar të zhvillojë marrëdhënie më të afërta me *Shqipërinë*, ku disa marrëveshje të reja në fusha kyçe të bashkëpunimit janë nënshkruar në takimin e katërt të qeverive në nëntor të vitit 2017, si dhe ka shpallur gatishmërinë për të hapur një Zyrë Doganore të Kosovës në Portin e Durrësit në Shqipëri. Një kornizë-Memorandum për bashkëpunim me diasporën është nënshkruar, ashtu si edhe Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet qeverive për të hapur konsullata të përbashkëta, ku zyrat konsullore të përbashkëta do të hapen në Mynih dhe Milano.

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim në marrëdhëniet e Kosovës me *Bosnjën e Hercegovinën*, pasi kjo e fundit nuk ka njohur pavarësinë e Kosovës. Regjimi i vizave reciproke vazhdon të jetë në fuqi.

Ka pasur përparim të mëtutjeshëm në marrëdhëniet me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë*. Në gusht të vitit 2017, vendet nënshkruan një protokoll implementimi për të hapur një pikë të re kalimi në Stancic-Belanoc. Të dyja janë pajtuar të mbajnë mbledhje të përbashkët qeveritare në baza vjetore. Kryeministri Zaev vizitoi Prishtinën në dhjetor të vitit 2017. Ca tensione u ngritën si pasojë e vendimeve për pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në ngjarjet e Kumanovës të vitit 2015.

Kosova ka marrëdhënie të mira me *Malin e Zi*. Marrëveshja për demarkimin e kufirit, tashmë e ratifikuar në Podgoricë, u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës në mars të vitit 2018. Në shkurt të vitit 2018, dy Presidentët nënshkruan një deklaratë të përbashkët në të cilën pajtoheshin që pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes për demarkimin e kufirit, do të themelohet një grup bilateral pune për të identifikuar dhe adresuar kontestet potenciale në shënimin e kufirit në sektorë specifikë. Në shkurt të vitit 2017, Kosova miratoi strategjinë për afirmimin dhe integrimin e pakicës malazeze.



Kosova ka ruajtur marrëdhëniet e mira me **Turqinë**. Ka pasur vizita të ndërsjella të nivelit të lartë, gjatë të cilave të dy vendet kanë shprehur përkushtimin e tyre për të rritur bashkëpunimin ekonomik dhe tregtinë.

## 5. NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE MES KOSOVËS DHE SERBISË

Puna në dialogun e mundësuar nga BE-ja ka vazhduar përgjatë periudhës së raportimit. Janë mbajtur katër takime zyrtare të nivelit të lartë nën lehtësimin e PLZP Mogerini në korrik, gusht dhe shtator të vitit 2017, si dhe në mars të vitit 2018. Presidentët Thaçi dhe Vuçiq u pajtuan të punojnë në një fazë të re të dialogut, me qëllim të normalizimit gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo punë aktualisht po vazhdon, si dhe duhet përshpejtuar. Takimet në nivelin teknik rifilluan herët më 2018.

Janari 2017 shënoi një përpjekje për të dërguar një tren, të shenjuar me slogane nacionaliste serbe, nga Beogradi drejt veriut të Kosovës. Pas presionit të madh nga BE-ja dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë, treni nuk hyri në veri të Kosovës.

Implementimi i **Marrëveshjeve të 25 gushtit 2015** në përgjithësi ka qenë i ngadalshëm. Është arritur progres në lidhje me **Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me shumicë serbe** në Kosovë. Më 4 prill 2018, Kosova i dha mandatin Ekipit Menaxhues që të fillojë hartimin e statutit të Asociacionit/Bashkësisë. Marrëveshja e **energjisë** mes Serbisë dhe Kosovës duhet të implementohet pa vonesë të mëtutjeshme, ashtu që të shmanget situata në të cilën ky kontest afatgjatë ka pasoja të tjera tek stabiliteti dhe siguria e energjisë në Serbi, Kosovë dhe vendet në të gjithë Evropën. Këto pasoja janë bërë më akute dhe më të dukshme në muajt e fundit. Serbia duhet të regjistrojë dhe licencojë dy kompanitë serbe të energjisë që duhen themeluar në Kosovë, si çështje urgjente. Një mur përgjatë urës në Mitrovicën e veriut u ndërtua ilegalisht në dhjetor të vitit 2016. Ai është hequr që prej atëherë. **Ura e Mitrovicës**, në të cilën punët kanë filluar në gusht të vitit 2016, duhet hapur pa vonesa apo pengesa të mëtutjeshme. Marrëveshja e **telekomit** tashmë është implementuar plotësisht. Kosova ka marrë kodin e thirrjeve për përdorim dhe operim në nëntor të vitit 2016. Serbia themeloi kompaninë e telekomunikimit si degë subsidiare e Srbija Telekom, brenda kuadrit ligjor dhe rregullativ të Kosovës.

Progres i mëtutjeshëm është shënuar në zbatimin e **“Marrëveshjes së Parë të Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve” të prillit 2013**. Marrëveshja për **drejtësinë** tashmë është implementuar plotësisht. Në tetor të vitit 2017, Presidenti i Kosovës Thaçi dekretoi 40 gjyqtarë serbë të Kosovës, 13 prokurorë dhe stafin përkatës mbështetës, duke finalizuar kështu procesin e rekrutimit të personelit gjyqësor për veriun. I gjithë ish-personeli serb gjyqësor tashmë është integruar plotësisht brenda sistemit të Kosovës, ashtu si personeli serb i **policisë dhe mbrojtjes civile**. Në kontekstin e **aranzhimeve të ndërlidhjes**, vizitat zyrtare rregullohen drejtpërdrejt nga zyrtarët ndërlidhës në përpunime me marrëveshjen përkatëse, por me raste, marrëveshja nuk respektohet plotësisht. Ngjarjet e marsit 2018, në lidhje me procedurat e hyrjes dhe trajtimin e zyrtarit qeveritar serb Marko Gjuriq, ngritën tensionet.

Disa prej **Marrëveshjeve të Dialogut Teknik (2011-2012)** nuk janë duke u zbatuar. Të dyja palët duhet të mbesin të përkushtuara ndaj zbatimit të vazhduar të marrëveshjes për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e Kosovës në **forume rajonale**. Çështja e njohjes së **diplomave universitare** ende nuk është zgjidhur, ashtu si elementet në lidhje me **tabelat e regjistrimit** nga Marrëveshja për lirinë e lëvizjes. Serbia ende nuk ka adresuar çështjen e strukturave të zhvendosura administrative serbe të doganës, me emërtim të Kosovës, që operojnë nga brenda Serbisë, si dhe nuk ka pushuar lëshimin e dokumentacionit apo vënien e vulave me emërtime që janë në kundërtënie me marrëveshjen përkatëse. Tek MIK-u, derisa pikat e përkohshme kufitare janë plotësisht funksionale, Serbia ka penguar progresin në ndërtimin e katër nga gjashtë pikave të përhershme të kalimit kufitar në Bërnjak, Jarinjë, Konqul dhe Muçibabë. Serbia duhet të ndërmarrë masa plotësuese për të mbyllur kalimet ilegale. Kërkesat për **ndihmë të ndërsjellë juridike** janë duke u proceduar. Serbia ofron përkrahje për procesin gjyqësor të udhëhequr nga **EULEX-i**.

Përgjithësisht, Kosova ka qëndruar e angazhuar në dialog. Megjithatë, Kosova duhet të bëjë përpjekje të mëtutjeshme substanciale për të kontribuar në krijimin e rrethanave që nxisin normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve me Serbinë. Marrëveshja juridikisht obligative është urgjente dhe qenësore, ashtu që Serbia dhe Kosova të mund të avancojnë më tutje në rrugët e tyre përkatëse evropiane.

## 6. STANDARDET EVROPIANE

### 6.1. Lëvizja e lirë e mallrave

Kosova është **në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje** në lëvizjen e lirë të mallrave. Ajo ka arritur **pak progres** gjatë periudhës së raportimit. Megjithatë, nga tre rekomandimet e raportit të vitit 2016, Kosova ka plotësuar vetëm pjesërisht rekomandimin për përafrimin e mëtutjeshëm me *acquis* të BE-së. Rekomandimet për zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve, rritjen e resurseve dhe bashkërendimit ndërinstitucional për të mundësuar zbatimin e ligjit, në pajtim me kërkesat e MSA-së, ende nuk janë adresuar për të siguruar implementim të mirëfilltë.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të sigurojë zbatimin e mirëfilltë të Ligjit të sapomiruar për standardizimin, Ligjin për metrologji, Ligjin për akreditim dhe Ligjin për kriteret teknike për produkte dhe vlerësim të përputhshmërisë, duke përfshirë edhe miratimin e të gjitha akteve relevante nënligjore;

→ Më tutje të përmirësojë bashkërendimin ndërinstitucional për të mundësuar zbatimin e mirëfilltë të legjislacionit dhe për të përforcuar kapacitetet e Agjencisë së Standardizimit të Kosovës, Agjencisë Metrologjike të Kosovës, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

→ Të bëjë përparim në përafrimin e saj me Rregulloren për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikalieve (REACH).

#### Parimet e përgjithshme

Tek **parimet e përgjithshme**, korniza për **prodhimin, shpërndarjen dhe marketingun e produkteve industriale** është përafruar më shumë me *acquis*. Kjo sidomos tek rasti i Ligjit për metrologjinë, Ligjit për Standardizim dhe Ligjit për kriteret teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit miratuar më 2018, si dhe Ligjit për akreditimin. Programi Nacional për implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit përcakton planifikimin për përafrimin gradual me *acquis* dhe zbatimin e tij.

#### Fushat e paharmonizuara

Legjislacioni i Kosovës duhet të përafrohet me **nenet 34-36 të Traktatit** për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFEU) Sidoqoftë, ende nuk është hartuar plani i veprimit për të siguruar këtë përafrim.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është autoriteti kompetent për të siguruar **obligimin për njoftim** për rregulloret teknike në fazën e hartimit, sipas kriterëve të vlefshme të BE-së dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

#### Fusha e harmonizuar: infrastruktura e cilësisë

Baza ligjore për rregulloret teknike, standardet, vlerësimin e konformitetit si dhe akreditimin është pjesërisht e përafruar me *acquis*, sidomos tek metrologjia; sidoqoftë, nevojitet punë e mëtutjeshme në legjislacionin e mbikëqyrjes së tregut. Organet e vlerësimit të cilësisë, standardeve dhe akreditimit kanë staf dhe resurse financiare të kufizuara, gjë që i pengon ato në implementim të plotë të *acquis*.

Ligji i ri për **Standardizimin** u përafraua më tutje me *acquis*; ai shtron kornizën për standardizimin dhe zhvillimin e mallrave dhe funksionimin e Agjencisë Kosovare të Standardizimit. Edhe pse

Kosova nuk është anëtare e Komitetit Evropian për Standardizim/Komitetit Evropian për Standardizim Elektro-Teknik (CEN/CENELEC), më 2017, CEN/CENELEC u pajtua t'i mundësonte Agjencisë qasje të drejtpërdrejtë në standardet e BE-së. Agjencia ka miratuar 647 standarde evropiane në periudhën e raportimit. Megjithatë, duhen adresuar pengesat që kufizojnë shitjen në internet të standardeve.

Ligji i ri për **Akreditimin**, miratuar në janar të vitit 2017, ngriti Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit në nivel të organit administrativ në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Kjo ishte konsideruar si një prej parakushteve që Kosova të nënshkruante Marrëveshjen Shumëpalëshe të Bashkëpunimit Evropian për Akreditim. Është miratuar politika dhe strategjia e akreditimit 2016-2020 për Drejtorinë, por resurset e kufizuara dhe mungesa e drejtorit të përgjithshëm që prej mesit të vitit 2016 e ka vënë zbatimin e tyre në rrezik.

Aktualisht ekzistojnë 39 trupa të akredituara **të vlerësimit të konformitetit** në Kosovë, si dhe 4 të tjera janë në proces të akreditimit. Megjithatë, kapaciteti dhe puna e tyre duhet përforcuar.

Tek **metrologjia**, Kosova miratoi legjislacionin me qëllim të përafrimit me Direktivën e Instrumenteve Matëse të vitit 2016, por legjislacioni sekondar ende ka nevojë të përafrohet me Direktivën e Instrumenteve Matëse Jo-Automatike. Gjithashtu, mungesa e stafit të kualifikuar dhe laboratorëve plotësisht funksionalë në Agjencinë Metrologjike të Kosovës minon implementimin e të dyja Direktivave në disa sektorë.

Tek **mbikëqyrja e tregut**, baza ligjore është Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, dizajnuar për t'u përafuar me *acquis*. Megjithatë, organi i mbikëqyrjes së tregut përballet me vështirësi në zbatim të Ligjit, për shkak të mungesës së stafit dhe financimit. Bashkërendimi ndërinstitucional është përmirësuar që prej themelimit të Trupit Koordinues të Mbikëqyrjes së Tregut. Aktualisht, nuk mund të bëhen inspektime në veri të Kosovës për shkak të mungesës së hapësirave, pas sulmit me bomba më 2017.

Më 2017, u kryen 266 inspektime për sigurinë e produkteve në Kosovë, ku u identifikuan 249 lloje të rrezikshme të produkteve, si dhe si pasojë, të gjitha produktet e dëmshme u larguan përgjithmonë nga tregu.

#### Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Tek legjislacioni i **Qasjes së Re dhe Globale të produkteve**, Kosova ka miratuar legjislacionin për të rritur nivelin e përafrimit me *acquis* të BE-së për sigurinë e lodrave, përputhshmërinë elektromagnetike, si dhe sigurinë e ashensorëve. Mungesa e kapaciteteve në infrastrukturën e cilësisë pengon implementimin e legjislacionit të miratuar së voni.

Nuk ka pasur progres në përafrimin me *acquis* të legjislacionit të produkteve **të Qasjes së Vjetër** e as **tek masat procedurale**. Kosova duhet të rrisë nivelin e përafrimit dhe të përforcojë më tutje kapacitetet e saj administrative për të siguruar zbatim efektiv të Rregullores për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikalieve (REACH).

Kosova ka përafrim të pjesshëm me *acquis* për Produktet e qelqit kristalor.

## **6.2. Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit**

Kosova është në masë **të moderuar e përgatitur** për lëvizjen e lirë të personave dhe shërbimeve dhe të drejtën e themelimit. **Pak progres** është bërë në përafrimin me Direktivën e Shërbimeve, duke miratuar Ligjin për shërbimet. Sidoqoftë, duhet të bëhet më shumë në përmirësim të efektshmërisë në këtë fushë.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të heqë barrierat e identifikuar ndaj lëvizjes së lirë të shërbimeve;
- të përafrohet me *acquis* për nostrifikimin e kualifikimeve profesionale;

Tek **lëvizja e personave**, në lidhje me qasjen në tregun e punës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka lëshuar 105 certifikata të punës për periudha prej 90 ditësh për shtetas të huaj gjatë periudhës së raportimit. Tek koordinimi i sistemeve të sigurimit social, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nënshkruar një Marrëveshje për Sigurimet Sociale me Belgjikën, në shkurt të vitit 2018, si dhe aktualisht po negocion marrëveshjen e sigurimeve sociale me Zvicrën. Kosova ka marrëveshje funksionale me Malin e Zi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë për konfirmimin e periudhave të sigurimit social.

Tek **liria për ofrimin e shërbimeve**, Ligji i ri për shërbime, miratuar në mars të vitit 2017, është vetëm pjesërisht në përputhje me Direktivën e Shërbimeve. Ligji nuk është i përafuar me dispozitat për shërbimet ndërkufitare dhe bashkëpunimin administrativ, ndërsa disa prej dispozitave të tij hyjnë në fuqi disa vjet pas publikimit. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, ka kontrolluar legjislacionin ekzistues për përaftrim me Direktivën e Shërbimeve të BE-së. Sipas këtij kontrollimi, 25 ligje dhe 29 akte nënligjore duhen ndryshuar e plotësuar, ashtu që Kosova të jetë plotësisht e përafuar me Direktivën e Shërbimeve të BE-së deri më 2022. Qeveria ka miratuar udhëzimin administrativ për procedurën e njoftimit dhe vlerësimin e përputhshmërisë së projekt-akteve normative me Ligjin për shërbimet. Ai obligon autoritetet kompetente që të kërkojnë mendim ligjor pozitiv për projektligjet e ardhme që bien në fushëveprimin e ligjit të ri.

Tek e **drejta e themelimit**, regjistrimi i përgjithshëm në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës është obligativ për çdo individ apo biznes që dëshiron të bëjë biznes. Në një numër profesione të rregulluara, si drejtësia dhe auditimi, ka nevojë të bëhet regjistrimi në një regjistër apo shoqatë të posaçme, specifike për sektorin e shërbimeve. ofruesit e huaj të shërbimeve lejohen të ofrojnë shërbime në Kosovë vetëm përmes themelimit, që do të thotë se legjislacioni nuk mundëson shërbime të lira ndërkufitare në baza të përkohshme.

Qeveria ka miratuar udhëzimin administrativ për operimin e Pikës së Kontaktit të Vetëm. Ky udhëzim synon të lehtësojë qasjen në shërbime për ofruesit dhe përfituesit e tyre. Udhëzimi gjithashtu rregullon përgjegjësitë e organeve kompetente për Pikën e Kontaktit të Vetëm. Kosova ka vazhduar të përafrojë gradualisht kornizën e saj ligjore të **shërbimeve postare** me *acquis*. Më 2017, po përgatitej Ligji i ri për shërbime postare, me plane për miratim në vitin 2018. Paralelisht, duhen hartuar aktet nënligjore për implementimin teknik të Ligjit, si dhe të caktohen afatet për përparimin me procesin ligjvënës. Shërbimi postar universal ende nuk ofrohet në 30% të territorit. Kufizimi i peshës për zonat e rezervuara duhet zvogëluar edhe më shumë për të liberalizuar plotësisht tregun postar.

Tek **nostrifikimi i kualifikimeve profesionale**, Ligji për profesionet e rregulluara në Kosovë, miratuar në tetor të vitit 2016, është përgjithësisht i përafuar me *acquis* të BE-së. Ligji përkufizon 16 profesione, të quajtura profesione sektoriale të rregulluara (si mjekët, dentistët, farmacistët, kirurgët veterinarë, mamitë, motrat medicinale dhe arkitektët), për të cilët Direktiva për nostrifikimin e kualifikimeve profesionale kërkon një trajnim minimal të harmonizuar, si dhe më tutje përcakton disa kritere të përgjithshme për qasje në profesionet e rregulluara. Ministria e Arsimit, bashkë me Qendrën Nacionale për Njohjen dhe Informimin Akademik të Kosovës janë autoritetet kompetente me kompetenca rregullative dhe autorizuese. Për më tepër, dy organe vendim-marrëse, Agjencia Shtetërore e Provimeve dhe Këshilli Shtetëror për Profesionet e Rregulluara janë paraparë me ligj, por nuk janë themeluar ende.

Përkundër progresit të arritur, Kosova duhet të zhvillojë strukturat e domosdoshme dhe rregullat për njohjen/nostrifikimin e kualifikimeve profesionale të fituara në vendet tjera, për të mundësuar lëvizjen ndërkufitare të profesionistëve dhe shërbimeve.

### 6.3. Lëvizja e lirë e kapitalit

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** për këtë fushë. **Pak progres** është bërë tek shërbimet e pagesave. Megjithatë, rekomandimi i raportit të fundit për të siguruar trajtimin e barabartë të shtetasve të BE-së që blejnë pronë të paluajtshme në Kosovë, si dhe për të rritur përpjekjet në luftim të krimit ekonomik dhe financiar, nuk është adresuar.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të bëjë hapa në ofrimin e trajtimit shtetëror për shtetasit e BE-së që përvetësojnë pronë të paluajtshme në Kosovë brenda 5 vitesh nga hyrja në fuqi e MSA-së (deri më 2021);
- të rrisë përpjekjet për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar, si dhe të përafrojë Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit me *acquis* të BE-së.

Tek **lëvizjet e kapitalit dhe pagesat**, lëvizja e kapitalit mbetet përgjithësisht e lirë në Kosovë, pa kufizime tek pronësia e huaj apo tek investimet në sektorin financiar. Përparim i mirë është bërë me vendosjen obligative të IBAN-it për pagesat vendore dhe ndërkufitare. Ekzekutimi i transaksioneve paguese kufizohet tek bankat dhe institucionet financiare jo-bankre, të cilat licencohen nga Banka Qendrore për të kryer aktivitete të tilla (pagesa dhe transferta parash).

Shtetasit e huaj ende nuk lejohen të përvetësojnë pronë të paluajtshme në Kosovë. Nuk është bërë ndonjë përparim në përafrimin e dispozitave të ligjeve përkatëse, akteve nënligjore dhe praktikave administrative që vazhdojnë të jenë pengesë për trajtimin e barabartë.

Ligji për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është vetëm pjesërisht në përputhje me *Acquis* dhe rekomandimet e Task-Forcës Vepruese Financiare (FATF). Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën ndaj krimit ekonomik dhe financiar duhet siguruar për të pasur hetim dhe ndjekje penale të mirëfilltë të veprave.

### 6.4. Shërbimet financiare

Kosova ka **përgatitje mesatare** në fushën e shërbimeve financiare. **Pak progres** është bërë gjatë perudhës së raportimit në mbikëqyrje bankare dhe të institucioneve kreditore.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të implementojë dhe të ekzekutojë plotësisht masat e Solvencës I;
- të miratojë ndryshimet në kornizën ligjore të Kosovës për institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare për ta përafuar me *acquis* të BE-së;
- të miratojë ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Tek **bankat dhe konglomeratet financiare**, është bërë pak progres në zbatimin e mbikëqyrjes bankare, që synon të përforcojë qeverisjen korporative dhe menaxhimin e riskut kreditor. Banka Qendrore duhet të sigurojë mbrojtje adekuate të konsumatorëve dhe parandalim të praktikave të padrejta bankare. Kosova duhet të krijojë një autoritet të pavarur të rikuperimit dhe zgjidhjeve. Tek harmonizimi i kornizës rregullative me standardet Bazel II dhe të BE-së, Kapitulli për Shumat e Ekspozimit me Normim Risku ende nuk është miratuar. Në mars të vitit 2017, Banka Qendrore nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Autoritetin Bankar Evropian, duke vendosur kështu një kornizë bashkëpunimi dhe këmbimi informatash, si dhe për Mekanizmin e Përbashkët Mbikëqyrës Evropian. Ky i fundit ende nuk është nënshkruar me Bankën Qendrore Evropiane. Legjislacioni për institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare ende nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim nuk është miratuar ende.

Tek **sigurimet dhe pensionet e punës**, masat Solvency I duhen zbatuar dhe ekzekutuar plotësisht. Ende nuk kanë filluar përgatitjet për të vendosur masa të përafuara me Direktivën Solvenca II. Ligji i sigurimeve është i përafuar me *acquis* të BE-së për ushtrimin dhe zbatimin e biznesit të sigurimeve, ri-sigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime. Mbikëqyrja dhe kontrollimi i fondeve të pensioneve të punës duhen përmirësuar. Pak progres është bërë në rritjen e transparencës së shërbimeve të sigurimit, gjegjësisht duke publikuar në internet raportet vjetore të auditimit, por nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të rritur kushtet për dhënien e licencave për kompani të reja të sigurimeve. Nevojitet edhe bashkërendimi më i mirë ndërinstitucional për të adresuar çështjen e veturave të pasiguruara e të peregjistruara. Për shkak të pamundësisë që Kosova të jetë pjesë e sistemit të “kartonit të gjelbër”, sigurimi i automjeteve vazhdon të kërkohej për veturat me regjistrime të huaja që hyjnë në Kosovë dhe për automjetet me tabela kosovare që dalin nga Kosova. Kjo nuk vlen për vendet me të cilat Kosova ka rregullime bilaterale të sigurimeve të automjeteve.

Tek **tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet investuese**, Banka Qendrore vë në ankand letrat me vlerë të qeverisë dhe mban dosjet, të cilat ruhen dhe përpunohen në mënyrë elektronike.

## 6.5. Dogana

Kosova ka **përgatitje mesatare** në fushën e doganave. Ka pasur **pak përparim**, sidomos në implementimin e deklarimeve pa letër dhe thjeshtimin e procedurave administrative. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të përafrojë më tutje legjislacionin doganor, duke përfshirë kodin doganor dhe të akcizës, me Kodin doganor të BE-së dhe *acquis për akcizën*;

→ të përshkallëzojë bashkërendimin ndërmjet Doganës së Kosovës, agjencive ligjzbatuese dhe institucioneve tjera relevante në luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimeve doganore.

Tek fusha e **legjislacionit doganor**, kodi doganor dhe akcizës është përgjithësisht i përafuar me kodin doganor të BE-së, por ende nevojitet një përafrim i mëtutjeshëm. Kosova nuk është anëtare e Konventës së Përbashkët të Tranzitit. Ajo gjithashtu nuk ka ratifikuar Konventën Rajonale për Rregullat Pan-Euro-Mesdhetare (PEM) Preferenciale të Origjinës, por zbaton dispozitat e saj. Dogana e Kosovës merr pjesë në Sistemin për Këmbimin e të Dhënave të Akcizës, që mundëson këmbimin sistematik elektronik të të dhënave mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. Legjislacioni për prekursorë të drogave, për masat doganore që rregullojnë të drejtat e pronës intelektuale, si dhe për kontrollin e eksportit për mallra kulturorë, ende nuk është në përputhje të plotë me *acquis* të BE-së. Nevojitet harmonizimi i mëtutjeshëm tek aspektet e sigurisë doganore. Për më tepër, në janar të vitit 2018, u vendosën lirime doganore për importimin e lëndëve të para dhe produkteve gjysmë të gatshme që përdoren në prodhim, linjat e makinerisë së prodhimit si dhe pajisjet e teknologjisë informative, të cilat nuk parashihen për lirim nga detyrimet në kodin doganor të Bashkimit Evropian. Terminalet doganore tokësore janë të vendosura në stabilimente në pronësi private, si dhe kërkojnë pagesë për secilin kamion që hyn në terminal për zhdoganim. Tarifat e tilla nuk janë në përputhje me *acquis*.

Administrata doganore ka vazhduar të ketë **kapacitet të arsyeshëm administrativ dhe operativ**; të ardhurat doganore janë rritur me 6,6% më 2017. Megjithatë, duhet të ketë më shumë koordinim me institucionet tjera përkatëse dhe organet ligjzbatuese për luftimin e ekonomisë joformale. Bashkimi i planifikuar i administratës tatimore dhe doganave është kufizuar në disa shërbime menaxhmenti dhe administrative, si dhe nuk do të ndikojnë në veprimtarinë themelore të administratave. “Koncepti pa letër” dhe e-pagesat e zbatuara nga Dogana e Kosovës kanë ndihmuar në eliminimin e procedurave dhe barrierave burokratike administrative, duke shpjerë drejt përsheptimit të procedurave të zhdoganimit.

Performanca doganore në luftimin e veprimtarive të paligjshme ndërkufitare, duke përfshirë kontrabandimin e mallrave, si narkotikët dhe materialet e rrezikshme, vazhdon të shfaqë përparim. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të adresuar më mirë korrupsionin, duke përfshirë edhe ndërmarrjen e më shumë hetimeve dhe përforsimin e kontrolleve të deklarimeve të pasurive të dorëzuara nga oficerët doganorë. Kapaciteti i departamentit doganor që merret me të drejtat e pronës intelektuale është i pamjaftueshëm. Numri në rritje i ankesave të prapambetura kundrejt administratës doganore në divizionin fiskal të Gjykatës Themelore të Prishtinës duhet të adresohet. Në janar të vitit 2017, aplikimi i Kosovës u pranua nga procesmbajtësi në Organizatën Doganore Botërore (WCO), gjë që nxiti diskutime dhe dallime në qëndrime në Këshillin e ODB-së.

## 6.6. Tatimimi

Kosova është në **fazë të hershme** në fushën e tatimeve. Ka pasur **pak progres** në vjeljen e të hyrave tatimore, tkurrjen e ekonomisë së hirtë, përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit sekondar tatimor, si dhe lidhjen e marrëveshjeve plotësuese të tatimit të dyfishtë me vendet tjera.

Rekomandimet e vitit të kaluar janë implementuar vetëm pjesërisht, pra në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të përshkallëzojë inspektimet e terrnit për të luftuar më tutje ekonominë joformale, të pëvetësojë detyrimet e papaguara tatimore, si dhe të zbulojë tatimpaguesit e paregjistruar, si dhe të sigurojë që rastet e evazionit fiskal dhe mashtrimit të hetohen e gjykohen siç duhet;

→ të sigurojë emërimet në bazë meritore në administratën tatimore, pa ndikim të pahijshëm politik, si dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës;

→ të zvogëlojë ngarkesën e ankesave të prapambetura kundrejt administratës doganore në divizionin fiskal të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Tek **tatimimi indirekt**, tatimi në vlerë të shtuar (TVSH) është përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Kosova aplikon normë standardet prej 18%, si dhe normë të ulur prej 8%, në përputhje me rregullat për normat, të përcaktuara me Direktivën e BE-së për Sistemin e Përbashkët të TVSH-së; edhe pse është norma e ulur, më shumë se ajo standarde, që aplikohet për furnizimet dhe importet e pajisjeve të TI-s. Rimbursimi i TVSH-së për mallrat që gjenden në bagazhin personal të udhëtarëve që jetojnë jashtë Kosovës nuk është e përafruar me Direktivat e BE-së. Tek **tatimimi direkt**, çmimet e transfertave ndërmjet ndërmarrjeve në pronësi apo kontroll të përbashkët adresohen me Ligjin për tatimin në të hyra të korporatave, në përputhje me udhëzimet e OECD-së për marrëveshjet për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Deri tash janë lidhur dymbëdhjetë marrëveshje të tilla, shtatë prej të cilave me Shtete Anëtare të BE-së. Ndërmjetësit financiarë nevojiten vetëm për të informuar autoritetin tatimor për pranuesit e të ardhurave nga kursimet, në bazë të kërkesës.

Kosova duhet që më tutje të përforcojë **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën juridike të ndërsjellë** në çështje tatimore, duke përfshirë ato që rregullohen me Konventën e OECD-së/Këshillit të Evropës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështje Tatimore.

Tek **kapaciteti operativ dhe kompjuterizimi**, bashkimi i planifikuar i administratës tatimore dhe doganës është kufizuar në disa shërbime menaxhuese dhe administrative, si dhe nuk pritet të ndikojë në veprimtaritë e të dy agjencive. Procesi i modernizimit të platformës së brendshme të TI-së tek autoritetet tatimore ka filluar, si dhe duhet të vazhdojë. Shërbimet elektronike, duke përfshirë pasqyrat tatimore në internet, sistemi i verifikimit dhe pagesës, si dhe qendrat e regjistrimit të biznesit (one-stop-shop) të lansuara më 2016 janë tashmë funksionale. Vjelja e përgjithshme e të hyrave tatimore më 2017 është rritur me 7%, krahasuar me vitin 2016. Sidoqoftë, evazoni fiskal dhe informaliteti vazhdojnë të dëmtojnë ekonominë.

Ka pasur pak progres në zvogëlimin e ekonomisë së hirtë joformale, por kjo vazhdon të jetë shumë e madhe, si dhe duhen bërë përpjekje të mëtutjeshme për ta luftuar. Në këtë drejtim, administrata

tatimore duhet të avancojë inspektimet në terren, të zbulojë detyrimet e papaguara tatimore, si dhe tatimpaguesit e paregjistruar. Administrata tatimore ka rekrutuar staf shtesë, por duhet të përforcojë kapacitetin e saj administrativ dhe profesional, duke siguruar emërimet në bazë meritash, si dhe duke zbatuar plotësisht vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Pohimet për mashtrime të rënda tatimore duhen hetuar në mënyrë të mirëfilltë. Numri në rritje i ankesave të prapambetura kundrejt administratës doganore në divizionin fiskal të Gjykatës Themelore të Prishtinës vazhdon të rritet dhe duhet të adresohet.

## 6.7. Konkurrenca

Kosova është në **fazë të hershme** në fushën e konkurrencës. **Pak progres** është bërë me miratimin e Ligjit për Ndihmën nga Shteti, si dhe me miratimin e akteve nënligjore të ligjit për konkurrencën. Megjithatë, pasi që shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë adresuar, ato mbeten të vlefshme. Agjencitë përgjegjëse për konkurrencë dhe ndihmë nga shteti përballen me sfida substanciale ndaj kapaciteteve të tyre hetuese dhe vendim-marrëse. Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit.

Në vitin vijues, Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme:

- përforcimit të zbatimit të ligjit për konkurrencën dhe ligjit për ndihmën nga shteti;
- përfundimit të përafrimit të akteve nënligjore për konkurrencën dhe ndihmën nga shteti;
- të siguruarit të kapacitetit funksional dhe pavarësisë operative të institucioneve të konkurrencës dhe ndihmës nga shteti që janë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin në të gjitha nivelet.

### Anti-trusti dhe përbashkimet

**Korniza legjislative** është përgjithësisht e përafruar me nenin 101 (marrëveshjet kufizuese) si dhe nenin 102 (abuzimi me pozitën dominuese) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU). Korniza ligjore për Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës për të kontrolluar përbashkimet është e vendosur. Pak progres është bërë në miratimin e legjislacionit përkatës sekondar. Sipas Agjendës së Reformave Evropiane, Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar aktet nënligjore që janë në masë të madhe në përputhje me *acquis*.

Tek **korniza institucionale**, Autoriteti i Konkurrencës është përgjegjës zbatimin e ligjit të konkurrencës. Autoriteti qeveriset nga Komisioni i Kosovës për Konkurrencë, organ kolektiv vendim-marrës emëruar nga Kuvendi. Formalisht, Autoriteti ka pavarësi operacionale, me kompetenca për iniciimin e hetimeve, kryerjen e inspektimeve në terren, vendosjen e gjobave dhe masave sanuese, si dhe për ndalimin e përbashkimeve anti-konkurrencë.

Sa i përket **kapacitetit për zbatim të legjislacionit**, Autoriteti ka 13 zyrtarë, por me ekspertizë të kufizuar. Ekipit i mungon trajnimi i përshtatshëm për konkurrencën dhe përbashkimet. Buxheti i tij operativ ka qëndruar stabil, por i pamjaftueshëm. Autoritetit ende i mungojnë procedurat e brendshme dhe kapaciteti për të kryer hetime. Për më tepër, gjyqtarët dhe stafi gjyqësor që merret me rastet e konkurrencës dhe kontrollimit të përbashkimeve ende nuk kanë ekspertizën adekuate në këtë fushë.

Pas emërimit të Komisionit të Kosovës për Konkurrencë, pak progres është bërë në zbatim, sidomos të vendimeve për marrëveshjet anti-konkurrencë, abuzimin me pozitën dominuese, si dhe përbashkimet. Sidoqoftë, aktivitetet vetëdijesuese duhet të rriten në masë të konsiderueshme.

### Ndihma nga shteti

**Korniza ligjore** është në masë të madhe në përputhje me *acquis* të BE-së. Pak progres është bërë me miratimin e Ligjit të ri për ndihmën shtetërore në dhjetor të vitit 2016, që gjerësisht pasqyron nenet 107 dhe 108 të TFEU-së. Megjithatë, ende nuk janë përafruar aktet nënligjore me ligjet e reja.



Sa i përket **kornizës institucionale**, Komisioni për Ndhimën Shtetërore me pesë anëtarë është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore, por ai ende nuk është emëruar. Në pajtim me ligjin e ri, stafii, asetet dhe buxheti janë transferuar nga Autoriteti i Konkurrencës tek Ministria e Financave, ku është krijuar Departamenti i ri për Ndhimën Shtetërore. Formalisht, ai ka mandatin për të verifikuar masat e njoftuara të ndihmës, të ndalojë atë ndihmë, të kryejë auditime të ndihmës *ex post* dhe të rikthejë ndihmën që është e papajtueshme. Sidoqoftë, me një zyrtar dhe një drejtor, kapaciteti i Departamentit për Ndhimë Shtetërore për të zbatuar ligjin mbetet tejet i kufizuar. Si pasojë, **implementimi** efektiv i Ligjit për Ndhimë Shtetërore ende nuk është demonstruar. Deri tash, aktivitetet e tij kanë mbetur tek shpërndarja e formularëve njoftues tek ofruesit e mundshëm të ndihmës shtetërore. Departamenti për Ndhimë Shtetërore nuk ka kapacitet të kontrollojë skemat e ndihmës ekzistuese, siç edhe kërkohet me MSA. Një numër masash të ndihmës, të ofruar në nivel qendror apo lokal, sidomos për kompanitë e mëdha në sektorë të ndryshëm, si telekomunikacioni, nuk njoftohen apo nuk hetohen siç duhet. Vetëdija për rregullat e ndihmës shtetërore tek ofruesit e ndihmës së tillë është tejet e pakët, si dhe duhet rritur në masë të konsiderueshme. Nuk është nxjerrë asnjë vendim për ndihmën shtetërore për 4 vitet e fundit.

### Liberalizimi

Ligji për Konkurrencën dhe Ligji për Ndhimën Shtetërore zbatohen edhe për sipërmarrjet publike në Kosovë. Rregullat për shërbimet financuese të interesit të përgjithshëm ekonomik janë pjesërisht në përputhje me *acquis*.

Nuk ka monopole të natyrës komerciale në kuptimin e nenit 37 të TFEU-së.

### **6.8. Prokurimi publik**

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** për prokurimin publik. **Pak progres** është arritur me miratimin e strategjisë së prokurimit publik, si dhe me krijimin e platformës elektronike të prokurimit. Megjithatë, duhet të bëhet më shumë për të parandaluar parregullsitë dhe korrupsionin në ciklin e prokurimit. Kosova duhet të adresojë kapacitetin e dobët të institucioneve të prokurimit publik për administrimin e prokurimit publik, monitorimin dhe ekzekutimin e pamjaftueshëm të kontratave, si dhe sistemet e dobëta të mjeteve juridike, ku të gjitha janë të cenueshme ndaj korrupsionit në rastin e prokurimit publik.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të përafrojë më tutje legjislacionin e saj me *acquis* evropiane, si dhe të sigurojë zbatim të mirëfilltë të Ligjit për Prokurimin Publik;

→ Të rrisë kapacitetin e të gjitha institucioneve të prokurimit publik për administrimin e prokurimit publik, si dhe të përforcojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e ciklit të plotë të tenderimit;

### Struktura institucionale dhe harmonizimi ligjor

**Korniza ligjore** për prokurimin publik është në masë të madhe në përputhje me *acquis* të BE-së. Ligji për Prokurimin Publik siguron mundësinë e përdorimit të procedurës konkurruese me negociim. Megjithatë, raporti më i mirë çmim-cilësi dhe kostot e ciklit të jetëgjatësisë së produkteve të parapara me direktivat e BE-së për prokurimin publik më 2014 nuk janë marrë parasysh. Gjithashtu, rregullat për listën e ngushtë të kandidatëve në procedurën e kufizuar dhe bazat për përjashtim nuk janë në përputhje me *acquis*. Direktiva e BE-së për Prokurimin në Mbrojtje nuk është harmonizuar.

**Strategjia** (2017-2021) dhe plani i veprimit (2017-2019) për përmirësim të sistemit të prokurimit publik janë miratuar më 2017, me qëllim të koordinimit më të mirë dhe aktiviteve më konsistente nga institucionet qendrore të prokurimit publik,.

**Institucionet e prokurimit publik** përbëhen nga tre trupa kryesorë. Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik është përgjegjës për bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik dhe trajnimet. Agjencia Qendrore e Prokurimit është përgjegjëse për prokurimet qendrore dhe të koordinuara. Organi Shqyrtues i Prokurimit shqyrton të gjitha pohimet për shkelje të ligjit të prokurimit publik. Megjithatë, këto institucione ende përballen me sfida të mëdha në ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të tyre në mënyrë efektive e efikase.

#### Implementimi dhe kapaciteti zbatues

Më 2017, pjesa e prokurimit publik në BPV arriti në 7.35 %, me vlerë prej 459.7 milionë eurosh. Prej këtyre, 87% janë kontraktuar përmes procedurës së hapur. Sidoqoftë, 98% e kontratave publike janë dhënë sipas kriterit të çmimit më të ulët më 2017, e jo sipas raportit më të mirë çmimcilësi. Janë shënuar dallime të mëdha në çmime për të njëjtit artikuj mes autoriteteve të ndryshme kontraktuese.

Që prej janarit 2017, përdorimi i e-prokurimit është bërë obligativ për të gjitha autoritetet kontraktuese, derisa ende lejohet edhe sistemi paralel në letër. Megjithatë, aktualisht vetëm 3 nga 12 modulet e sistemit të e-prokurimit janë në funksion. Për të pasur zbatim të plotë të e-prokurimit, duhen ndërmarrë hapa për të zhvilluar kapacitetet e përdorimit të tij tek ofertuesit (sidomos të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) si dhe të blerësve. Çështjet tjera të konsiderueshme, si mbikëqyrja e kontratave dhe monitorimi i menaxhimit të kontratave, ende nuk janë të zbatuara në masë të mjaftueshme.

**Prokurimi i centralizuar** është i detyrueshëm për të gjitha lëndët që janë shënuar në listën e Ministrisë së Financave, si dhe vlen për agjencitë që i raportojnë Kuvendit e që kanë më pak se 50 të punësuar. Megjithatë, zgjerimi i këtij viti në këtë listë të mallrave të blera të përbashkëta duhet të pasohet edhe me një rritje të konsiderueshme të stafit dhe resurseve të tjera në agjencinë qendrore të prokurimit. Monitorimi i aktiviteteve qendrore të prokurimit është me rëndësi të posaçme për shkak të vlerës së lartë dhe kompleksitetit. Ka vonesa të konsiderueshme në prokurimet që kryhen nga agjencia, pasi që vetëm njëri është kryer këtë vit, derisa i dyti, i gatshëm të kontraktohet, është ende në fazën e apelimit. Kjo gjendje pengon në masë të konsiderueshme zbatimin e prokurimeve të centralizuara.

#### Sistemi efikas i mjeteve juridike

Korniza rregullative dhe struktura institucionale për shqyrtimin e prokurimit publik, përfshirë këtu partneritetet publiko-private, janë të krijuara. Dispozitat e ligjit për prokurimin publik mbi fushëveprimin e shqyrtimit dhe sistemit të mjeteve juridike, afatet për kundërshtimin e vendimeve, efektet e parashtrimit të ankesës dhe mekanizmin për sigurimin e efektshmërisë së kontratave, në masë të madhe janë në përputhje me *acquis*.

Më 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar dhe ka shqyrtuar 541 ankesa dhe ka shqyrtuar 459 apele. Nga këto vendime, 159 janë dërguar për rivlerësim, si dhe në 91 raste, vendimi i autoritetit kontraktues është konfirmuar. Të gjitha vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit publikohen në faqen e tij të internetit, por databaza duhet të jetë më miqësore për përdoruesit, me funksione më të mira të kërkimit.

Operatorët ekonomikë kanë të drejtë të parashtrorjnë kërkesë tek Organi Shqyrtues i Prokurimit për shqyrtim të ankesave të tyre. Në rast të moszbatimit të vendimeve të tij, Organi ka kompetencë të gjolisë autoritetet kontraktuese. 4 ndëshkime të tilla janë dhënë më 2017.

Klauzola e pezullimit automatik, e vendosur me Ligjin e ri të Prokurimit Publik, u përdor në qershor të vitit 2017, kur dy anëtarë të bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit u pezulluan për shkak të aktakuzës së tyre në një rast korrupsioni.

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit duhet të ofrojë arsyetime më të elaboruara, ndërsa ekzekutimi i vendimeve të tij duhet përmirësuar.

## 6.9. E drejta e subjekteve tregtare

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e të drejtës së subjekteve tregtare. **Pak progres** është bërë tek regjistrimi i bizneseve në internet dhe zbulimi i informatave të kompanive.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të miratojë Projektligjin për Shoqëritë Tregtare;

→ të sigurojë zbatimin e mirëfilltë të Ligjit të miratuar së voni për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Tek e **drejta e kompanive**, projektligji për shoqëritë tregtare, me synimin e përafrimit me *acquis* në një numër çështjesh, duke përfshirë përbashkimet dhe ndarjet vendore, por edhe për përbashkimet ndërkufitare, ende nuk është miratuar. Kodi i qeverisjes korporative duhet të hartohet pas miratimit të këtij ligji. Përvetësimet e kompanive nuk janë të rregulluara. Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Kosovës është përgjegjëse për regjistrimin dhe publikimet e bizneseve në internet, duke përfshirë pasqyrat financiare të kompanive. Regjistrimi i biznesit mund të dorëzohet në mënyrë elektronike.

Tek **kontabiliteti dhe auditimi korporativ**, është miratuar ligji i ri për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim. Subjektet e mëdha duhet të aplikojnë Standardet Ndërkombëtare për Raportimin Financiar (IFRS/IAS) që janë plotësisht dhe drejtpërdrejt të transpozuar në standarde vendore. Subjektet e vogla dhe të mesme duhet të aplikojnë IFRS-në për standardet e NVM-ve; Kosova duhet të marrë parasysh një regjim më të thjeshtë që vlen për kompanitë e vogla sipas Direktivës së BE-së për Kontabilitet. Financimi dhe resurset e pamjaftueshme të strukturave institucionale të mbikëqyrjes së auditimit.

## 6.10. E drejta e pronës intelektuale

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** për këtë fushë. **Pak progres** është bërë në harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së. Sidoqoftë, Agjencia Shtetërore e Pronës Intelektuale dhe Agjencia e Pronës Industriale kanë ende nevojë për më shumë fonde, staf e trajnim. Ende nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të siguruar implementimin, duke përfshirë mjetet efektive për ushtrimin e të drejtave pronësore intelektuale, në pajtim me obligimet e MSA-së.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të përforcojë më tutje kapacitetin dhe bashkërendimin e agjencive ligjzbatuese për të zbatuar të drejtat e pronës intelektuale, industriale dhe komerciale;

→ të adresojë mungesën e resurseve të Agjencisë së Pronës Industriale dhe të përballet me aplikimet e prapambetura për të drejtat e pronës intelektuale.

Tek **të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta**, nuk është bërë ndonjë progres në implementim të legjislacionit përkatës mbi skemat e kopjimit privat dhe piraterisë digjitale. Ende nevojiten mekanizma për të përcaktuar tarifën për përdorimin e materialeve me të drejtë autori ndërmjet organizatave të menaxhimit kolektiv dhe transmetuesve.

Tek **të drejtat e pronës industriale**, korniza legjislative ende ka nevojë të përafrohet më tutje me *acquis* të BE-së, duke përfshirë edhe sekretet tregtare. Përkundër progresit të bërë në trajtimin e disa aplikimeve të pashtjelluara për të drejta të pronës intelektuale, Agjencia e Pronës Industriale vazhdon të jetë e penguar nga mungesa e stafit dhe financimit të pamjaftueshëm. Bashkëpunimi mes institucioneve politike-bërëse dhe agjencive ligjzbatuese mbetet i dobët. Ekziston nevoja për një strategji qeveritare për të drejtat e pronës intelektuale, si dhe për më shumë vetëdijësim tek bartësit dhe shfrytëzuesit e këtyre të drejtave.

Tek **ekzekutimi**, Dogana e Kosovës ka ndërmarrë 272 operacione të lidhura me mallrat që shkelin të drejtat e pronës intelektuale më 2017, 222 prej të cilave u iniciuan pas kërkesës për veprim nga bartësit e të drejtës, derisa 50 rastet tjera të veprimit u ndërmorrën në mënyrë proaktive nga zyrtarët e Doganës. Vlera e mallrave të sekuestruara ishte 1.6 milionë euro. Sidoqoftë, departamenti i doganës që merret me të drejtat e pronës intelektuale duhet të përforcohet - vetëm dy zyrtarë të punësuar janë të pamjaftueshëm për të siguruar zbatimin. Kriteri administrativ për të marrë autorizimin policor për të kryer hetime të tregut dëmton efektshmërinë e inspektoratit të tregut. Për më tepër, korniza ligjore për masat doganore tek të drejtat e pronës intelektuale mbetet pa përafrim me *acquis* të BE-së.

## 6.11. Politika sociale dhe punësimi

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e politikave sociale dhe punësimit. Është arritur **pak progres** gjatë periudhës së raportimit. Agjencia e Punësimit është tashmë funksionale, shërbimet publike të punësimit janë përmirësuar, si dhe është arritur përafrimi i mëtutjeshëm tek shëndeti dhe siguria në punë. Njëkohësisht, incidentet fatale janë në rritje, ndërsa Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ende nuk po zbatohet.

Pasi që asnjë prej rekomandimeve të vitit 2016 nuk janë implementuar, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të zbatojë planin e veprimit për trajtimin e papunësisë së rinisë, të zbatojë strategjinë e punësimit dhe mirëqenies sociale 2018-2022, si dhe të monitorojë rezultatet e tyre;

→ Të ndryshojë dhe të zbatojë Ligjin për punën si dhe legjislacionin për shëndet dhe siguri në punë, si dhe të miratojë e zbatojë legjislacionin për inspektime, për të ulur numrin e aksidenteve në punë;

→ Të ndryshojë dhe të miratojë Ligjin për Këshillin Ekonomik-Social.

Kosova ende mbetet të ndryshojë **Ligjin për Punën** si dhe të përmirësojë zbatimin e tij. Amandamentet duhet që *inter alia* të adresojnë më mirë trajtimin e barabartë e jo-diskriminues të grave. Zbatimi i ligjit pengohet nga numri i ulët i inspektorëve dhe procedurave të zgjatura gjyqësore. Implementimi është edhe më problematik në sektorin privat. Puna e fëmijëve mbetet brengë serioze, me rreth 11% të fëmijëve të angazhuar në punë, ku kjo përqindje është më e lartë tek komunitetet rom dhe ashkali, me rritje deri në 17%. Ky angazhim i fëmijëve shpesh shpie drejt ekspozimit të tyre ndaj formave të ndryshme të dhunës. Megjithatë, të dhënat cilësore mungojnë. Gjatë periudhës së raportimit, Inspektorati i Punës ka identifikuar dhe është marrë vetëm me një rast të një të mituri të angazhuar në punë.

Tek **shëndeti dhe siguria në punë** ka pasur disa rregullore të reja të hartuara, por zbatimi mbetet joefektiv. Më 2017, ka pasur rritje të aksidenteve në vend të punës, prej të cilëve 14 nga 50 ishin fatale, kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe shërbimeve. Inspektorati i Punës duhet të shënjestrojë pjesën joformale të sektorit të ndërtimit në mënyrë më efektive, si dhe t'i sigurohen resurset adekuate për të përmbushur mandatin e tij pa vonesa të mëtutjeshme. Kjo duhet të bëhet mbi të gjitha me rritjen e numrit të inspektorëve, së paku nga 49 që janë aktualisht në 65 që planifikohen.

Tek **dialogu social**, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e vitit 2014, që është themelore në kuptimin e parashikimit të të drejtave dhe detyrimeve për punëdhënës dhe punëtorë, nuk është duke u zbatuar. Negocimi kolektiv bëhet kryesisht në nivel qendror, përmes Këshillit Ekonomik dhe Social, si dhe në nivel sektorial, por kryesisht mbulon sektorin publik. Ndryshimet në Ligjin për Këshillin Ekonomik e Social ende nuk janë aprovuar. Anëtarësimi në sindikata të punëtorëve në sektorin privat është tejet i ulët.

Tek **politikat e punësimit**, qeveria ka miratuar strategjinë sektoriale 2018-2022. Gjithashtu, në përputhje me zotimet e Agjendës së Reformave Evropiane, qeveria ka hartuar një plan veprimi për të trajtuar papunësinë rinore. Buxheti i ndarë për masat aktive të tregut të punës mbetet i pamjaftueshëm. Shërbimet publike të punësimit kanë rritur performancën e tyre në përputhje të punëdhënësve me punëtorë. Agjencia e Punësimit është tashmë funksionale.

Pasiviteti i lartë dhe punësimi i ulët mbeten sfida kyçe. Shkalla e përgjithshme e aktivitetit qëndroi tej 37,6 % më 2015, ndërsa shkalla e punësimit ishte skajshmërisht e ulët me 25%. Përveç këtyre, shkalla e papunësisë është ende tejet e lartë me 31% më 2017. Ajo vazhdon të jetë më e lartë për gratë (37%) sesa për burrat (29%). Shkalla e përgjithshme e punësimit është 30%, por vetëm 13% e grave kanë punësim formal, krahasuar me 47% të burrave. Vetëm 29% të të punësuarve kanë kontrata të përhershme pune, derisa 71% punojnë me kontrata afatshkurtra. Papunësia është më e pranishme tek të rinjtë (15-24 vjeç), me 51% të papunë. Shkalla e papunësisë është edhe më e lartë tek komunitetet rom dhe ashkali. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve zakonisht punojnë në sektorin joformal, duke mbajtur vende pune të pasigurta, pa kualifikime dhe status të ulët. Një numër tejet i ulët janë të regjistruar si të papunë.

Sa i përket përgatitjeve për shfrytëzimin e **Fondit Social Evropian (ESF)**, nuk ka pasur zhvillime të reja.

Tek **përfshirja dhe mbrojtja sociale**, Kosova duhet të sigurojë që komunat të kenë resurse të mjaftueshme për të ofruar shërbimet sociale që janë përgjegjësi e tyre. Ka pak progres në përfshirjen sociale të fëmijëve dhe familjeve rom dhe ashklike. Kosova duhet të sigurojë që fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të ndjekin shkolla publike bashkë me moshatarët e tyre. Tek **mbrojtja sociale**, që prej vitit 2009, fondet e mirëqenies sociale janë ndarë përmes grantit të përgjithshëm, pa ndonjë alokim në lidhje me buxhetin lokal të disponueshëm për shërbime sociale. Kjo mungesë e qartësisë ka rezultuar me dallime të konsiderueshme në nivele të përkrahjes nga komunat për ofrimin e shërbimeve sociale. Dispozitat për alokimin e fondeve specifike nga granti i përgjithshëm për shërbime sociale duhet të parashihen në projektligjin e ardhshëm për Financa Lokale. Pjesa e popullatës së Kosovës që jeton nën vijën e varfërisë ka qenë në rënie, por ende mbetet e lartë tek 17.6 %. Këshilli i Përgjithshëm për Politika Sociale dhe Familjare, përgjegjës për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale, duke përfshirë përkujdesin familjar, nuk ka qenë funksional. Nuk ka pasur përparim në licencimin e ofruesve të rinj të kujdesit familjar për fëmijë në nevojë.

Tek **mosdiskriminimi në punësim dhe politika sociale**, aktet nënligjore për implementimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk janë miratuar. Autoritetet duhet të adresojnë diskriminimin ndaj grave, sidomos në lidhje me procedurat e rekrutimit në sektorin privat. Gjatë periudhës së raportimit, Avokati i Popullit ka pranuar një numër të ngjashëm të rasteve si në vitet e kaluara, por numri i hetimeve *ex officio* në baza diskriminimi është dyfishuar. Institucionet vazhdojnë të jenë dobët në procedimin dhe hetimin e rasteve të diskriminimit.

Tek **barazia mes grave dhe burrave**, gratë vazhdojnë të jenë të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të diskriminimit gjinor. Kosova duhet të reformojë sistemin e pushimit të lindjes dhe atij prindor, që paraqet pengesë për rekrutimin e grave, sidomos në sektorin privat. Qasja e kufizuar në kujdes për fëmijë dhe në rregullime fleksibile të punës janë gjetur të jenë gjithashtu barriera ndaj punësimit të grave, pasi që opsionet formale të kujdesit përtej pushimit të lindjes janë të kufizuara, ndërsa oraret miqësore për familje shpesh nuk janë të disponueshme.

## 6.12. Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në këtë fushë. Nuk ka pasur progres në mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit.

Kosova duhet që posaçërisht:

- Të rrisë angazhimin e shoqërisë civile në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtave të konsumatorit, si dhe të sigurojë numër adekuat të inspektorëve dhe mbikëqyrjen e tregut;
- Të rrisë resurset financiar për të mundësuar jetësimin e reformave të sektorit shëndetësor, duke përfshirë edhe përhapjen e mëtutjeshme të Sistemit Informativ elektronik Shëndetësor.

Tek **mbrojtja e konsumatorit**, Ligji i ri për Mbrojtjen e Konsumatorit duhet të miratohet. Kapacitetet institucionale dhe administrative, por edhe bashkërendimi i të gjithë rregullatorëve në fushën e mbrojtjes së konsumatorit duhen përforcuar. jetësimi i mbrojtjes së konsumatorëve është tejet i kufizuar, ndërsa organizatat e konsumatorëve janë tejet të dobëta. Ligji i ri nuk parasheh kompetenca të shprehura ligjore për organizatat e shoqërisë civile në ofrim të këshillave për mbrojtjen e konsumatorit, informimin dhe edukimin e konsumatorëve. programi i mbrojtjes së konsumatorëve për periudhën 2016-2020 është miratuar, por mungesa e resurseve njerëzore dhe financiare në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë vazhdon të pengojë implementimin efektiv të politikave dhe koordinimin e programit.

Sa i përket **çështjeve të ndërlidhura me sigurinë e produkteve**, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka miratuar rregulloren për sistemin e këmbimit të shpejtë të informatave të produkteve që përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Databaza e produkteve të rrezikshme ka qenë funksionale që prej dhjetorit të vitit 2016. Tek **çështjet jashtë sigurisë**, Ligji për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregjeve është pjesërisht i përafëruar me *acquis*, megjithatë, numri i pamjaftueshëm i inspektorëve dobëson kapacitetin e mbrojtjes së interesave ekonomikë të konsumatorëve.

Tek **politika e shëndetit publik**, Kosova ka miratuar disa udhëzime administrative dhe një strategji komunikimi në mbështetje të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, por zbatimi i tyre mbetet i ngadalshëm si dhe është vonuar edhe më shumë pasi që fillimi i mbledhjes së premieeve është shtyrë deri në fund të vitit 2018.

**Strategjia e re e sektorit të shëndetësisë 2017-2021** si dhe planit të veprimit ka filluar në shkurt të vitit 2017. Strategjia qartë paraqet disa mangësi në sektorin shëndetësor, duke përfshirë nivelet e ulëta të produktivitetit të institucioneve shëndetësore, si dhe mungesën e të dhënave të besueshme, por për shkak të mekanizmave institucionale dhe monitorues, strategjia nuk është duke u zbatuar. Rreth 30% të popullatës së Kosovës nuk arrin të marrë shërbime shëndetësore për shkak të varfërisë së skajshme.

Shpenzimet e ulëta publike në shëndetësi mbesin brengosëse. Më 2016, u vlerësua që vetëm 40% të nevojave të përgjithshme vjetore për shëndetësi publike mbulohen. Fondet e alokuara kryesisht shpenzohen për të mbuluar kosto fikse (rreth 68%), duke lënë vetëm rreth 32% për kosto direkte të pacientëve, lidhur me diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin. Financimi i shëndetësisë kryesisht bazohet në shpenzimet historike. Llogaridhënia institucionale është e dobët, si dhe nuk ka stimuj të qartë për të rritur produktivitetin, efikasitetin dhe cilësinë në sektorin shëndetësor. Shpenzimet private (nga xhepi) mbeten të larta, si dhe vlerësohen të jenë 40% të shpenzimeve totale mjekësore.

Kosova ka një Ligj gjithëpërfshirës të Kontrollimit të Duhanit, por niveli i zbatimit të tij ka vazhduar të bjerë, për shkak të mungesës së vullnetit politik dhe performancës së dobët të autoriteteve zbatuese.

Tek **gjaku, indet, qelizat dhe organet**, Ligji i vitit 2014 për transplantimin e indeve dhe qelizave, që është pjesërisht i përafuar me *acquis*, nuk po zbatohet plotësisht. Ende nuk është miratuar Ligji për transfuzionin e gjakut. Përafrimi i plotë i të dy ligjeve me *acquis* kërkon resurset e domosdoshme, kapacitetet administrative dhe monitoruese.

Në fushën e **kërcënimeve serioze shëndetësore ndërkufitare, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse**, legjislacioni nuk është i përafuar me *acquis*. Mbulimi me imunizim në vitin 2017 ishte më i ulët sesa më 2016. Ka gjithashtu rënie edhe në vaksinimin e fëmijëve në mosha shkollore. Kosova ende nuk ka plan veprimi të përditësuar të rezistencës antimikrobike (AMR). Përshkrimi i antibiotikëve duhet të kontrollohet më afërsisht për të parandaluar rezistencën anti-mikrobike.

Sa i përket **të drejtave të pacientëve në shëndetësi ndërkufitare**, legjislacioni i Kosovës nuk është i përafuar me *acquis*. Kosova është duke zhvilluar një Sistem Informativ elektronik të Shëndetit (eSISH), në bazë të Treguesve themelorë Evropianë të Shëndetit, i cili përfshin të dhënat për pranimin, lirimet dhe transferimet e pacientëve, edhe pse aktualisht mbulon vetëm rreth 30% të institucioneve publike shëndetësore. Nevojitet përkushtim i fuqishëm për të siguruar përhapjen e plotë të SISH-it në të gjitha institucionet shëndetësore. Funkcionet tjera (barnatoret, patologjia, radiologjia, transfuzioni i gjakut, vaksinimi dhe intervenimet tjera, etj.) duhen shtuar, ndërsa mbulimi të zgjerohet për të mbështetur politikën shëndetësore të bazuar në evidenca.

Legjislacioni i Kosovës në lidhje me **barnat për njerëz dhe veterinari** nuk është i përafuar me *acquis*.

**Promovimi shëndetësor** në lidhje me **sëmundjet jo-ngjitëse** mbetet i dobët. Kosova nuk ka ndonjë strategji e as plan veprimi në këtë fushë. Aktualisht, Kosova po planifikon të ndërmarrë një Hulumtim Gjithëpërfshirës mbi Faktorët e Rrezikshmërisë për Sëmundjet Jo-ngjitëse, i cili do të mbështeste hartimin e një strategjie dhe plani të veprimit të bazuar në evidenca. Sa i përket **skringut për kancer**, nuk ka ndonjë strategji për kontrollim të kancerit në fuqi. Gjatë vitit 2017, u ndërмор një pilot-program kontrollimi për kancerin e mitrës në Prishtinë.

Legjislacioni për **shëndetin mendor** nuk është i përafuar me *acquis*.

Tek **ushqyeshmëria dhe aktiviteti fizik**, nuk ka legjislacion në zbatim.

Tek **pabarazitë shëndetësore**, Kosova aktualisht nuk ofron sigurim universal shëndetësor, si dhe kështu shpenzimet nga xhepi për shërbime shëndetësore mbeten të larta. Vlerësohet që rreth një e treta e popullsisë nuk ka qasje të lehtë në shërbime shëndetësore, ose kanë qasje të kufizuara për shkak të mungesës së fondeve, si dhe që 18% të popullsisë, për shkak të arsyeve ekonomike, nuk kërkon shërbime mjekësore në rast të sëmundjes. Mbulimi i komuniteteve rom dhe ashkali mbetet brengosës në kuptimin e imunizimit, ku vetëm tre në dhjetë fëmijë janë plotësisht të imunizuar. Mungesa e informatave mbi shërbimet e ofruara nga institucionet publike dhe rastet e diskriminimit, kanë gjithashtu efekt negativ në qasjen në shërbime shëndetësore.

### 6.13. Arsimi dhe kultura

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** për arsimin dhe kulturën. Nuk ka pasur progres vitin e kaluar dhe cilësia e arsimit ende mbetet të përmirësohet në masë të konsiderueshme.

Pasi që rekomandimet e raportit paraprak nuk janë adresuar, vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të miratojë ligj të ri të arsimit të lartë, me qëllim të zbatimit të një reforme të bazuar në standardet më të mira, duke përfshirë sigurimin e autonomisë dhe operimit të pavarur të institucioneve të arsimit të lartë dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë;

→ të përshkallëzojë përpjekjet për reformë në arsimin para-universitar (duke përfshirë programet e arsimit dhe aftësimin profesional), me fokus në mësimin e bazuar në kompetenca;

→ të përmirësojë qasjen në arsim cilësor për regjistrimin në parashkollor dhe grupet e marginalizuara.

Tek **arsimi dhe aftësimi**, niveli i shpenzimeve publike në arsim, me 4.7% të BPV-së, nuk menaxhohet në mënyrë aq efikase për të ofruar arsim cilësor për numrin krahasimisht të madh të rinjve.

Normat e regjistrimit në arsimin **fillor dhe të mesëm të ulët** janë gati universale, derisa regjistrimet bruto në arsim të mesëm të lartë qendrojnë tek 85%. Sidoqoftë, vetëm 18% të fëmijëve në mosha 0-5 vjeç ndjekin institucione të licencuara parashkollore. regjistrimi i ulët i fëmijëve në nivelin **parashkollor** mbetet brengosës, pra Kosova duhet të rrisë ofrimin e institucioneve të kujdesit për fëmijë. Numri i studentëve në **arsimin e lartë** është gati dyfishi i mesatares së BE-së krahasuar me popullsinë. Megjithatë shkalla e përfundimit është e ulët, si dhe ka shkallë të lartë të papunësisë tek bartësit e diplomave universitare (25%), që pasqyron mospërputhjet mes programeve të arsimit të lartë dhe nevojave të tregut të punës. Kriteret e Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë (AKA) marrin parasysh standardet e BE-së. Sidoqoftë, vendimi i qeverisë më 2017 për të shkarkuar të gjithë bordin dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit të Agjencisë ka dëmtonuar autonominë e agjencisë, si dhe ka shpjerë drejt përjashtimit të saj nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR). Korniza e kualifikimeve të Kosovës i referohet Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Arsimi mbetet sektor me rrezikshmëri të lartë për korrupsion dhe ndikim politik, sidomos në arsimin e lartë. Qeveria gjithashtu ka vendosur të shkarkojë anëtarët e Bordit Udhëheqës të Universitetit të Prishtinës, gjë që e privon institucionin nga të pasurit të një menaxhmenti stabil, të aftë për të ushtruar detyrat dhe realizuar reformat.

Plani Strategjik për Arsimin në Kosovë dhe plani i veprimit 2017-2021 janë miratuar në korrik të vitit 2017. Strategjia përfshin pjesëmarrjen dhe përfshirjen, menaxhimin e sistemit arsimor, sigurimin e cilësisë, zhvillimin e mësimdhënësve, arsimin e hershëm dhe parashkollor, arsimin dhe aftësimin profesional, arsimin e të rriturve, si dhe arsimin e lartë. Strategjia dhe plani i veprimit tani mbeten të zbatohen, si dhe të ndahen resurset e nevojshme. Ligji për standardet profesionale u miratua në nëntor të vitit 2016. Qeveria duhet të sigurojë implementimin e strategjisë për sigurimin e cilësisë si dhe të krijojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë në nivel komunal. Implementimi i reformës kurrikulare dëmtohet nga mungesa e stafit mësimdhënës të kualifikuar, materialeve dhe mjeteve mësimore, si dhe një sistemi të pazhvilluar të vlerësimit të nxënësve. Sistemi i trajnimit të mësimdhënësve për përmirësimin e arsimit para dhe gjatë shërbimit është vendosur, por mbetet të ofrojë rezultate. Në janar të vitit 2018, Ministria shpalli planet e saj për të vendosur profilizimin e mësimdhënësve për klasët 1-5, pa ndonjë vlerësim të mirëfilltë të gjendjes bazë. Kjo do ta komplikonte dhe do ta vononte më tutje zbatimin e reformave.

Cilësia e arsimit vazhdon të jetë sfidë në të gjitha nivelet. Sipas vlerësimit më 2015 nga Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) renditi Kosovën të tretën nga fundi në një listë me mbi 70 sisteme të testuara. Kosova është zotuar të marrë pjesë edhe në vlerësimin PISA për vitin 2018.

Rreth gjysma e të gjithë nxënësve në shkollimin e mesëm të lartë zgjedhin **arsimin profesional**. Programet e arsimit dhe aftësimin profesional (AAP) nuk kanë kurse praktike dhe aplikative, ku vetëm disa janë akredituar nga Autoriteti Shtetëror i Kualifikimeve. Përgjithësisht, lidhja me tregun e punës mbetet e dobët. Roli dhe ardhmëria e Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur mbeten të paqarta. Kosova duhet të rrisë cilësinë e programeve AAP bashkë me kualifikimet, për të inkurajuar punëdhënësit që të angazhojnë më shumë të diplomuar nga AAP-ja, duke përfunduar katalogun e kualifikimeve në sektorët e AAP-së.

Kërkohen më shumë përpjekje për të ofruar qasje në arsim cilësor për fëmijët me aftësi të kufizuara, si dhe duhen trajnuar më shumë mësimdhënës dhe asistentë. Duhet marrë masa për të adresuar shkallën e lartë të braktisjes së shkollave nga fëmijët romë dhe ashkalinj. Rritja e pjesëmarrjes së tyre në parashkollor, si dhe e grupeve të tjera të cenueshme, do të përmirësonte në masë të konsiderueshme pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme dhe suksesin në shkollim të mëtutjeshëm.



Që prej janarit 2018, Kosova mund të marrë pjesë në tërësinë e Erasmus +, si dhe mund të bashkohet në platforma e rrjete. Deri tash, më se 2000 studentë e staf mësimor janë angazhuar në fushën e Mobilitetit Ndërkombëtar të Kredive, nga të cilët dy të tretat janë nga Kosova, ndërsa një e treta kanë shkuar në Kosovë. Institucionet nga Kosova kanë marrë pjesë në 14 projekte të Zhvillimit të Kapaciteteve në Arsim të Lartë, tre prej tyre si partnerë koordinues.

Tek **rinia**, është inauguruar dega lokale e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit (RYCO). Më se 800 pjesëmarrës të rinj kanë përfituar nga njëri prej tre veprimeve të Lëvizshmërisë Rinore që prej vitit 2014 (mobiliteti i punëtorëve të rinj, këmbimet rinore dhe Shërbimi Vullnetar Evropian).

Tek **kultura**, Kosova duhet të vazhdojë punën në arritje të standardeve të parapara me Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore, si dhe të krijojë një vazhdimësi të praktikave të mira. Më 2018, Kosova do t'i bashkohet Evropës Kreative si partner në program (nën-programi i kulturës).

#### 6.14. Shkenca dhe hulumtimet

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** për shkencën dhe hulumtimet. **Nuk është bërë progres** në vitin e kaluar.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të rrisë shpenzimet qeveritare në hulumtime dhe të përpiqet të nxisë investimet nga sektori privat duke përgatitur dhe shfrytëzuar gjetjet e një strategjie të specializimit të mençur që duhet të hartohet shpejt;

→ të fokusojë përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes në Programin e BE-së Horizonti 2020, si dhe të sigurojë bashkërendim më të mirë të personave kontaktues për Horizontin 2020.

Kosova ka bërë pak për të zhvilluar **politikën e saj të hulumtimit dhe inovacionit**. Ligji për Veprimtaritë Hulumtuese Shkencore nuk është duke u zbatuar siç duhet, për shkak të mungesës së fondeve. Shpenzimet qeveritare në hulumtim janë ulur në 0.1% të BPV-së. Kosova ka histori të dobët në shfrytëzim edhe të atij buxheti, shpesh duke mos arritur të shpenzojnë as gjysmën e tij. Në arsimin e lartë, cilësia e programeve post-diplomike që përgatisin për karrierë hulumtimesh janë me cilësi të dobët, ku edhe institucionet private edhe ato publike të arsimit të lartë kanë kriterë tejet të pabarazueshme për ngritje në detyrë në bazë të hulumtimeve dhe botimeve shkencore. Hapja e Zyrës për Programe të Sponsorizuara dhe Hulumtime në Universitetin e Prishtinës është hap i vogël por pozitiv në drejtimin e duhur. Ministria e re për Inovacion e Ndërmarrësi duhet të zhvillojë kapacitetet e saj administrative dhe të miratojë një strategji inovacioni në bashkërendim të afërt me ministrinë tjera.

Nuk ka pasur progres në integrimin me **Zonën Evropiane të Hulumtimeve**.

Tek **programet kornizë**, Kosova merr pjesë në programin e hulumtimit dhe inovacionit të Horizontit 2020 të BE-së (H2020) si palë e tretë. Kosova ka marrë pjesë 10 herë në projektet H2020 (2 të reja më 2016 dhe 1 të ri më 2017). Ka një rritje të vogël krahasuar me vitet e kaluara, por ky nivel i pjesëmarrjes mbetet nën potencialin e Kosovës. Masat promovuese dhe trajnuese duhen marrë për ta përmirësuar gjendjen. Hulumtuesi i parë me përvojë nga Kosova u financua përmes Aksioneve Marie Skłodowska-Curie vitin e kaluar, bashkëpunim që duhet të rritet më tutje në vitet vijuese.

## 6.15. Çështjet tregtare

Kosova është në **fazë të hershme** të përgatitjes në këtë fushë, me **pak progres** gjatë vitit të kaluar. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të vazhdojë implementimin e liberalizimit të tregtisë sipas MSA-së;
- të ndërmarrë veprime në kuadër të planit shumëvjeçar të veprimit për një Zonë Ekonomike Rajonale;
- të përforcojë kapacitetin administrativ të Ministrisë së Tregtisë, sidomos në kuptimin e zotimeve rajonale në fushën e tregtisë.

Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes për aplikim për status të vëzhguesit në OBT, ku hapi i parë është Memorandumi për Regjimin e Tregtisë së Huaj, që është përgatitur për miratim nga autoritetet e Kosovës. Kosova ka vazhduar të koordinojë pozitat e saj me BE-në për politikën e përbashkët komerciale.

Pak progres është arritur në kuptimin e zonës së lirë tregtare me BE-në, por mundësitë për eksportuesit e Kosovës do të mund të zgjeroheshin me gëzimin e plotë të përparësitë tregtare të ofruara në MSA; Kosova ka hequr detyrimet doganore për një numër linjash tarifore, duke përfshirë produktet industriale, bujqësore dhe peshkatarisë. Detyrimet e mbetura do të tkurren në mënyrë progresive deri më 2025. Përkundër një përmirësimi të paktë në eksportin e shërbimeve më 2017, deficitin tregtar me BE-në ka vazhduar të rritet.

Kosova ka marrë përsipër zotime të rëndësishëm me rastin e Samitit të Ballkanit Perëndimor në Trieshte, në korrik të vitit 2017, për të zbatuar një plan shumëvjeçar të veprimit për zhvillimin e një Zone Ekonomike Rajonale (REA) në Ballkanin Perëndimor. Zbatimi i planit do të mundësojë thellimin dhe zgjerimin e integritit evropian brenda rajonit, në bazë të rregullave dhe standardeve të BE-së. Kosova vazhdon të luajë rol aktiv në Marrëveshjen për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA) dhe mori përsipër kryesimin e saj më 2018.

## 6.16. Politika e ndërmarrjeve dhe ajo industriale

Kosova është **mesatarisht e përgatitur** në këtë fushë. **Pak progres** është arritur duke marrë masa për përmirësimin e ambientit afarist. Ekziston nevoja për të zhvilluar më tutje kapacitetin administrativ dhe për të përforcuar bashkërendimin ndërministror.

Rekomandimet nga raporti i vitit 2016 nuk janë zbatuar plotësisht. Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të zbatojë vlerësimet e ndikimit rregullativ për të zvogëluar ngarkesën administrative mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- të vazhdojë implementimin e rekomandimeve të dhëna në vlerësimin “Small Business Act” (SBA) të BE-së;
- të sigurojë përafrimin e Ligjit për Zonat Ekonomike me *acquis*.

Tek **parimet e politikave të ndërmarrjeve dhe atyre industriale**, strategjia e zhvillimit të sektorit privat 2017-2021, që përfshin politikat industriale, mbetet të miratohet. Projekt-strategjia megjithatë kufizohet në sektorët në përgjegjësi të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe duhen siguruar sinergjitë e duhura me politikat tjera të rëndësishme, si energjia, arsimiti, hulumtimet dhe zhvillimi. Është krijuar Ministri e re për Inovacion dhe Ndërmarrje. Sidoqoftë, ka nevojë të zhvillohen kapacitetet e saj administrative, të sigurohet një bashkërendim më të fortë ndërministror, si dhe të miratohet strategjia e inovacionit.

Ligji për kamatë-vonesat në transaksione tregtare është në përputhje me Direktivën 2011/7/EU për luftimin e pagesave të vonuara në transaksione tregtare.

Tek **instrumentet e politikave të ndërmarrjeve dhe industriale**, Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është riaktivizuar dhe ofron një forum për dialog publiko-privat. Janë bërë hapa pozitivë në ambientin afarist. Në veçanti, janë vendosur masa për lehtësimin e procesit të fillimit të biznesit, qasjes në kredi dhe zgjidhje të paaftësisë së pagesës. Kjo ka rezultuar me renditjen e Kosovës 20 pozita më lart në raportin e Bankës Botërore “Doing Business”. Ekzistojnë 8 parqe industriale në faza të ndryshme të përfundimit, si dhe 1 park biznesi plotësisht funksional. Por, Ligji për Zonat Ekonomike, që rregullon themelimin dhe financimin e zonave ekonomike, nuk është në përputhje me *acquis të BE-së*. Nuk ka programe specifike për ristrukturim, as për zhvillimin e sektorëve specifike, e as për modernizimin e industrisë pa marrë parasysh sektorët.

Pak progres është bërë në diversifikim dhe lehtësim të qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me fonde shtesë të ndara për Fondin e Kosovës për Garanci Kreditorë. Në janar të vitit 2017, u themelua Grupi Kombëtar Koordinues për Aktin për Biznes të Vogël (SBA), udhëhequr nga Agjencia Kosovare për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA). Megjithatë, KIESA ende duhet të përforcojë kapacitetet e saj. Rekomandimet e vlerësimit të Aktit të Biznesit të Vogël nuk janë implementuar ende.

Në dhjetor të vitit 2017, u nënshkrua një marrëveshje për pjesëmarrjen e Kosovës në programin e BE-së për konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME). Kosova do të arrijë të ketë qasje në fondet e COSME-s pasi të përfundojnë procedurat e brendshme për aprovimin e marrëveshjes. Kosova duhet të fillojë zhvillimin e masave për të rritur vetëdijen tek palët e biznesit dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në program.

## 6.17. Bujqësia

Kosova **ka një nivel përgatitjeje** në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. **Pak progres** është bërë në zbatimin e programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Në vitin

vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të përmirësojë vlerësimin dhe monitorimin e granteve dhe pagesave të drejtpërdrejta të ofruara në kuadër të programit të bujqësisë dhe zhvillimit rural;

→ të rishikojë dhe përditësojë programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, ashtu që investimet në këtë sektor të jenë më efikase.

Tek **çështjet horizontale**, buxheti prej 46 milionë Eurosh i ndarë për sektorin bujqësor ka mbetur stabil, edhe për pagesat direkte edhe për grantet investuese. Sidoqoftë, mungesat e stafit dhe monitorimi joadekuat, vlerësimi, kontabiliteti dhe auditimi i brendshëm në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor vazhdojnë të dëmtojnë procedimin e mirëfilltë të kërkesave dhe ekzekutimin e pagesave. Strategjia dhe Programi për bujqësi dhe zhvillim rural (2014- 2020) janë të vëna në zbatim. Megjithatë, pas regjistrimit bujqësor kryer më 2015, si dhe në përputhje me zhvillimet në sektor, masat e planifikuara në këtë program duhen rishikuar e përditësuar për të shfrytëzuar më së miri dhe për të arritur ndikim maksimal të fondeve për bujqësinë, për të rritur të hyrat e bujqve dhe për të përmirësuar jetesën e popullatës rurale.

Tek **pagesat direkte**, një masë e konsiderueshme e përkrahjes për bujqësi, përtej investimeve, ofrohet përmes pagesave direkte. Përkrahja e tillë mbetet kryesisht e lidhur me prodhimtarinë, derisa lidhjet me përputhshmërinë e tërthortë ende duhen implementuar.

Kosova ka krijuar një **Sistem të thjeshtuar të Identifikimit të Parcelave Tokësore**, një regjistër fermash dhe një sistem të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve. Pak progres është bërë drejt krijimit të një **Sistemi të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit**. **Rrjeti i të dhënave të llogarive të fermës** është i vënë në funksion.

Nuk është bërë ndonjë përparim në lidhje me krijimin e një **organizate të përbashkët tregu**. Kosova duhet të bëjë hapa për të krijuar bazën ligjore për themelimin dhe funksionimin e tyre.

Në fushën e **zhvillimit rural**, masat kryesisht adresojnë modernizimin e fermave dhe stabilimenteve të përpunimit ushqimor. Sidoqoftë, niveli i financimit dhe efikasiteti i masave aktuale të zhvillimit rural mbeten të dobëta, sidomos në lidhje me investimet në ferma, përpunim primar të ushqimit, krijim të vendeve të punës në zonat rurale, zhvillimin dhe fuqizimin e komuniteteve lokale, si dhe komasacionin e tokës, qasjen në ujë dhe azhurnim të edukimit të bujqve.

Tek **politikat e cilësisë** dhe tek bujqësia organike, legjislacioni mbetet të zbatohet.

Kosovës i mungon strategjia në këtë drejtim. Sistemi i certifikimit organik, i pajtueshëm me kriteret e *acquis*, mbetet të zhvillohet. Kosova duhet të rrisë kapacitetet për implementimin e Ligjit për Bujqësi Organike. Legjislacioni në sektor nuk është dizajnuar të përputhet me *acquis*.

Ndryshimet ligjore në shfrytëzimin e tokës bujqësore vazhdojnë të ndikojnë në disponueshmërinë edhe ashtu të kufizuar të tokës së punueshme dhe produktivitetin e fermave. Nuk ka informata se sa tokë bujqësore humb Kosova në baza vjetore, si dhe nuk ka ndonjë strategji apo plan veprimi për të adresuar këtë çështje. Ministria e Bujqësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet të ndërmarrë masa urgjente për të ndaluar humbjet e mëtutjeshme të tokës bujqësore, si dhe të zbatojë legjislacionin që rregullon planifikimin hapësinor.

#### **6.18. Politikat për siguri ushqimore, veterinare dhe fitosanitare**

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** në fushën e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare. **Pak progres** është bërë në këtë fushë.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të implementojë një sistem të integruar të kontrollimit të ushqimit, edhe me bartjen e përgjegjësive inspektuese tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;

→ të përfundojë dhe të vërë në zbatim sistemin e grumbullimit dhe depozitimit të nus-produkteve shtazore;

Në fushën e **sigurisë së ushqimit**, nevojiten përpjekje plotësuese për të kompletuar legjislacionin që rregullon fushën e sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë. Regjistrimi dhe kategorizimi i stabilimenteve të ushqimit dhe ushqimit për kafshë janë në vazhdim e sipër. Agjencia vazhdon të bëjë kontrole të rregullta të importimit dhe eksportimit të kafshëve të gjalla, produkteve shtazore, bimëve dhe produkteve bimore. Lejet e importit për ndërmarrjet e regjistruara në BE nuk kërkohen më. Puna në krijimin e një plani për monitorimin e barnave dhe mbetjeve është në vazhdim. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ende nuk ka përgatitur plan shumëvjeçar kontrolli për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe ende nuk ka rritur kapacitetet në këtë drejtim.

Përgjegjësitë e inspektimit ende nuk janë transferuar nga komunat tek Agjencia, duke krijuar kështu një sfidë të vazhdueshme për implementimin e një sistemi të integruar të kontrollit ushqimor.

Tek **politika veterinare**, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë aktualisht po avancohet sistemin e vet për inspektime kufitare. TRACES përdoret vetëm për eksporte.

Në fushën e **shëndetit shtazor**, pak progres është bërë. Programi shumëvjeçar për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e sëmundjeve shtazore është në funksion. Sidoqoftë, implementimi i plotë i programit do të ketë nevojë për alokim të mjaftueshëm të fondeve dhe kapaciteteve për Agjencinë. Si pjesë e përpjekjeve rajonale për kontrollimin dhe zhdukjen e tërbimit, Agjencia po punon për të rifilluar fushatat e vaksinimit. Programi i vaksinimit për sëmundjen e gungave të lëkurës (LSD) është në vazhdim e sipër. Duke pasur këtë parasysh, kapacitetet e Agjencisë për reagim emergjent në rast epidemie mbeten të pamjaftueshme.

Sa i përket menaxhimit të **nusprodukteve shtazore**, përparim është bërë në ndërtimin dhe pajisjen e impiantit depozitues të Kategorisë I. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar menaxhimin e mirëfilltë dhe sistemin e grumbullimit për nusprodukte shtazore.

Sa i përket identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, mosraportimi i lëvizjeve shtazore mbetet problematik. Masat për zbatimin e rregullores për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve në nivel të tregjeve të shtazëve, thertoreve dhe transportit të bagëtisë ende nuk janë miratuar nga Agjencia.

Identifikimi i masave themelore të përputhshmërisë së tërthortë në fushat e sigurisë së ushqimit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve mbetet prioritet për Agjencinë, me synimin që ato të përfshihen në programin e bujqësisë 2018.

Në sektorin e **fitosanitarisë**, nuk është arritur ndonjë përparim. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të përforcuar kapacitetet zbatuese dhe operacionale të institucioneve përgjegjëse për shëndetin e bimëve në Kosovë, për të siguruar sistem efektiv të kontrollit të sëmundjeve bimore.

#### 6.19. Peshkataria

Kosova është në një **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e peshkatarisë. **Nuk është bërë progres.**

Në vitin Kosova duhet që posaçërisht:

- Të përafrojë më tutje politikën e saj të tregut me *acquis*;
- Të krijojë inventarin e specieve të peshqve në Kosovë.

*acquis* për kuotat e zënies, menaxhimit të kapacitetit të flotave, inspektimin dhe kontrollin kanë zbatueshmëri të kufizuar, pasi që sektori i peshkatarisë bazohet në peshkim dhe akuakulturë komerciale të liqeneve. Kosova duhet të përgatisë **politikë tregu** si dhe të bëjë inspektimet në përpajtje me *acquis* të BE-së.

#### 6.20. Mjedisit dhe ndryshimet klimatike

Kosova është në **fazë të hershme të përgatitjes** në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. **Nuk është arritur progres** dhe problemet serioze mjedisore vazhdojnë të ndikojnë në jetesën dhe shëndetin e popullatës. Mbrojtja e mjedisit dhe ndryshimet klimatike kërkojnë vullnet shumë më të madh politik për të adresuar sfidat në rritje.

Pasi që shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë implementuar, në vitin vijues, Kosova duhet që:

- Të vendosë sisteme monitorimi të cilësisë së ajrit në kohë reale, si dhe të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, të publikojë të dhënat dhe të ndërmarrë masa urgjente për të zbutur ndotjen e ajrit dhe ujit;
- Të rrisë mbulueshmërinë e grumbullimit të mbeturinave urbane për të adresuar çështjen e deponive të paligjshme;
- Të ekzekutojë dispozitat ligjore për përgjegjësinë, dëmtimet dhe krimin mjedisor; të implementojë parimin *ndotësi pagan* dhe të ngrejë vetëdijen publike për mbrojtjen e mjedisit;
- Të implementojë strategjinë për adaptimin me ndryshimet klimatike dhe zhvillimin me emisione të ulëta, në përpajtje me kornizën EU 2030 për politikën e klimës dhe energjisë.

## Mjedisi

Sa i përket **legjislacionit horizontal**, nevojitet përparim i mëtutjeshëm për përafrim dhe zbatim të plotë të direktivave të mbetura mjedisore që janë të ndërthurura. Mungesa e zbatimit të Direktivës për Përgjegjësinë Mjedisore dëmton efektshmërinë e mbrojtjes mjedisore. Inspektoratet mjedisore nuk kanë staf dhe kapacitet, si dhe nuk arrijnë të sigurojnë zbatim efektiv, edhe pse janë bërë përpjekje për përafrim me Direktivën e Krimit Mjedisor. Strategjia e mjedisit ende duhet përditësuar dhe zbatuar. Implementimi i masave prioritare dëmtohet nga financimi i pamjaftueshëm, mungesa e kapaciteteve administrative dhe e aftësive teknike. Zbatimi i vlerësimeve të ndikimit mjedisor dhe strategjik duhet të përmirësohet në masë të konsiderueshme, sidomos në sektorët industrialë me efekte të konsiderueshme në mjedis, si energjia dhe transporti. Është e domosdoshme edhe angazhimi kuptimplotë i publikut dhe shoqërisë civile.

Ende mbesin të miratohen masat për përmirësimin e **cilësisë së ajrit**. Cilësia e ajrit, sidomos në zonat urbane, vazhdon të përbëjë kërcënim madhor ndaj shëndetit publik. Strategjia e Kosovës për cilësi ajri, si dhe ligji për cilësinë e ajrit të ambientit vazhdojnë të mos ekzekutohen. Ndotja e pakontrolluar nga sektori i energjisë - sidomos nga termocentrali Kosova B dhe ngrohja në ekonomi familjare - por edhe nga komplekset industriale, trafiku rrugor, djegia e mbeturinave dhe materialet tjera toksike, mbetet problem serioz. Planet e cilësisë së ajrit për zonat ku nivelet e ndotësve dukshëm tejkalojnë vlerat kufitare në masë të madhe, sidomos gjatë dimrit, ende nuk janë përgatitur e as miratuar. Sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit ende mbetet të ofrojë të dhëna në kohë reale për publikun. Ka mungesë të resurseve të mjaftueshme financiare dhe kapaciteteve për mirëmbajtjen dhe kalibrimin e pajisjeve monitoruese. Nevojiten masa urgjente për të zvogëluar varësinë e ekonomive familjare nga ngrohja me linjit.

Sistemi aktual i **menaxhimit të mbeturinave** të ngurta në Kosovë është i paqëndrueshëm në kuptimin mjedisor. Korniza ligjore është pjesërisht e përafruar, por mbeturinat mbesin njëri prej problemeve më madhore në Kosovë. Shumica e rrjedhave të mbeturinave përfundojnë në deponi të ligjshme e të paligjshme. Grumbullimi i mbeturinave duhet të zgjerohet më tutje. Strategjia dhe Master-Plani për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022 vetëm pjesërisht pasqyrohen në planet komunale për mbeturina të ngurta. Autoritetet përgjegjëse duhet të ndërmarrin hapa drejt një qasjeje qarkore ekonomike, duke siguruar ndarjen e mbeturinave në burim, riciklimin dhe rikuperimin e rrjedhave të mbeturinave. Numri i lartë i deponive duhet të adresohet urgjentisht dhe në mënyrë të qëndrueshme. Shumica e deponive ekzistuese janë në përfundim të kapaciteteve të tyre deponuese, si dhe përbëjnë rrezik të konsiderueshëm e afatgjatë mjedisor, sidomos për kontaminimin e ujërave nëntokësore. Kjo sidomos vlen për deponinë e Mirashit në Obiliq.

Në fushën e **cilësisë së ujit**, niveli i përafrimit është i kufizuar. Strategjia dhe plani i veprimit për mbrojtjen e ujit ende nuk janë miratuar, si dhe kërkohen veprime urgjente për të siguruar funksionimin e autoritetit të pellgjeve lumore, themeluar në korrik të vitit 2017, duke përfshirë edhe përgatitjen e planit të menaxhimit. Kanalizimet dhe shkarkimet e patrajtuara mbesin burim qenësor i ndotjes. Rrjeti i monitorimit të ujërave nëntokësore është në fazë të hershme. Sistemi për monitorimin e ujërave sipërfaqësore ende nuk është funksional. Është publikuar një raport mbi cilësinë e ujit të pijes. Kërkohet identifikimi i aglomeracioneve dhe definimi i zonave të ndjeshme, në përputhje me Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane. Duhet të sigurohet edhe financimi buxhetor për projektet prioritare në këtë fushë. Inkasimi i tarifave duhet të përmirësohet, ndërsa humbjet teknike të ujit të zvogëlohen.

Tek **mbrojtja e natyrës**, nuk ka pasur progres në përafrim me *acquis*. Mbrojtja efektive për zonat e caktuara të mbrojtjes ende nuk është e vendosur. Ndërtimet e paligjshme në zonat e mbrojtura duhen luftuar në mënyrë efektive. Planet e infrastrukturës duhet të sigurojnë respektimin e obligimeve për mbrojtjen e natyrës, sidomos në hapësirat që mund të potencialisht mund të bëhen lokacione të mbrojtura Natura 2000. Procesi i përcaktimit Natura 2000 është ende krejt në fillim, për shkak të mungesës së kapaciteteve teknike dhe të personelit në institucionet relevante. Sidoqoftë, janë bërë hapa për fillimin e inventarizimit dhe identifikimit të llojeve të habitateve

natyrore dhe të biodiversitetit.

Tek **ndotja industriale dhe menaxhimi i rreziqeve**, përafrimi mbetet në fazë të hershme. Zbatimi i pamjaftueshëm i legjislacionit dhe llogaridhënia e pamjaftueshme e ndotësve po ngadalëson përparimin në krijimin e një sistemi për parandalimin e fatkeqësive industriale dhe kimike. Mbeturinat e rrezikshme minerare, si dhe deponitë industriale vazhdojnë të përbëjnë rrezik serioz ndaj dheut dhe ujit. Duhet themeluar mekanizma për të siguruar qëndrueshmëri të kostove operacionale të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave. Ende mbetet të nominohet operatori për stabilimentin e ardhshëm të depozitimit të mbeturinave të rrezikshme.

Tek **kimikaliet**, përafrimi me *acquis* mbetet në fazë të hershme. Kosova nuk është palë e Konventës së Roterdamit për Procedurën e Pëlqimit me Informim Paraprak për disa kimikalie dhe pesticide të dëmshme në tregtinë ndërkombëtare, si dhe ende mbetet të implementohet korniza rregullative për eksportimin dhe importimin e kimikalieve të dëmshme.

Ende mbetet të miratohet ligji i ri për **zhurmën**. Ende mbetet të hartohen hartat e zhurmës dhe planet e veprimit, por edhe veprimet efektive në zbatim të ligjit.

Kosova nuk është pjesë e **Mekanizmit të BE-së për Mbrojtje Civile**, por është përfutuese e programit të Bashkëpunimit në Mbrojtje Civile IPA, që prej vitit 2010. Ende është i domosdoshëm përparimi i konsiderueshëm në fusha të rëndësishme, si mbrojtja nga vërshimet.

### **Ndryshimet klimatike**

Niveli i përafrimit mbetet i kufizuar. Sa i përket kornizës strategjike, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike ende nuk janë miratuar. Strategjia përmban edhe një komponentë për adaptimin me ndryshimet klimatike. Këshilli Kombëtar për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike ka dështuar të marrë masa konkrete për të standardizuar veprimet klimatike, si dhe për të rritur vetëdijen e publikut. Ende nuk ka dëshmi të standardizimit të ndryshimeve klimatike brenda ndonjërit prej projekteve qeveritare. Kjo sidomos mungon në sektorin e energjisë dhe transportit.

Edhe pse Kosova nuk është palë nënshkruese e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike, e kështu nuk ka përgatitur Kontributin e Synuar të Përcaktuar nga Shteti për Marrëveshjen e Parisit 2015, implementimi i plotë i strategjisë së saj për ndryshimet klimatike do të duhej të ndihmonte Kosovën në arritjen e objektivave të emisioneve të ulëta dhe të qëndrueshmërisë së klimës nga kjo marrëveshje.

Sa i përket transparencës së veprimit klimatik, përgjegjësia për përpilimin e raporteve të inventarit të gazrave me efekt serrë (GHG) qëndron tek Agjencia e Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit. Inventari i vitit 2014 është dorëzuar, ndërsa ai i vitit 2015 është aktualisht duke u përgatitur. Kosova ende mbetet të përafrohet me Sistemin e Tregtimit të Emisioneve të BE-së. Duhet bërë përpjekje të mëtutjeshme në fushën e standardeve të emisioneve për veturat dhe furgonët e rinj, informimit të konsumatorëve, cilësisë së karburanteve si dhe ndarjes së përpjekjeve, depozitimit gjeologjik të CO<sub>2</sub>, shfrytëzimit të tokës, ndryshimeve në destinim të tokave, substancave shturëse të ozonit dhe gazrave me flor. Kapacitetet administrative, e sidomos aktivitetet e vetëdijesimit, duhen përforcuar në masë të konsiderueshme.

### **6.21. Politika e transportit**

Kosova është **në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje** në fushën e politikës së transportit. **Pak progres** është arritur në implementimin e reformës së lidhshmërisë, por nevojiten përpjekje të mëtutjeshme në lidhjet e rajonit. Më shumë punë duhen në përforcim të kapaciteteve administrative për të gjitha mënyrat e transportit.

Pasi që shumica e rekomandimeve të vitit 2016 nuk janë implementuar ende, në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të përmirësojë sigurinë rrugore duke synuar zvogëlimin e fatalitetit; si dhe të krijojë një sistem për grumbullimin e vazhdueshëm të të dhënave nga ndeshjet në rrugë;
- të përforcojë kapacitetet e rregullatorit të hekurudhave, si dhe të sigurojë pavarësinë e tij financiare dhe operacionale;
- të miratojë legjislacionin për Sistemin Inteligent të Transportit (ITS), të definojë kornizën strategjike për implementimin e ITS-së në rrjetet themelore, duke siguruar kapacitete e resurse të mjaftueshme për zbatimin e tij;
- bëjë përpjekje për respektim të kërkesave sipas fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes ECAA;
- të vazhdojë përpjekjet për zbatimin e legjislacionit evropian për të drejtat e udhëtarëve në të gjitha mënyrat e transportit.

Sa i përket *acquis* për **transportin e përgjithshëm**, legjislacioni nuk është përafuar me *acquis* për aranzhimet verore. Duhet bërë përpjekje për të përfunduar përafrimin me *acquis* për obligimin e shërbimeve publike, duke përfshirë transpozimin e *acquis* për procedurat dhe kriteret për dhënien e kontratave të shërbimit publik në fushën e transportit rrugor. Kapaciteti administrativ për të gjitha mënyrat e transportit mbetet i pamjaftueshëm. Duhet përpjekje të mëtutjeshme për transpozimin e Direktivës ITS dhe Direktivës së ndërveprueshmërisë hekurudhore.

Tek **transporti rrugor**, korniza ligjore për mallrat e rrezikshme ende nuk është përafuar me *acquis*. Qasja në treg për transportin e mallrave dhe udhëtarëve, si dhe kriteret për qasje në operator të zënies së transportit rrugor gjithashtu kërkojnë përafrim të mëtutjeshëm. Nevojitet harmonizim i mëtutjeshëm edhe tek interoperabiliteti i sistemeve të pagesave rrugore. Përafrimi me *acquis* për legjislacionin social dhe sigurinë rrugore nuk është i plotë, por është i domosdoshëm për zvogëlimin e fatkeqësive me fatalitet. Për të zvogëluar rastet fatale, duhet edhe informim, edukim, trajnim, por edhe zbatim efektiv i rregullave të trafikut. Sa i përket zbatimit të legjislacionit social, nevojiten përmirësime në kontrollet e rrugëve, përforcimin e kompetencave ligjore dhe kapaciteteve të zyrtarëve inspektues, si dhe në miratim e zbatim të rregullave për ndëshkimet ndaj cenimit të Marrëveshjes Evropiane për Punën e Flotave të Automjeteve të angazhuara në Transport Rrugor Ndërkombëtar (AETR). Legjislacioni për automjetet e pastra dhe efikase në energji në transport rrugor, si dhe për zhvillimin e infrastrukturës për lëndë djegëse alternative nuk është përafuar ende. Nuk ka legjislacion e as kornizë rregullative për implementimin e Sistemeve Inteligjente të Transportit (ITS).

Sa i përket **transportit hekurudhor**, është licencuar një operator privat dhe ka marrë certifikatën e sigurisë për ofrimin e shërbimeve të transportit të mallrave. Ka pak progres në legjislacionin për sigurinë hekurudhore, por duhet bërë përpjekje për të plotësuar kriteret për zbatim të tij. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme në përafrim me *acquis* për interoperabilitetin. Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10 (lidhja nga kufuri me Serbinë deri në atë me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë) do të ketë nevojë për rritje të kapaciteteve të Infrakos-it, kompania infrastrukturore e hekurudhave.

Tek **aviacioni**, Kosova ka përparuar në përafrim me *acquis* të BE-së si dhe ka zbatuar gati të gjitha kërkesat sipas fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), me përjashtim të disa dispozitave në fushën e rregullimit ekonomik, që lidhen posaçërisht me ligjin e punës. Kosova ka arritur pak përparim në përafrimin me kornizën e Qiejve të Përbashkët Evropiane II (SES II), si dhe në implementimin e Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, për ç'gjë nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për aplikim të plotë të saj. Nuk ka legjislacion për **transportin e kombinuar**. Mundësitë për zhvillimin e transportit të kombinuar duhet shtyrë më tutje.



## 6.22. Energjia

Kosova mbetet në **fazë të hershme** në fushën e energjisë. Ka pak progres në këtë fushë, duke përfshirë zbatimin e mëtutjeshëm të pakos së tretë të energjisë, sidomos në tregun e brendshëm të energjisë si dhe në heqjen e tarifave mbi produktet e naftës.

Pasi që shumica e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë implementuar, në vitin vijues, Kosova duhet që:

- të miratojë planin e veprimit për strategjinë e energjisë 2017-2026;
- të implementojë *acquis* për sigurinë e furnizimit, dekomisionimin e termocentralit Kosova A, si dhe të sigurojë vendosjen e kapaciteteve të reja gjeneruese;
- të plotësojë emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si dhe të përforcojë pavarësinë dhe stabilitetin e saj financiar;
- të rishikojë planin e saj të veprimit për të arritur cakun e detyrueshëm të energjisë së ripërtërishme prej 25% më 2020;
- të miratojë ligjin për eficiencën e energjisë, si dhe të krijojë Fondin e Eficiencës së Energjisë.

Kosova duhet të miratojë planin e veprimit për Strategjinë e Energjisë 2017-2026 për të vënë në zbatim orientimet e politikave të parapara me strategjinë e energjisë tashmë të miratuar. Edhe nëse kjo do të adresonte disa prej problemeve të energjisë dhe mjedisit në afat të mesëm, Kosova vazhdon aktualisht të bazohet gati ekskluzivisht tek linjiti si burim i energjisë si dhe në dy termocentrale të vjetëruara e ndotëse me qymyr. Si pasojë, Kosova vazhdon të përballet me ndotje të madhe ajri dhe reduktime në furnizim të energjisë elektrike.

Tek **siguria e furnizimit**, investimet dhe mirëmbajtja vazhdojnë të përmirësojnë besueshmërinë e sistemit të transmisionit të energjisë. Megjithatë, linja e re e transmisionit me Shqipërinë mbetet jashtë funksionit, për shkak të moszbatimit të marrëveshjes së koneksionit mes Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës. (*cfr. Pjesa Rrjetet Trans-Evropiane*). Deri sa humbjet në distribucion janë në rënie të ngadalshme, shpejtësia e investimeve në rrjetin e shpërndarjes nuk është e kënaqshme. Humbjet e kombinuara komerciale (në fatura të papaguara) dhe teknike më 2016 qenë të larta me 30%. Nuk ka pasur progres në përafrim të legjislacionit në fushën e akumulimeve të detyrueshme të naftës dhe rezervave obligative të naftës me *acquis*. Aktualisht, stoqet e naftës vlerësohen të qëndrojnë vetëm për katër ditë. Tarifat mbi produktet e naftës (lubrifikantë dhe koks naftë) janë hequr.

Sa i përket **tregut të brendshëm të energjisë**, ka pasur pak progres në zbatim të legjislacionit që transponon Pakon e Tretë të Energjisë. Autoriteti rregullator filloi lëvizjen drejt hapjes së tregut, duke miratuar rregullat e këmbimit dhe duke lëshuar licenca për dy furnizues të rinj për operim në tregun e Kosovës. Një tregtues me bazë në BE u pranua pa pasur nevojë për licencë shtesë.

Sa i përket kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë, marrëveshja komerciale për termocentralin e ri është nënshkruar me ofertuesin në dhjetor të vitit 2017, por ndikimi potencial i saj mbi financat publike, tarifat dhe mjedisin ende mbetet të vlerësohet. Nevojiten urgjentisht masa mjedisore në termocentralin Kosova B, për të zvogëluar nivelin e shkarkimit të hirit në ajër dhe për të respektuar planin e zvogëlimit të emisioneve. Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, shtyrja e planit të zvogëlimit të emisioneve deri në janar të vitit 2022 është shkelje e dispozitave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Kosova ka bërë pak progres në de-rregullimin e pjesshëm të çmimit të gjenerimit dhe largimit të subvencioneve të tërthorta mes kategorive të ndryshme të konsumatorëve. Por, konsumi i energjisë elektrike (faturat e papaguara) në veri të Kosovës vazhdon të trajtohet si humbje komerciale, e cila rikupërohet nga tarifat e shitjes me pakicë. Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë është tashmë

funksional, por kapaciteti dhe pavarësia e Zyrës janë dëmtuar nga ndërhyrjet politike, kapacitetet e dobëta administrative dhe mungesa e resurseve njerëzore.

Ka pasur tejet pak progres në sektorin e burimeve të **energjisë së ripërtërishme**. Derisa legjislacioni është përafuar pjesërisht me *acquis*, duhet të vihet në zbatim dizajni i ri i tregut të energjisë elektrike, për të mundësuar integrimin e gjenerimit të energjisë së ripërtërishme. Tregu i ankandeve për prodhues mbetet i paqenë. Ende mbetet të hartohet legjislacioni në përputhje me masat e lidhmërisë (konektivitetit).

Kosova duhet të rishikojë planin e saj të veprimit për të zënë hapin në arritje të caktuar të energjisë prej 25 % më 2020. Niveli i investimeve mbetet minimal, përkundër ekzistimit të kornizës ligjore për skemat mbështetëse për energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtërishme. Kosova duhet të vëjë në zbatim një qasje të bazuar në treg për promovimin efektiv në kosto të energjisë së ripërtërishme dhe integrimin e energjisë së ripërtërishme në treg. Kyçja dhe qasja në rrjetin e transmisionit dhe atë të distribucionit mbeten barrierat kryesore për prodhuesit e energjisë së ripërtërishme, për shkak të paaftësisë së operatorëve të rrjeteve për t'u përballur me prodhimin e energjisë elektrike me ndërprerje. Nuk ka rregullore për kriteret minimale për energjinë e ripërtërishme në ndërtesa. Nuk ka pasur progres në përmbushjen kritereve për përdorimin e bio-karburanteve në transport.

Ka pasur pak progres në përafrimin me *acquis* të **efiçencës së energjisë**, me miratimin më 2017 të një ligji për performancën energjetike të ndërtesave. Megjithatë, ligji i ri - lidhur me projektligjin për Fondin e Efiçencës së Energjisë - për efiçencën e energjisë ende mbetet të miratohet. Plani i veprimit për efiçencë të energjisë 2010- 2018 parasheh një cak kursimesh të energjisë prej 9%, që duket i pagjasë. Kosova ka aprovuar planin e veprimit për efiçencën e tretë të energjisë. Krijimi i Fondit të Efiçencës së Energjisë mbetet qenësor për sigurimin e më shumë investimeve në masa të efiçencës së energjisë në sektorin publik dhe atë banesor. Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë ka mungesë stafi dhe kapacitete të dobëta për të monitoruar, vlerësuar e verifikuar përparimin drejt caqeve.

Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes së kornizës ligjore e rregullative për **sigurinë nukleare dhe të rrezatimit**. Ligji për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Nukleare është miratuar. Kapaciteti i Agjencisë së Sigurisë Nukleare dhe Mbrojtjes nga Rrezatimi në licencim dhe inspektime mbetet i dobët, ndërsa fondet janë të pamjaftueshme për të përmbushur mandatin e saj. Nuk ka monitorim të rrezatimit (për shembull të uranit të varfëruar), nuk ka kontrollim të mbeturinave radioaktive, e as plan emergjent radiologjik. Ende mbetet të gjendet zgjidhja për depozitimin e përhershëm të mbeturinave radioaktive. Kosova nuk është palë e Konventës për Siguri Nukleare e as Konventës së Përbashkët për Sigurinë e Menaxhimit të Karburanteve të Shpenzuara dhe për Sigurinë e Menaxhimit të Mbeturinave Radioaktive.

### 6.23. Rrjetet Trans-Evropiane

Në fushën e rrjeteve trans-evropiane, Kosova ka **një nivel përgatitjeje dhe pak progres** është arritur në transportin rrugor gjatë periudhës së raportimit. Më shumë duhet të bëhet në energji dhe telekomunikacion.

Në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ të vazhdojë me harmonizimin e kornizës ligjore me *acquis* dhe rregulloret TEN-T dhe TEN-E, si dhe me implementimin e masave të reformimit të lidhmërisë;

→ të përforcojë kornizën institucionale dhe kapacitetet administrative për zhvillimin dhe monitorimin e rrjeteve trans-evropiane;

→ Të përforcojë kapacitetin e Autoritetit Rregullatik për Komunikime Elektronike dhe Postare për të zbatuar rregulloret e tregut të telekomunikacionit.

Tek **rrjetet e transportit**, korniza strategjike për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit mbulohet me strategjinë sektoriale dhe multimodale të transportit (STMTS) 2015- 2025, bashkë me planin pesëvjeçar të veprimit. SMTS-ja duhet të rishikohet dhe përditësohet çdo vit. Përfundimi i procedurave të brendshme për aprovimin e Traktatit të Komunitetit të Transportit, nënshkruar në qershor të vitit 2017 është në pritje.

Përvoja me zbatimin e projekteve të autostradave 6 dhe 7 ka demonstruar dhe treguar kapacitetin institucional për të implementuar projekte strategjike. Megjithatë, ky kapacitet duhet të përforcohet e mirëmbahet më tutje, sidomos aty ku bëhet fjalë për angazhim në zhvillimin e Rrjeteve Trans-Evropiane. Projektet prioritare në rrjetet themelore dhe gjithëpërfshirëse ende mbeten të kryhen. Miratimi pesëvjeçar i planeve të mirëmbajtjes për gjithë rrjetin themelor është ende në fazë të hershme, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme.

Tek rrjetet e energjisë, sistemi i transmisionit të Kosovës është i ndërlidhur me sistemet e transmisionit të Evropës Juglindore. Linja e re e transmisionit 400 kV dhe kontrolli i frekuencës së ngarkesës me Shqipërinë nuk janë funksionale, për shkak të moszbatimit të marrëveshjes së lidhjes mes Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës. Kosova nuk ka infrastrukturë vendore të gazit. Një studim para-fizibiliteti në vazhdim do të hulumtojë mundësinë e lidhjes së Kosovës dhe Shqipërisë në Projektin e Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP).

Tek **rrjetet telekomunikuese**, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është autoriteti qendror rregullativ në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare. Autoriteti luan rol kyç në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës digjitale. Kapaciteti i tij për të hartuar e zbatuar rregullore duhet përforcuar më tutje.

#### 6.24. Shoqëria e informacionit dhe mediat

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** për këtë fushë. Korniza ligjore është kryesisht në vend, por **nuk ka pasur progres** në zbatim të saj. Në veçanti, Kuvendi ende nuk ka siguruar pavarësinë financiare të transmetuesit publik. Si në vitet e kaluara, Komisioni i Pavarur për Media nuk ka ecur përpara me procesin e kalimit nga televizioni analog në atë digjital.

Pasi që rekomandimet e raportit paraprak nuk janë adresuar, vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- Të sigurojë që rregullatorët e telekomit dhe mediave të kenë resurse adekuate për të zbatuar mandatet e tyre në mënyrë të pavarur dhe të zhvillojë një zgjidhje për financim të qëndrueshëm të transmetuesit publik;
- Të sigurojë implementimin e plotë të numrit emergjent evropian 112;
- Urgjentisht të implementojë kalimin digjital.

Tek **komunikimet elektronike dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit**, nuk ka pasur përmirësim në pavarësinë financiare dhe organizative të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Agjencia e Statistikave të Kosovës për herë të parë publikoi të dhënat për përdorimin e TIK-ut. Sipas hulumtimit, 88.8% të ekonomive familjare kishin qasje në internet, prej të cilave 83.6% qasen në internet përmes lidhjeve fikse, ndërsa 24.6

% përmes lidhjeve mobile. Të dhënat nga autoriteti rregullator tregojnë që penetrimi i telefonisë mobile ka arritur mbi 112 %, derisa penetrimi i linjave fikse telefonike për ekonomi familjare është 23%. Edhe pse Ekipi Reagues për Sigurinë dhe Incidentet Kompjuterike është krijuar më 2014, ai ende ka mungesë të stafit të mjaftueshëm dhe të trajnuar. Kosova ka filluar të zbatojë numrin emergjent evropian 112, ndërsa autoriteti rregullator bashkëpunon me të gjitha palët e interesit që janë përgjegjëse për operimin e tij. Në shkurt të vitit 2017, rregullatori ofroi të dhënat gjeografike të stacioneve mobile (2G, 3G dhe 4G) tek Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave.

Kosovës i është caktuar kodi i thirrjeve 383 në dhjetor të vitit 2016, në pajtim me planin e veprimit të dakorduar në Dialogun Beograd-Prishtinë. Kodet e mëparshme të thirrjeve do të pushojnë së funksionuari në qershor të vitit 2018.

Tek **shoqëria e informacionit**, duhet të vihen në dispozicion resurse adekuate buxhetore për të implementuar strategjinë dhe planin e veprimit për siguri kibernetike 2016-2019.

Tek **politika audio-vizuale**, Komisioni i Pavarur për Media prapë ka dështuar të bëjë ndonjë përparim substancial në implementimin e kalimit digjital, edhe pse afati i Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit ka skaduar në qershor të vitit 2015. Nuk janë ndarë e as identifikuar fonde për të implementuar këtë proces. Si rregullator i mediave, Komisioni për Media duhet të ketë stafin dhe fondet adekuate për të vepruar në mënyrë të pavarur. Kosova duhet të përshpejtojë përpjekjet e saj dhe të sigurojë që kalimi në sistemin digjital të bëhet në transparencë të plotë dhe në përputhje me standardet e BE-së. Transmetuesi publik RTK mbetet i financuar drejtpërdrejt nga shteti, gjë që minon pavarësinë e tij redaktuese. Dështimi i Kuvendit për të vepruar në lidhje me varësinë financiare të RTK-së është posaçërisht brengosës, pasi që kjo dobëson qëndrueshmërinë afatgjate, si dhe dëmton kapacitetin e tij për të ushtruar mandatin e tij si shërbim publik.

## 6.25. Kontrolli financiar

Kosova është në **fazë të hershme** në fushën e kontrollit financiar. **Pak progres** është bërë në fushën e auditimit të jashtëm me zgjerimin e mëtutjeshëm të auditimeve të performancës. Implementimi i strategjisë së kontrollit të brendshëm të financave publike (PIFC) dhe planit të saj të veprimit po ngec. Nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të jetësuar llogaridhënien menaxheriale në kulturën administrative, si dhe për të implementuar PIFC-në në të gjitha nivelet e administratës dhe ndërmarrjet publike.

Pasi që rekomandimet e Komisionit për vitin 2016 nuk janë adresuar, vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

- të miratojë legjislacionin sekondar që rrjedh nga ligji i ri për PIFC;
- të fillojë zbatimin e shqyrtimeve të kontrollit të brendshëm në institucione publike, si vazhdimësi e pyetësorëve të vetë-vlerësimit;
- të fillojë marrjen e masave efektive për të siguruar nivel më të lartë të adresimit të rekomandimeve për auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë edhe vetëdijesimin tek menaxherët.

### Kontrolli i brendshëm i financave publike

Sa i përket **kornizës strategjike**, implementimi i strategjisë 2015-2019 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe planit të veprimit është i ngadalshëm, kryesisht për shkak të vonesave në miratim të ligjit të ri për kontrollin e brendshëm të financave publike. Në ligj parashihet edhe krijimi i Këshillit PIFC, për të monitoruar e raportuar mbi zbatimin e strategjisë. Rishikimi i strategjisë dhe planit të veprimit për PIFC, bashkë me treguesit e tyre, është i domosdoshëm për të siguruar përputhjen me strategjinë e reformimit të menaxhimit të financave publike dhe strategjinë e modernizimit të administratës publike. Ende mbetet të vihet në zbatim mekanizmi për koordinim, monitorim e raportim efektiv mbi administratën publike, menaxhimin e financave publike, si dhe reformat në PIFC.

**Llogaridhënia menaxheriale** nuk është mirë e jetësuar në kulturën administrative të sektorit publik. Ekziston një numër i madh i agjencive (gjysmë) të pavarura që i raportojnë drejtpërdrejt qeverisë dhe Kuvendit, e jo ministrisë amë të natyrshme. Menaxhimi i performancës është ende në fazë të hershme. Derisa duket të ketë përafrim më të madh ndërmjet delegimit të buxhetit dhe strukturave menaxhuese brenda organizatave buxhetore, vendim-marrja e deleguar nuk shfrytëzohet plotësisht. (*Shih Reforma e Administratës Publike*)

Korniza aktuale ligjore për **implementimin e kontrollit të brendshëm** nuk është plotësisht në përputhje me kornizën e kontrollit të brendshëm të Komitetit të Organizatave Sponsoruese (COSO) si dhe udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Aplikimi praktik i kontrollit të brendshëm ende mbetet të zhvillohet më tutje. Fokusi është kryesisht tek përputhshmëria financiare e ekzekutimit të buxhetit vjetor, e jo aq shumë tek menaxhimi strategjik financiar. Menaxhimi i rreziqeve dhe raportimi mbi parregullsitë rrallë aplikohen. Gjithashtu, ndodhin shumë rialokime të buxhetit jashtë procesit të rishikimit buxhetor.

**Praktika e auditimeve të brendshme** është e kufizuar në Kosovë. Kërkesat ligjore për organizimin e auditimit të brendshëm nuk zbatohen plotësisht. Kapaciteti është tejet i ulët, si dhe rreth 40% e njësisve të auditimit të brendshëm kanë vetëm një auditor. Megjithatë, shumica e njësisve të auditimit të brendshëm respektojnë kriterin e dorëzimit të planeve strategjike dhe vjetore të auditimit. Implementimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm, që kryesisht fokusohet tek zbatimi i rregullave dhe procedurave ekzistuese, mbetet i dobët.

**Njësia Qendrore e Harmonizimit (NJQH)** në Ministrinë e Financave është përgjegjëse për udhëzimet metodologjike dhe bashkërendimin e kontrollit të brendshëm dhe zhvillimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik. NJQH-ja përpilon raportin vjetor PIFC në bazë të pyetësorëve të vetë-vlerësimit, si dhe më 2017, qeveria kërkoi për vitin e tretë me radhë masat zbatuese nga NJQH-ja dhe organizatat buxhetore. NJQH-ja ka ndërmarrë rishikime të auditimit të brendshëm në baza të mostrave, por ende nuk ka implementuar rishikimet e kontrollit të brendshëm.

### **Auditimi i jashtëm**

**Korniza kushtetuese dhe ligjore** sa i përket Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Shtetërore të Auditimit janë në masë të madhe në përputhje me standardet e INTOSAI-t, duke siguruar pavarësinë funksionale, organizative dhe financiare. Sidoqoftë, mbrojtja e pavarësisë nga Gjykata Kushtetuese apo Gjykata Supreme nuk përmendet shprehimisht.

Sa i përket **kapacitetit institucional**, Zyra ka 155 zyrtarë, nga të cilët 129 janë auditorë. Trajnimet ofrohen në mënyrë sistematike. Numri i personelit është rritur çdo vit, për shkak të zgjerimit të mandatit të auditimit, për të mbuluar edhe auditimet e ndërmarrjeve publike (nëntë auditime të tilla të kryera më 2017). Zyra është duke zbatuar Strategjinë e saj të Zhvillimit Korporativ 2015-2020.

Për të rritur **cilësinë e punës audituese**, Zyra ka vënë në zbatim procedura të kontrollit dhe sigurimit të cilësisë. Zyra ka vazhduar të zbatojë programin e certifikimit dhe të kryejë auditime në përputhje me doracakët e auditimit financiar dhe atij të performancës, të cilat përditësohen rregullisht. Veprimtaria në auditim të performancës dhe të TI-së është duke u rritur.

**Ndikimi i punës së auditimit** është i kufizuar. Ndikimi i punës së auditimit është i kufizuar. Implementimi i rekomandimeve të auditimit duhet të rritet, sidomos në nivelin komunal. Vetëm 26% të rekomandimeve të nxjerra më 2015 u zbatuan plotësisht, 37% pjesërisht dhe 38% aspak. Të gjitha raportet e auditimit janë publikisht të disponueshme, si dhe Zyra ka ndërmarrë iniciativën për të përforcuar komunikimin e saj me shoqërinë civile përmes një forumi konsultativ.

### **Mbrojtja e interesave financiarë të BE-së**

**Përafrimi me *acquis*** është i kufizuar. Kosova nuk ka **shërbim koordinues anti-mashtrim (AFCOS)** e as strategji kundër mashtrimeve për mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së. Zbatimi i politikave të sinjalizimit apo procedurave të raportimit të parregullsisë, si masë e kontrollit të brendshëm, nuk është aq i përhapur. **Bashkëpunimi me Komisionin Evropian** sigurohet përmes një Marrëveshjeje për Bashkëpunim Administrativ të nënshkruar me Policinë e Kosovës në shkurt të vitit 2017. Ky synon transmetimin me kohë të informatave dhe bashkëpunimin në rastet e lidhura me mashtrimet e pohuara dhe aktivitetet tjera të paligjshme që prekin interesat financiarë të BE-së.

## Mbrojtja e Euros nga falsifikimi

**Përafrimi me *acquis*** ende nuk është vlerësuar, por Kosova ka krijuar autoritetet kompetente dhe procedurat për përballje me rastet e falsifikimit të parave. Ligji për Bankën Qendrore rregullon qarkullimin e parave të falsifikuara. Banka Qendrore ka nxjerrë edhe një rregullore për operacionet me kesh, me fokus tek përforsimi i rregulloreve dhe procedurave për institucionet financiare që veprojnë në Kosovë. Kosova merr pjesë në aksionet e programit Pericles 2020.

### 6.26. Statistikat

Kosova ka **një nivel përgatitjeje** në fushën e statistikave. **Pak progres** është bërë, sidomos në përmirësimin e llogarive nacionale. Sidoqoftë, Agjencia e Statistikave të Kosovës vazhdon të vuajë nga resurse e kapacitete të pamjaftueshme, që shpesh rezultojnë me vonesa në publikim dhe mungesë cilësie në statistika. Nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme sidomos për të siguruar përafrimin e statistikave makro-ekonomike dhe të biznesit me standardet evropiane.

Disa prej rekomandimeve në raportin e mëparshëm për Kosovën janë implementuar, si dhe në vitin vijues, Kosova duhet që posaçërisht:

→ Të ndryshojë ligjin për statistikatat dhe të sigurojë pavarësinë profesionale të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;

→ Të sigurojë vazhdimësinë adekuate të rishikimit nga Eurostat-i të Sistemit Statistikor të Kosovës dhe të miratojë një plan veprimi për të implementuar rekomandimet e tij;

→ Të bëjë përgatitjet e domosdoshme për regjistrimin vijues të popullsisë më 2020/2021, duke siguruar mbulim të plotë të territorit.

Tek **infrastruktura statistikore**, korniza ligjore është përgjithësisht në përputhje me kodin e praktikave statistikore evropiane. Ende mbeten të miratohen ndryshimet në ligjin e statistikave, si prioritet, për të avancuar më tutje pavarësinë profesionale dhe vazhdimësinë menaxheriale të Agjencisë Statistike të Kosovës, ashtu që të përmirësohet qeverisja e sektorit dhe të sigurohet qasja me kohë në të dhëna administrative. Mungesa e resurseve, financiare e njerëzore, pengon prodhimin me kohë të statistikave. Agjencia duhet të ketë rol më të fuqishëm koordinues brenda sistemit statistikor të Kosovës. Ajo duhet të arrijë të përdorë dhe të ketë ndikim mbi të dhënat administrative që mund të jenë burime për statistika zyrtare. Për të rritur sasinë dhe cilësinë e statistikave që prodhohen, Agjencia duhet të ketë në dispozicion resurset adekuate. Ajo gjithashtu duhet të rrisë efektivitetin në kosto, si dhe të zhvillojë një sistem të menaxhimit të cilësisë dhe metodave të reja të grumbullimit të të dhënave. Hapësirat aktuale mbesin joadekuate. Transmetimi i të dhënave tek **Eurostat**-i është përmirësuar. Që prej tetorit të vitit 2017, Agjencia ka përmirësuar më tutje shpërndarjen e statistikave në internet, por nevojiten përpjekje shtesë për të përforsuar marrëdhëniet me përdoruesit e të dhënave dhe botën akademike. Klasifikimi evropian i veprimtarive ekonomike (NACE Rev.2) vazhdon të aplikohet në të gjitha fushat relevante statistikore. Regjistri statistikor i bizneseve është përmirësuar, si dhe është më i përafuar me realitetin e veprimtarive ekonomike në Kosovë. Grupet e Ndërmarrjeve ende nuk janë vënë në zbatim.

Tek **statistikat makro-ekonomike**, është në vazhdim përafrimi i mëtutjeshëm me Sistemin Evropian të Llogarive 2010. Agjencia aktualisht përpilon llogaritë kombëtare vjetore dhe tremujore, si dhe ka arritur të shkurtojë periudhën e prodhimit. Më 2017, për herë të parë filloi prodhimin e llogarisë kapitale të qeverisë, si dhe do të vazhdojë të zhvillojë sektorët tjerë institucionalë. Statistikat mujore për tregti me mallra i dorëzohen Eurostat-it. Të dhënat për bilancin e pagesave përpilohen nga Banka Qendrore dhe janë përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së; të dhënat vjetore dhe tremujore i dorëzohen Eurostat-it. Statistikat e financave qeveritare u transmetuan tek Eurostat-i për herë të parë. Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit publikohet në pajtim me standardet e BE-së (klasifikimi ECOICOP).

**Statistikat strukturore të biznesit** dhe disa statistika afatshkurtra janë pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së, por disponueshmëria e statistikave afatshkurtra është e kufizuar. Statistikat e industrisë dhe ndërtimitarisë prodhohen përgjithësisht në përputhje me rregulloret relevante. Indeksi i kostos së ndërtimit prodhohet në baza tremujore. Statistikat industriale (lista e produkteve PRODCOM e Bashkimit Evropian) për vitin 2016 u publikuan në fund të vitit 2017. Statistikat e turizmit dhe ato të transportit ende nuk janë në përputhje me *acquis* të BE-së. Statistikat për hulumtimin dhe zhvillimin, inovacionin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nuk prodhohen në baza të rregullta. Më 2017, Agjencia për herë të parë kreu një hulumtim për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit nga ekonomitë familjare.

Për **statistikat sociale**, vetëm statistikat demografike janë përgjithësisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Si prioritet, Agjencia duhet të fillojë përgatitjet për regjistrimin e popullsisë 2020/2021, duke siguruar metodologjinë, resurset e mirëfillta, si dhe mbulimin e plotë të territorit. Disa statistika të mbrojtjes sociale prodhohen, por statistikat e besueshme të papunësisë ende mungojnë, ndërsa cilësia e të dhënave duhet të përmirësohet. Statistikat e arsimit ende nuk prodhohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të klasifikimit të arsimit (ISCED 2011). Anketa vjetore e fuqisë punëtore kryhet, por duhet të sigurohet publikimi më i shpejtë. Statistikat e indeksit të kostos së fuqisë punëtore, strukturës së të ardhurave dhe vendeve të lira të punës ende nuk prodhohen. Statistikat për shëndetin publik dhe kriminalitetin ende nuk janë në përputhje me standardet e BE-së.

Për **statistikat bujqësore**, Agjencia publikoi të dhëna për të mbjellat vjetore bujqësore, bagëtinë dhe pemëtarinë. Anketa për mbajtjen bujqësore prodhohet rregullisht dhe është e përafuar me standardet e *acquis*. Publikimi i hulumtimit të strukturës së fermave planifikohet për vitin 2019. Indekset e çmimeve bujqësore dhe llogaritë ekonomike për bujqësinë prodhohen në baza të rregullta. Bilancet e gjendjes së ofertës dhe indeksi i fuqisë punëtore në bujqësi ende nuk prodhohen.

**Statistikat energjetike dhe mjedisore** janë pjesërisht në përputhje me *acquis*. Më 2017, Agjencia shkurtoi afatet për publikimin e rezultateve të balancës energjetike, si dhe rriti numrin e produkteve statistikore që i dërgohen Eurostat-it. Megjithatë, nevojiten përmirësime të mëtutjeshme në këtë fushë. Statistikat për konsumin e energjisë në sektorin banesor në Kosovë janë prodhuar, por rezultatet mbeten të publikohen. Të dhënat mujore dhe hisja mujore e të ripërtërishmeve nuk i ofrohen Eurostat-it. Mungesa e treguesve të eficiencës së energjisë vazhdojnë të jenë pengesë në raportimin mbi kursimet e energjisë. Statistikat për mbeturina dhe ujëra prodhohen rregullisht. Statistikat mjedisore për emisionet në ajër, tatimet përkatëse mjedisore, shpenzimet në mbrojtje dhe llogaritë e rrjedhave materiale ende nuk prodhohen.

## **SHTOJCA I - MARRËDHËNIET MES BE-SË DHE KOSOVËS**

Më 1 prill 2016 ka hyrë në fuqi **Marrëveshja për Stabilizim-Asocim (MSA)** BE-Kosovë. MSA-ja paraqet marrëdhënien e parë kontraktuale mes BE-së dhe Kosovës. Kjo është marrëveshje gjithëpërfshirëse që ofron kornizën për dialogun politik, si dhe trajton bashkëpunimin në një gamë të gjerë të sektorëve, duke përfshirë drejtësinë dhe punët e brendshme, tregtinë, arsimin, punësimin, energjinë, mjedisin dhe një sërë fushash tjera të politikave. Dy mbledhje të Këshillit për Stabilizim-Asocim, si dhe dy cikle të takimeve të nën-komiteteve, janë mbajtur më 2016 dhe 2017.

Për të orientuar reformat në zbatim të MSA-së, Komisioni dhe Kosova miratuan në nëntor të vitit 2016 **Agjendën e Reformave Evropiane (ARE)** për Kosovën. Kjo Agjendë ravijëzon veprimet prioritare në fushat e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, konkurrencës dhe klimës së investimeve, si dhe punësimin e arsimit. Zbatimi i ARE-së është në vazhdim e sipër.

Kosova ka vazhduar të adresojë prioritetet e përcaktuara me Raportin e vitit 2016. Që prej vitit 2012, Komisioni ka nxjerrë katër raporte për progresin e Kosovës drejt **liberalizimit të vizave** (më të fundit në dhjetor të vitit 2015 dhe maj të vitit 2016). Më 4 maj 2016, Komisioni dorëzoi propozimin legjislativ për të hequr kriterin e vizave për qytetarët e Kosovës, me kushtin që deri në ditën e miratimit të tij nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli, Kosova do të ketë ratifikuar marrëveshjen e kufirit me Malin e Zi, si dhe të ketë përforcuar regjistrin e rasteve në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen për demarkimin e kufirit me Malin e Zi në mars të vitit 2018.

Sa i përket **ndihmës financiare**, programi i Instrumentit për Para-Asocim (IPA) 2016 për Kosovën është miratuar me kontribut të BE-së prej gjithsej 70.5 milionë eurosh, duke përfshirë programin me 25 milionë euro për përkrahje buxhetore për reformën e administratës publike, plotësuar me bashkë-financim nga Kosova për buxhet total prej 71.1 milionë eurosh. Programi IPA për vitin 2017 ofron kontributin e BE-së në total prej 73 milionë eurosh, duke përfshirë duke përfshirë programin me 25 milionë euro për përkrahje buxhetore për menaxhimin e financave publike, plotësuar me bashkë-financim nga Kosova për buxhet total prej 74.5 milionë eurosh. Më 2016, Zyra e BE-së nënshkroi 95 kontrata për gjithsej 54 milionë euro. Më 2017, Zyra e BE-së nënshkroi 120 kontrata për gjithsej 82 milionë euro. Ajo ka vazhduar të sigurojë bashkërendimin e donatorëve aktivë në Kosovë duke organizuar - bashkë me Ministrinë e Integrimit Evropian të Kosovës - mbledhje të rregullta për koordinim të donatorëve. Programi IPA për vitin 2018 për Kosovën është në përgatitje e sipër.

Më 17 korrik 2017, Këshilli miratoi Marrëveshjen Kornizë ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, mbi parimet e përgjithshme të pjesëmarrjes së Kosovës në **Programet e Bashkimit Evropian**. Kosova do t'i bashkangjitet Programeve Erasmus+, COSME, Evropa për Qytetarë dhe Evropa Kreative Europe for Citizens dhe Creative Europe).

Baza ligjore për **Dhomat e Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar të Kosovës**, themeluar për të hetuar pohimet për krime ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999, është kompletuar me hyrjen në fuqi, në janar të vitit 2017, të marrëveshjes dypalëshe me Holandën, duke mundësuar mbajtjen e procedurave të Dhomave të Specializuara në këtë vend. Në shkurt të vitit 2017, 19 gjyqtarë u emëruan në Listën e Gjyqtarëve Ndërkombëtarë. Rregullorja e Punës dhe e Provave hyri në fuqi më 5 korrik 2017, duke shënuar ditën nga e cila Dhomat e Specializuara bëhen plotësisht funksionale në kuptimin gjyqësor dhe në gjendje të pranojnë parashtrësat.

Që prej vitit 2008, **Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)** ka monitoruar, mentoruar e këshilluar Kosovën për sundim të ligjit. Ai ka edhe disa përgjegjësi ekzekutive.

Deri më sot, sipas qeverisë, Kosova është njohur nga 114 vende, duke përfshirë 23 Shtete Anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka vazhduar të ofrojë raporte të rregullta mbi veprimtarinë e Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK). Ai ka theksuar brengat për



vakumin institucional që rrodhi si pasojë e polarizimit politik në Kosovë, mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme në qershor të vitit 2017, si dhe zgjedhjeve komunale në tetor të vitit 2017, si dhe negociatave pasuese për formimin e qeverisë. Ai theksoi faktin që si pasojë, janë humbur mundësi të rëndësishme ekonomike e sociale gjatë asaj periudhe. Ai ka vazhduar të jetë avokues për rëndësinë e dialogut të lehtësuar nga BE-ja, si dhe ka bërë thirrje për autoritetet në Beograd dhe Prishtinë që të demonstrojnë leadership të fuqishëm si dhe që të arrijnë kompromise të drejta, të vështira e shpesh edhe të dhimbshme. Ai ka theksuar që pajtimi politik duhet të pasohet edhe me pajtimin shoqëror.

Forca e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) ka vazhduar të ndihmojë në sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe të rregullt në Kosovë. Gjatë periudhës së raportimit, Forca ka pasur afërsisht 4.000 trupa.

## SHTOJCA II - ANEKSI STATISTIKOR

TË DHËNAT STATISTIKORE (më 16.02.2018)

**Kosova**

<b>Të dhënat themelore</b>							
Popullsia (mijë)							
Sipërfaqja totale e vendit (km <sup>2</sup> )							

<b>Llogaritë kombëtare</b>							
Bruto-Prodhimi Vendor (BPV) (milionë euro)							
BPV (euro për kokë banori)							
BPV për kokë banori (në standarde të fuqisë blerëse (PPS))							
BPV për kokë banori (në PPS), në raport me mesataren e BE-së (EU-28 = 100)							
Norma e rritjes reale të BPV-së: ndryshimi në vitin paraprak të vëllimit të BPV-së (%)							
Rritja e punësimit (të dhënat e llogarive kombëtare), në raport me vitin paraprak(%)							
Rritja e produktivitetit të fuqisë punëtore: rritja në BPV (vëllim) për person të punësuar, në raport me vitin paraprak (%)							
Rritja e kostos për njësi pune, në raport me vitin paraprak (%)							
**Ndryshimi 3-vjeçar (T/T-3) në indeksin e rritjes nominale të kostos për njësi pune (2010 = 100)							
Produktiviteti i punës për person të punësuar: BPV (në PPS) për person të punësuar në raport me mesataren e BE-së (EU-28 = 100) Bruto-vlera e shtuar sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)							
Industria (%)							
Ndërtimtaria (%)							

Shërbimet (%)							
Shpenzimet e konsumit final, si hise e BPV-së (%)							
Formimi i bruto-kapitalit fiks, si hise e BPV-së (%)							
Ndryshimet në inventarë, si hise e BPV-së (%)							
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)							
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me BPV-në (%)							
Formimi i bruto-kapitalit fiks nga sektori i përgjithshëm qeveritar, si përqindje e BPV-së (%)							

### Biznesi

<b>Biznesi</b>							
Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2010 = 100)							
numri i ndërmarrjeve aktive (numri)							
Shkalla e natalitetit: numri i ndërmarrjeve të krijuara në periudhën referuese (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)							
Shkalla e vdekshmërisë: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën referuese (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)							
Persona të punësuar në NVM si hise e të gjithë personave të punësuar (në kuadër të ekonomisë së biznesit jo-financiar) (%)							
Vlera e shtuar nga NVM-të (në kuadër të ekonomisë së biznesit jo-financiar) (milionë EUR)							
Gjithsej vlera e shtuar (në kuadër të ekonomisë së biznesit jo-financiar) (milionë EUR)							

### Norma e inflacionit dhe çmimet e shtëpive

<b>Norma e inflacionit dhe çmimet e shtëpive</b>							
Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit (HICP), ndryshimi në raport me vitin paraprak (%)							
**Ndryshimi vjetor në indeksin e çmimeve me deflacion të shtëpive (2010 = 100)							

### Bilanci i pagesave

<b>Bilanci i pagesave</b>							
Bilanci i pagesave: gjithsej llogari rrjedhëse (milionë euro)							

Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci tregtar (milionë euro)							
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: shërbimet neto (milionë euro)							
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci neto për të ardhurat primare (milionë euro)							
Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci neto për të ardhurat sekondare (milionë euro)							
Bilanci neto për të ardhurat primare dhe sekondare: nga të cilat transfere qeveritare (milionë euro)							
**Mesatarja 3-vjeçare me lëvizje prapa e bilancit të llogarive rrjedhëse në raport me BPV (%)							
**Ndryshimi pesëvjeçar në pjesën e eksporteve botërore të mallrave e shërbimeve (%)							
Bilanci neto (hyrje-dalje) i investimeve të huaja direkte (IHD) (milionë euro)							
Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milionë euro)							
Nga të cilat IHD të ekonomisë raportuese në vendet EU-28 (milionë euro)							
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milionë euro)							
Nga të cilat IHD të vendeve EU-28 në ekonominë raportuese (milionë euro)							
**Neto pozita e investimeve ndërkombëtare, në raport me BPV- në (%)							
Shkalla e ndryshimit vit pas viti në rrjedhat bruto hyrëse të remitencave (në valutë kombëtare) nga punëtorët migrues (%)							

### Financat publike

***Deficiti/suficiti i përgjithshëm qeveritar, në raport me BPV (%)							
***Bruto borxhi i përgjithshëm qeveritar, në raport me BPV (%)							
Gjithsej të ardhura qeveritare, si përqindje e BPV-së (%)							
Gjithsej shpenzime qeveritare, si përqindje e BPV-së (%)							

<b>Treguesit financiarë</b>							
Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me BPV (%)							
Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%)							
Oferta e parasë: M1 (banknotat, monedhat, depozitat ditore, milionë euro)							
Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet, milionë euro)							
Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milionë euro)							
Gjithsej kredi nga institucionet financiare monetare për banorë (konsoliduar) (milionë euro)							
**Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)							
**Rrjedha kreditore private, konsoliduar, në raport me BPV-në (%)							
**Kredi private, konsoliduar, në raport me BPV-në (%)							
Normat e interesit, norma e parave ditë pas dite, për vit (%)							
Norma e interesit për kredi (një vit), për vit (%)							
Norma e interesit për depozita (një vit), për vit (%)							
Shkalla e këmbimit të euros: mesatare e periudhës (1 euro = ... valuta kombëtare)							
Indeksi i normës këmbimore efektive të ponderuar për tregtim, 42 vende (2005 = 100)							
**ndryshimi 3-vjeçar (T/T-3) në Indeksin e normës këmbimore efektive të ponderuar për tregtim, 42 vende (2005 = 100)							
Vlera e aseteve rezervë (përfshirë arin) (milionë euro)							

<b>Tregtia e jashtme me mallra</b>							
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milionë euro)							
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët							

(milione euro)							
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milione euro)							
termat e tregtisë (indeksi i çmimit të eksportit / indeksi i çmimit të importit * 100) (numri)							
Pjesa e eksporteve drejt vendeve EU-28 në vlerën e eksporteve totale (%)							
Pjesa e importeve nga vendet EU-28 në vlerën e eksporteve totale (%)							

### Demografia

Norma brut e ndryshimit natyror të popullsisë (shkalla natyrore e rritjes): numri i lindjeve minus vdekjet (për mijë banorë)							
Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave, fëmijë të vdekur nën moshën njëvjeçare (për mijë lindje të gjalla)							
Jetëgjatësia e pritur në lindje: meshkuj (vite)							
Jetëgjatësia e pritur në lindje: femra (vite)							

### Tregu i punës

Shkalla e aktivitetit ekonomik për personat në moshat 20– 64 vjeç: pjesa e popullatës në grupmoshat 20–64 që është ekonomikisht aktive (%)							
*Shkalla e punësimit për personat në moshat 20 -64 vjeç: pjesa e popullatës në grupmoshat 20–64 që është në punësim (%)							
Shkalla e punësimit të meshkujve në moshat 20-64 (%)							
Shkalla e punësimit të femrave në moshat 20-64 (%)							
Shkalla e punësimit për personat në moshat 55 -64 vjeç: pjesa e popullatës në grupmoshat 55–64 që është në punësim (%)							
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)							
Industria (%)							
Ndërtimtaria (%)							
Shërbimet (%)							

Persona të punësuar në sektorin publik si pjesë e punësimit total, persona të moshave 20– 64 vjeç (%)							
Persona të punësuar në sektorin privat si pjesë e punësimit total, persona të moshave 20– 64 vjeç (%)							
Shkalla e papunësisë: raporti i fuqisë punëtore që nuk është e punësuar (%)							
Shkalla e papunësisë meshkuj (%)							
Shkalla e papunësisë femra (%)							
Shkalla e papunësisë rinore: raporti i fuqisë punëtore në moshat 15-24 vjeç që nuk është e punësuar (%)							
Shkalla e papunësisë afatgjate: masa e fuqisë punëtore që ka qenë pa punë për 12 muaj e më shumë (%)							
Shkalla e papunësisë për persona (të moshave 25–64) që kanë kryer më së shumti arsimin e mesëm të ulët (nivelet 0-2 ISCED) (%)							
Shkalla e papunësisë për persona (të moshave 25–64) që kanë kryer arsimin terciar (nivelet 5-8 ISCED) (%)							

#### Kohezioni social

Pagat dhe rrogat mujore nominale mesatare (valutë kombëtare)							
Indeksi i pagave dhe rrogave reale (indeksi i pagave dhe rrogave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2010=100_							
Koeficienti GINI							
Hendeku i varfërisë							
*Braktisësit e hershëm të arsimit dhe aftësimin: masa e popullatës në moshat 18–24 vjeç me më së shumti arsim të mesëm të ulët që							
nuk ndjekin arsim apo aftësim të mëtutjeshëm (%)							

#### Standardi i jetesës

Numri i automjeteve të pasagjerëve në raport me madhësinë e popullsisë (numri për mijë banorë)							
Numri i abonimeve të telefonisë mobile në raport me madhësinë e popullsisë (numri për mijë banorë)							

Penetrimi i brezit të gjerë mobil (për 100 banorë)							
Penetrimi i brezit të gjerë fiks (për 100 banorë)							

### Infrastruktura

Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në operim për mijë km <sup>2</sup> )							
Gjatësia e rrugëve nacionale (kilometra)							

### Inovacioni dhe hulumtimi

Shpenzimet publike për arsimin në raport me BPV-në (%)							
*Shpenzimet bruto vendore për Hulumtim e zhvillim në raport me BPV (%)							
Zotimet apo projeksionet buxhetore qeveritare për hulumtim e zhvillim (GBAORD), si përqindje e BPV-së (%)							
Përqindja e ekonomive familjare që kanë qasje interneti në shtëpi (%)							

### Mjedisi

*Indeksi i emisioneve të gazrave serrë, CO <sub>2</sub>							
Ekivalent (1990 = 100)							
Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg naftë ekuivalent për 1000 Euro BPV me çmime konstante të 2010-ës)							
Energjia elektrike e gjeneruar nga burime të ripërtërishme në raport me konsumin bruto të energjisë elektrike (%)							
Pjesa rrugore e transportit të mallrave brenda vendit (me bazë ton-km) (%)							

### Energjia

Prodhimi primar i të gjitha produkteve të energjisë (mijë TOE)							
Prodhimi primar i naftës krud (mijë TOE)							
Prodhimi primar i lëndëve të ngurta (mijë TOE)							
Prodhimi primar i gazit (mijë TOE)							
Importet neto i të gjitha produkteve të							



energjisë (mijë TOE)							
Konsumi bruto i energjisë brenda vendit (mijë TOE)							
Gjenerimi bruto i energjisë elektrike (GWh)							

### Bujqësia

Indeksi i vëllimit të prodhimit bujqësor për mallra e shërbime (me çmime të prodhuesit) (2010 = 100)							
Sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar (mijë hektarë)							
Shifrat e bagëtisë: kafshë të gjalla gjedh (mijë koka, fundi i periudhës)							
Shifrat e bagëtisë: kafshë të gjalla derr (mijë koka, fundi i periudhës)							
Shifrat e bagëtisë: dele dhe dhi të gjalla (mijë koka, fundi i periudhës)							
Qumësht i gjallë në dispozicion në ferma (mijë tonë)							
Prodhimi i të vjelave: drithëra (përfshirë orizin) (mijë tonë)							
Prodhimi i të vjelave: panxhar sheqer (përfshirë orizin)(mijë tonë)							
Prodhimi i të vjelave: perime (përfshirë orizin)(mijë tonë)							

: = nuk janë në dispozicion

b = ndarja në seri

e = vlerësuar

p = përkohshme

\* = indikator i Europe 2020

\*\* = Indikator i Procedurës së Mosbalancimit Makroekonomik (MIP)

\*\*\* = të dhënat për deficitin dhe borxhin qeveritar në vendet e zgjerimit publikohen në baza "ashtu si janë" dhe pa ndonjë siguri në lidhje me cilësinë dhe përputhshmërinë me rregullat ESA..

### Fusnotat

- 1) 2005, 2012-2014: indeksi i çmimit të konsumit.
- 2) 2012-2015: Vlera e BPV-së nxirret nga Kornizat Afatmesme të Shpenzimeve 2014-2016 si dhe 2016-2018.
- 3) Përfshin tarifën e disbursimit ngarkuar nga bankat.
- 5) Duke përfshirë tokën e përbashkët bujqësore.
- 6) 2014: Të dhëna nga regjistrimi bujqësor 2014. 2014-2016: Rezultatet për katër komuna në veri të Kosovës që nuk kanë marrë pjesë në regjistrim/sondazhe janë të përafuara.
- 7) Përjashton orizin.

